


*Idriz Ponari*

# OYTEZA E BARDHE

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-32  
P85



NOVELA E TREGIME

854-32

D 85

IDRIZ PONARI

# QYTEZA E BARDHË

— *Novela e tregime* —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## GURI I KRIPIES

Pashe Kola, një malësore e re nga Bregu i Drinit, me shtat të hedhur e sy të kaltër, me flokët pisë të zinj të fshehur nën shami, me faqet që i skuqnin si dy kokrra mollë, shihte delet që kullosnin dhe këndonte me shikimin tretur andej, midis maleve të larta e të thepisura, nga gjarpëron Drini. Rrjedha e lumit vende-vende ngushtohej aq shumë, sa Pashes ia merrte mendja se mund ta hidhte gurin matanë. Në ato ngushtica ujërat e shumta grumbulloheshin me valë të egërsuara e kryeneçe, përplaseshin pas shkëmbinjve e riktheheshin me zhurmë. Malet e larta e tepër të pjerrëta në të dyja anët i rrinë lumit mbi kokë Ujëvarat e panumërtë të Drinit e rrëmbezin vajzën e re dhe pikërisht këtyre bukurive ajo po u këndonte, u këndonte atë këngën që e kishte thurur vetë.

Shtëpitë e bardha të fshatit dukeshin para syve të Pashes si copëra të atyre shkëmbinjve gjigantë, të shkëputura nga mali. Ato qëndronin të veçuara e larg njëratjetrës.

Tek ishte duke kënduar, Pashes iu bë sikur dëgjoi zëra. U çua në këmbë, po njerëz nuk pa, dhe ia mori përsëri këngës.

— Oj Pashe, — u dëgjua një zë që i thirri paksa larg, po shumë i qartë.

— O hoja, — u përgjigj dhe bëri më lart, se një tufë lisash i kishin zënë rrugën.

Ishin shokët e shoqet e saj të fshatit.

— Apo vjen te Kantieri i Dritës, o Pashe?

(Kështu i thoshin kantierit të ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës ata)

— Besa s'po di. Pse me ardhë, moj çika? — pyeti Pashja dhe priti të merrete përgjigje, po në vend të saj dëgjoi zërat e tyre tek bisedonin me njëra-tjetrën.

— Po ti a nuk din gja, a? — e pyeti një vajzë.

— Jo besa. Nuk di...

— Heu, — ia bëri një djalë. — Si bre, nuk ditke gja? Sot vijnë ata të «Mao Ce Dunit». Do të këndojnë, do të kërcejnë pér ne.

Kur i thanë «Vijnë ata të «Mao Ce Dunit», asaj iu kujtua Ndoci, iu kujtuan ato ditë të bukura kur ai, Ndoci Marash Geri ruante dhitë e kooperativës. Ata të dy këndonin kodrave. Ja, ai, Ndoci, i përgjigjej me këngë asaj Pashe Kolës. Kur iku Ndoci para dy vjetësh, ajo kishte kuptuar se pa atë, Ndoci Marash Gerin, malet i dukeshin të vetmuara. Dhe kishte ndier një mërsi të çuditshme e të panjohur pér të.

Ndoci Marash Geri ishte bërë eskavatorist. Ai tani kishte një makinë të fuqishme që ngrinte traktorin, sikur të mos qe traktor prej hekuri po karkalec prej fushe. Punonte në hidrocentral.

Kështu thoshin e ajo krenohej me Ndocrin.

— Po fol, moj Pashe, se ne ty po të presim, — dëgjoi një zë pak si të shqetësuar.

Pashja mendoi me vete aty pér aty:

Po tata ç'do të thotë? «Harbove edhe ti, oj Pashe, si çikat e tjera? Po a s'të vjen marre, oj Pashe?» — dhe me gjysmë zëri iu përgjigj shoqes që i pat thirrur:

— Nisuni, nisuni ju...

Dhe priti ç'do t'i thoshin.

Atje matanë tufës së lisave shoqet e shokët e saj  
diç bisedonin midis tyre, pastaj i thirrën prapë:

— Po ti hajde me ne, oj Pashe, mos e humb këtë rast!

— Jam me dele, oj çika, m'i ha ujku...

— Po pse, ne pa punë ishim, a? — tha dikush.

— Afroi delet tash, se kanë kullotë mjaft që në pikë të sabahut, — shtoi një tjetër.

— Nisuni, nisuni... Nisuni se ju za rrugës, — tha e menduar Pashja më në fund.

— Besa-besë?

— Besa-besë, — u përgjigj Pashja dhe qeshi.

— Mos u vono pra, — vazhdoi zëri, — se ata të «Mao Ce Dunit» nuk vijnë përditë te ne. Është rast i bukur, oj Pashe!

Pas këtij dialogu të rinjtë morën kurrizit të malit.

Pashja ra përsëri në mendime:

«Është rast i bukur!» — këto fjalë i kumbonin në vesh, ndërsa para sysh i shfaqej fytyra e zverdhur e tatës me ata sytë e vegjël e të inatosur. Mendime të shumta i vërshonin. Mori tufën e deleve përrpara dhe i futi te delet e plakës Marë, duke i afruar ngadalë e duke i thënë si qëndronte puna pa ia hequr sytë.

— Shko, të pastë nana, për ju asht kanga, — i tha plaka Marë.

Pashja e puthi në të dyja faqet dhe fluturoi.

\* \* \*

Gjatë gjithë rrugës Pashja eci me drojtje se mos takonte papritur tatën, duke thënë me vete: «Ai të flet rëndë, të turpëron në sy të miletit, në sy të Ndocit».

Kur arriti në vendin ku do të jepej shfaqja e kur pa

gjithë ata njerëz, u step. Dyshoi se mos midis gjithë atyre njerëzve mund të ishte edhe tata. Sikur iu shfaqën dy sytë e tij që e bënин t'i ngrinte gjaku e t'i dridheshin gjunjët. Po mendimi se do të takonte Ndoc Marash Gerin e shtyu të ecte përpara.

Katër makina ishin takuar dy e dy, «shpinë për shpinë», dhe kishin krijuar një shesh të vogël të drunjëtë që përbënët skenën. Skenë e çuditshme!

«Paska fillue», — tha ajo me vete duke lëvizur më tej e në të njëjtën kohë pa e hequr vështrimin nga dy djem e një vajzë që këndonin e u binin veglave në skenë. Kërkoi me sy Ndoc Marash Gerin, po atë nuk e pa gjékundi. «Këndokan edhe çikat, — foli me vete. — Po sikur të këndoja unë para gjithë miletit?» — pyeti dhe fytyra e tatës i doli përpara tërë zemërim e kërcënuese.

Tre këngëtarët u larguan nga skena dhe fill pas tyre doli një djalosh shtathedhur me kaçurrela të zinj, që tha me zë të lartë e rrjedhshëm se kush do të këndonte. Pastaj në skenë doli një vajzë. Ajo këndonte bukur. Pashja e dëgjoi me vëmendje deri në fund këngën e saj. «Tata i kësaj çike nuk do të jetë si tata im...» — tha me vete dhe vazhdoi të duartrokiste akoma, kur të tjerët kishin heshtur.

Njerëzit kthyen sytë nga ajo.

Pashja uli kokën e turpëruar.

«Lashë nam!.. Ç'desa që erdha?» — tha me vete.

Djali me kaçurrela të zinj doli prapë në skenë:

— Ndoc Marash Geri...

Kaq dëgjoi ajo, se shpërthyen duartrokitjet. Të gjithë e njihnin atë, Ndoc Marash Gerin.

Pashja u tremb.

Nëpër trup i kaluan të rrëqethura. Ndjeu t'i vëرشonte gjaku në kokë dhe tha me vete se kushedi sa shumë do të qe skuqur në fytyrë!

I hodhi sytë nga skena dhe pa Ndocin. Për çudi ai iu duk i madh. Ishte rritur. Ishte shëndoshur. Ishte veshur bukur. Iu kujtua ajo makina e tij e fuqishme që e peshonte traktorin si karkalec fushe. Ndoci mbante në dorë një çifteli të re, të bukur, por që dukej e vogël për krahët e tij të fuqishëm.

Ndoci ngriti kokën dhe duke buzëqeshur lehtë po vështronë nga spektatorët si të kërkonte të shihte ndonjë të njojur...

«Ja ku jam, o Ndoc Marash Geri, — deshi t'i thërriste Pashja që atje ku ishte. — Ti nuk e di se Pashe Kola sot ka ardhë pa lejë të tatës me ndigjue kangën tande. Unë e di çfarë kange do të këndosh ti, se ne shpeshherë kemi këndue bashkë pyjeve. Edhe çiftelisë sate ia njoh melodinë...»

Pushuan zhurmat. Ndihej vetëm buçitja e ujit të Drinët nëpër gryka dhe tingujt e çiftelisë së Ndocit. Në qelli s'kishte asnjë re. Qielli dukej i kaltër, i bukur, i dashur...

— Merrja me zë, o Ndoc, se na plake — foli dikush.

Ndoci po e vononte këngën. Në fillim i binte çiftelisë, thua jse kishte dëshirë të tregonte sa mirë i binte. Dhe pse të mos e tregonte?

Pastaj zëri i tij i bukur jehoi papritur. Dikush duartrokiti, po një plak u ankua:

— Na lini të dëgjojmë këngën e në fund po rrëshim shuplaka sa të doni!

Pashja pa plakun.

Edhe ajo kishte dëshirë ta dëgjonte atë këngë. E çudiste ajo këngë. Ajo qe gënjer. Ajo, Pashe Kola, s'e din te atë këngë.

«Ky Ndoci paska ndryshue».

*Sot s'po këndojet përvalt' e lumit,  
Po për ndërtuesit e «Mao Ce Dunit.»*

«Sa bukur!» — tha Pashja.

«Që kur s'jam pa me Ndocin? — pyeti ajo dhe një mendim ogurzi i erdhi në kokë. — A mos më ka harrue mue ai, Ndoc Marash Geri? Ai e ka harrue kangën që këndonim bashkë. Ai paska mësue nji kangë të re!»

Duartrokitjet që shpërthyen atë çast e shkëputën nga mendimet. Ajo kujtoi se kënga kishte mbaruar, po Ndoci këndonte:

*I tha Enveri, Drinit: «Ndal». E ne një mal rritëm me valë.*

Pashen e pushtoi një ndjenjë krenarie kur dëgjoi këto vargje dhe duartrokitjet që shpërthyen përsëri. Ajo priti të dëgjonte plakun që ankohej po ai po duartrokiste e po buzëqeshte i gjëzuar gjithnjë e më shumë.

Ndoc Marash Geri lëvizte si t'ia komandonte zemra ata gishta dhe këndonte me sytë e ngulur mbi malet e larta që dukeшин sikur të qenë bërë një me qiellin e kaltër. Fytyra e tij shkëlgente nga gjëzimi.

Pas pak turma e njerëzve filloj të lëvizte. Shfaqja mbaroi. Pashe Kolën e shqetësonde mendimi: mos e kishte harruar ai, Ndoc Marash Geri? A do ta takonte që të ndërronte me të dy fjalë?

Filloj të ecte edhe ajo. U afrua atje te makinat. Po kur pa sa shumë njerëz ishin, ajo u largua dhe hipi mbi një shkëmb veças atyre njerëzve.

Dielli qe fshehur prapa maleve e në lugina ajri qe freskuar. Buçitja e Drinit dëgjohej më shumë.

Priti, priti, Pashja, ashtu e malluar dhe më në fund tha me dëshpërim: «Më ka harrue». Dhe mori me vrap rrugën e kthimit nëpër udhën e vetmuar të pyllit.

\* \* \*

Midis lisave tē gjatë tē pyllit gurgullon ai krua me ujë tē kulluar, që tē ndjell tē shuash etjen në pikën e zhe-gut. Era e luleve dhe e barit tē njomë kundërmonte. Zogjtë dëgjoheshin tek ciceronin tē fshehir nën gjethet e pemëve. Poshtë, në Kantierin e Dritës, dëgjoheshin zhurmat e motorave tē makinerive, buldozerëve... Bregut tē Drinit nuk kishte qetësi.

Dhe Pashja ecte, ecte e nxituar përmes pyllit me èndrrat e saj tē vrara. Papritur dëgjoi një zë:

— A je, Pashe Kola?

Në fillim u tremb si ta kishte pickuar gjarpri, po kur hodhi sytë andej nga i pat ardhur zëri, thirri:

— A ti je, Ndoc, a? Si je? — dhe u skuq e tëra në fytyrë.

— E paske marrë me vrap, o Pashe!

— Ç'ka me ba,... i kam lanë delet vetëm, — tha ajo.

— Të pashë kur erdhe, Pashe.

Ajo uli sytë dhe u skuq më tepër.

— Pse s'erdhe tē këndonim bashkë, o Pashe?

Ajo deshi ta qortonte rëndë: «Kur më pe, pse nuk më erdhe pranë, po më le si tē mjerueme?!» — Pastaj iu përgjigj:

— Kësaj here erdha tē ndigjoj. Atë kangë sot e mësova, Ndoc... — dhe qëndroi e menduar, sikur t'i thoshte: «Ti e di, o Ndoc, që mue nuk më len tata me këndue!»

Ndoci, sikur t'ia kishte kuptuar mendimin, i foli:

— Të merr Ndoci ty, o Pashe Kola.

— ....

— Po çfarë ke në këtë grusht, pash kryet?

Ai ia hapi duart që deri atëherë ia mbante tē shtrënguara në tē tijat.

— Kam gurin e kripës, — tha ajo duke qeshur.

Ndoci e mori në dorë atë gur kripe. Ishte si një topth i qelqtë i lëmuar prej gjuhëve të deleve kur i ndillte Pashja shtigjeve të maleve. Ai gur i kujtoi shumë gjëra Ndocit...

— A ma fal mue, o Pashe, këtë gur?

Ajo e shikoi e habitur.

— Çka të duhet ty, o Ndoc, guri i kripës? Ti nuk ke ma tufën, po atë maqinën e madhe...

Ai qeshi.

— Për maqinën e due, o Pashe, për maqinën. Ajo maqinë asht zemra e Ndocit. Aty në kabinë do ta var këtë gur kripe. Apo s'kam vend edhe për një njeri aty në kabinën e maqinës sime! Po njeri s'kam gjetë, mbasë guri i kripës do të ma gjejë...

Pashja vështronte kantierin, lumin, malet, e fytyra i digej.

Drini ushtonte. Në kantier nuk kishte qetësi.

## P O R T R E T I

Në minierën tonë erdhi për të bërë punën fizike Vera. Ajo është skulptore dhe punon në Institut.

Ne niseshim çdo mëngjes me autobusin e orës pesë e tridhjetë, por qëllonte më të rrallë që vinte edhe me atë të orës gjashtë. Kur vinte Vera duke vrapuar, Sotiri e pyeste nga larg për vonesën e ajo, duke buzëqeshur, i thoshte: «Më qe prishur furnela e kafesë...». — Ne qeshnim sepse kjo shaka e Verës thumbonte ata që pinin nga gjashtë kafe në ditë.

Mbasi vinte Vera, ne zinim atë qoshen tonë. Si gjithnjë, në fund të autobusit. Sotiri është inxhinier. Ka mbaruar fakultetin duke vazduar shkollën pa shkëputje nga puna. Njëzenënëntëvjeç. Këtij inxhinier Sotirit, që ka trup mesatar, i takon vendi që të mbështetet për hekurat mbrojtës të xhamit, në fund të autobusit. Në të djathtë, afër dritares, qëndron Vera, ndërsa unë afër asaj dritares së vogël që kanë autobusat për ajrosje. Aty ne mbledheshim çdo ditë dhe fillonim nga bisedat tona që s'i ndërprisnim as edhe kur ndonjëri na quante «lokalistë». Se Vera është skulptore, Sotiri amator në pikturë, ndërsa unë... Jam i treti në grupin «e artistëve» të minierës sonë.

Pas Verës vjen gjithnjë kryellogaritari Liman, me pallto të rëndë e me çantë në dorë. Çantën e ka gjithnjë

të mbushur plot. Afër na qëndron edhe elektricisti, një djalë ftyrëhequr, rreth njëzetkatërvjeç, që sjell me vete çdo mëngjes erën e freskët të kolonjës. Ai e vështron Verën. Qesh kur qesh ajo, edhe pse nuk merr pjesë në bisedë. Po kur ndodh që e pyet Verën për diçka, ajo e vështron drejt në ftyrë me dashamirësi, i përgjigjet dhe, pa mbaruar, ftyra e elektricistit bëhet all e kuqe. Ah, kjo Vera! Ka trup të gjatë e ftyrë të bukur. Sy të shkruar e vështrim të mprehtë. Të folur të rrjedhshme. Pa le të qeshurën, tringëllimë! Rreth qafës mban gjithnjë atë shallin e saj në ngjyrë rozë të ndezur.

Elektricisti skuqet, ndërsa kryellogaritari e vëren. Çet mekaniku, me zërin e tij metalik, çan përmes njerëzve, duke përshëndetur sa majtas-djathtas. Më i shkathëti mekanik që ka miniera. Si përshkon gjithë autobusin, që nga Sotiri mbështetur pas hekurit mbrojtës të xhamit, qëndron atje në krye, pas sediljes së zëvendësdrejtorit. Harrrova t'ju them se ky shoferi ynë, që mban kasketë të gjes, para nisjes, thërret: — «Hej shokëni, kontrolloni orët, i keni mirë apo jo?» — dhe shtyp butonin. Motori gullon e xhamat dridhen, pastaj merr kthesën ngadalë, deri atje ku shket në asfalt. Kështu nisemi ne çdo ditë...

U zgjata ca, po kjo vetëm nga dëshira për t'ju njohur me disa nga shokët e shoqet e mia. — Ata janë shumë dhe përbëjnë atë që Vera e ka quajtur «Kapitulli i këngëve të shkruara në zemër të tokës».

Rrëfimi im fillon me ta, për një ngjarje që ka ndodhur katër-pesë vjet më parë. Sotiri punonte si teknik misionere dhe vazhdonte shkollën. Me t'u diplomuar inxhinier, u largua nga sektori i parë dhe u caktua në minierë. Një ditë ai njoju një njeri. Kishte ardhur nga fshati. E quanin Lush Baftia. Ai kishte trup të shkurtër e të lidhur, shpatulla e gjoks të gjerë. Ftyrërrreshkur. Nën vetullat e tij

me qime të verdha, Lush Baftia vështronte me kureshtje, se çdo gjë në minierë i dukej e re dhe e panjohur. Dokumentat i kishte në rregull Lushi, ndaj e morën në punë, duke e caktuar si ndihmësminator në galerinë e shtatë. Ai rrinte i vëtmuar. Edhe në punë gjatë tetë orëve veç heshtte. Kur flisnin shokët, ai dëgjonte. Pinte duhan dhe dëgjonte në heshtje. Në punë s'ia kalonte njeri. Një ditë e caktuan të punonte jashtë. Zëvendësoi një punëtor tjetër. Shtatë vagona me qymyr kishte shtyrë njëherësh atë ditë Lush Baftia. Fjala qe përhapur në të katër anët. Deri në qytet kishte vajtur bile. Dikush mundi ta quante Lu-shin «Dekovil», një tjetër «Lokomotivë». Po ai i priti këto në heshtje me nga një shtëllungë tymi. Kur pinte duhan Lushi, të dukej sikur i kushtonte vëmendje të veçantë tymit që lëshonte nga goja. Ai thithë cigaren fort, pastaj, si i zgjaste buzët e shtrënguara pipës, lëshonte përpara fytyrës i rritej një si këpurdhë tymi. Nganjëherë ai rithithë tymin, sikur të qe montuar ndonjë pompë në fytyrën e tij, kur lëshonte ato: pup-pup-pup e tymi i bardhë tretej si një lëp<sup>1)</sup>) e zbetë.

Kështu kaluan gjashtë muaj e gjysmë. Lush Baftia filloj të hapej si ajo pema që mbjell në oborr dhe e vëren çdo ditë. Në fillim të duket se ajo qëndron njëlloj, si ditën e parë që e ke mbjellë. Nuk vëren ndryshim, derisa një ditë, kur papritur lëshon gjethë e lule. Kështu ndodhi edhe me Lush Baftinë. Në pesëmbëdhjetëdëshin e fundit ai arriti të merrte pesëqind e shtatëdhjetë e katër lekë e një grusht me qindarka, që ia kishte hedhur në prehër arkë-tares sonë e ia kishte bërë gjakun ujë. Lush Baftia kishte bërë një prapakthehu e as kishte çarë kokën se po e ndiqte pas arkëtarja. Vetëm kur ajo i kishte thënë e nevrikosur: «Mirë... këtu do të vish prapë, o Lush Baftia», — Lushi

---

1) Lëpë — perde e hollë mjegulle.

kishte buzëqeshur lehtë. Nuk e dinte se ajo arkëtarja e minierës sonë do ta kritikonte Lush Baftinë edhe në mbledhjen e kolektivit atë ditë që ky qe propozuar për brigadier. Ç'është e vërteta, kur qeshën shokët, Lushit iu skuqën edhe majat e veshëve, pa le ftyra. Edhe kur u ngrit e u zotua, ftyrën all e kishte, po këto ishin vogël-sira që askush nuk i vërente përparrë fjalëve të tij kur tha:

- Kam pasë mendue me u ba minator i zoti dhe...
- Shokët duartrokiten. — Por, — vazhdoi ai, — jo brigadier, — shokët qeshën. — Nejse. Ju vendosët pra dhe...
- Shokët duartrokiten. — Unë, — vijoi Lush Baftia, — do të punoj si brigadier dhe si minator. Lush Baftia pa puanar s'mund të rrjë...

Që atëherë ai filloi të punonte si brigadier. Lush Baftia e drejtonte brigadën apo të gjithë shokët ndihmonin që punët të shkonin «sahat», këtë nuk e thoshin, po në fund doli që detyrat e planit të vitit i plotësuan në nëntë muaj e katër ditë. Kjo bëri bujë në minierë. Shkroi edhe «Zëri i popullit» për brigadën dhe për brigadierin komunist. Fotografia e Lushit me shokë, një fotografi me format të madh, u vendos në një vend të dukshëm në të hyrë të minierës, aty ku janë ato stendat e emulacionit.

Pas dy muaj e njëzet e gjashtë ditësh dhe pikërisht më 30 e 31 dhjetor, në prag të Viti të Ri, komunisti Lush dhe shokët e tij shënuan një objektiv të ri të shkruar me pak fjalë: «Planin e vitit të ardhshëm do ta realizojmë më 16 tetor...»

Të gjitha këto na i tregonte Sotiri, aty në qoshe të autobusit, ku rrinte mbështetur pas xhamit mbrojtës.

Çet mekaniku i thërriste nga kreua për të bërë të tjetrët të qeshnin. Po Sotiri, me atë tonin e tij të urtë vazhdoni tregimin për shokun e tij, brigadierin komunist Lush Baftia. Ai e ngrinte zérin kur thoshte se, pas tre vjetësh

brigada e tij tejkaloj planin duke avancuar një vit përpara. Gjë e rrallë, por përpara vullnetit të komunistëve, punëtorëve, s'ka e s'mund të ketë shkëmb që s'çahet as para-shikim që s'arrihet.

— ...Unë krenohesha me Lushin, — vazhdoi të na tregonte inxhinier Sotiri, — se e kisha shok të ngushtë. Dhe me shokët e tjerë të brigadës krenohesha. Më kujtohet dita e fundit. Ka qenë e premte më 19 prill 196... Ne u drejtuan për te kulla e madhe që të zbrisnim në galeri e t'ia fillonim punës. Do të punoja atë ditë në brigadën e Lushit. Kishim një sektor të vështirë. Në galerinë numër shtatë gjëmonin pistoletat. Lush Baftia i kishte vënë gjoksin shkëmbit. Pistoleta e tij ma kishte mbërthyer vështrimin. Po mendoja vitet e punës në minierë. Unë dhe Lushi ishim rritur. Ai qe bërë komunist, minator, brigadier i dalluar. Edhe unë... Ne qemë pranuar në Parti njëherësh. Sa qeshë diplomuar inxhinier. E nëpër këto mendime ato caste më valaviteshin flamuj të kuq. Flamujt e 1 Majit të kuq. Unë kisha preqatitur ato pllakatet dhe më kishin dale të bucura. Me ato do të parakalonim përpara shokut Enver. Ç'gëzim të madh ndienim. Dhe ky gëzim na jepte krahë për të çarë shkëmbin e egër e për t'i rrëmbyer pasuritë nëntokës.

Lush Baftia qe transferuar në sektorin e parë. Atje punët sikur çalonin, prandaj duhej dërguar një njeri me përvojë. Ishte Lushi që i bëhej ky nder.

Kur qe nisur atë ditë, unë i thashë jo pa qëllim:

— Ti po shkon në sektorin e parë. Unë atje u bëra inxhinier.

Lushi më vërejti buzagaz dhe tha me atë zërin e tij prej babloku:

— Unë jam i vetmi pinjoll i fisit Baftia që nuk vazhdoj shkollën, prandaj inxhinier do të bëhem. Kështu qemë ndarë atëherë. Pas dy ditësh shkova në

plazh, ta kaloja lejën atje. Kisha vendosur tē punoja diç-ka nga rivjera jonë e bukur. Më thoshte mendja se do ta bëja një gjë tē tillë, por tē gjitha punët që fillova m'u shndërruan në ca njolla tē pakuptim, që unë i bëja shuk gjithë nervozizëm, duke thënë me vete se kurrë s'do tē bëhesha dot një piktor pér tē qenë. Atëherë lija panoramat dhe vrisja mendjen se mos bëja ndonjë portret, tē Lush Baftisë pér shembull. Në këto mendime sikur shikoja fytyrën e tij, buzëqeshjen, trupin tërë muskuj, gjoksin e gjerë tē Lushit. Pastaj qëndroja ca minuta duke menduar dhe më thoshte mendja se ajo do tē qe puna më e lehtë pér mua, që isha një amator fillestar në pikturë. Atë fytyrë e kisha në mendje dhe në sy. Sikur e prekja me dorë. Pastaj, pse tē mos e themi? Edhe një surprizë e bukur pér Lushin, kur tē kthehesha nga plazhi.

Punoja dhe bisedoja me tē sikur isha duke i treguar portretin: «Ti, more Lush Baftia, mos u çudit dhe as mos u mburr tepër, se këto që ke bërë ti, këta vjet, nuk janë tē zakonshme, por as tē jashtëzakonshme jo. Se ti s'je i vetmi në minierë, more Lush!»

Më në fund e mbarova portretin. Bindja se e kisha bërë mirë zgjati pak kohë. Atë protret mund ta çoja në dhomë dhe ta shikoja, por kjo s'po më jepte kënaqësi. Përkundrazi, thosha se tē nesërmen punës edhe mund t'ia filloja nga e para. Duke kaluar nëpër rërën e nxeh të tē plazhit, shkova drejt e në atë sallonin e madh. Aty bë-hej kryqëzimi i tē gjitha korridoreve që tē çonin në mensë, në bufe, në sallën e lojërave, në lulishte e në këndin sportiv. Aty e vendosa portretin.

S'qe nevoja pér ndonjë prezantim nga ana ime. U mblodhën shumë kampistë. E panë. Ma lavdëruan do tē thoni? Disa po, e lavdëruan, por pati tē tjerë që më bënë t'ia filloja punës jo tē nesërmen, po që atë çast.

Pastaj Sotiri, vazhdon tē na tregojë se kur u kthyë

nga plazhi e mori portretin e Lushit në minierë që ta shikonin kolegët, ta shikonin punëtorët, edhe vetë Lush Baftia ta shikonte. Po Lushin s'kishte ku ta gjente. Thoshin se ai merrej me ato racionalizimet e tij për zhbllokimin e oxhaqeve, duke kursyer pesëdhjetë për qind të kohës dhe të forcave.

Këtë histori mësova unë nga Sotiri në atë qoshen «tonë» në autobus. Që atëherë s'më hijet nga mendja. Jam matur sa herë të shkruaja për të po mendja më rrinte gjithnjë edhe te Sotiri, edhe te Vera. Ata duhet të bënин më shumë, sidomos Vera. Vetëm portreti që kishte bërë Sotiri, pak më dukej. Një ditë vendosa të bisedoja shtruar me të. Për Lush Baftinë duhet shkruar, duhet... Sotiri më tha se miniera jonë ka dhjetëra si Lush Baftia. Pastaj ai ngriti sytë e më tha:

— Dëgjo, Qemal, mba'dite do të vemi te Vera.

Mbasdite ne i shkuam në shtëpi Verës, megjithëse unë nuk e dija përse. Si u takua me ne, ajo iku me vrap në dhomën tjetër. Unë e preka në gju Sotirin, duke e pyetur me sy se çfarë po kurdisej: «Mos më pyet — më tha. — Do ta thotë Vera me gojën e saj». — Mua s'më mbetej gjë tjetër, veçse të shikoja të papriturat e kësaj vizite në shtëpi të Verës.

Vera erdhi me një diçka në dorë. Zakonisht në vizita të tilla të presin me tabaka, po ajo, në vend të saj, kishte diçka të mbuluar me pecetë të bardhë. U afrua te ne, përkuli trupin ngadalë dhe, si i uli duart mbi tavolinë, tha: — «Tani hijjani duvakun», — dhe qeshi.

Sotiri kapi me dy duart mbulesën dhe... zbuloi veprën e parë të Verës në minierë. Ishte portreti i Lush Baftisë me pistoletë në gjoks duke çarë shkëmbin.

Unë pasqë sytë e Sotirit që shkëlqyen.

Kështu ndodhi me Lush Baftinë dhe me ne «tre artistë» e minierës.



## PISHTARË TË NDEZUR

Atë buzëmbrëmje, sipas urdhërit të vetë Shefqet Durgut Pashës, u mblohdhën për të raportuar të gjithë komandantët e reparteve. Kampi qe ngritur e nëpër çadrat shumëngjyrëshe qenë ndezur dritat. Mbi to vareshin ca tu-falakë që i tundte era e lehtë e malit. Pashai i dëgjoi me vëmendje oficerët tek raportonin dhe, si zakonisht, e mbante mbyllur njërin sy e frynte bulshitë. Si dëgjoi në heshtje deri në fund, ftyra e Pashait u çel. Dukej se kishte mbetur i kënaqur. Rrallë qe vendosur në fushim në një kohë aq të shkurtër ushtria e tij. Ajo ditë qe një shans i mirë për Pashanë. Kur dolën oficerët, Pashai diç foli me Abu Isanë, oficer shtabi rrëth të dyzetave, thaim, me ftyrë me prenjka e që shquhej për lajkat e tij dhe gjuhën brisk.

Abu Isai u përkul deri te gjunjët dhe duke lëshuar një «Aferim Durgut Pasha», doli i fundit nga dera e çadrës duke ecur me shpinë. Pashai e pa, shfryu nën hundë, po shpejt e harroi atë. Në çadër, nga dera e brendshme, shpalosi perden Xhaxhile beu, mjekërgjatë e i thinjur. Nën vetullat e trasha, në gropat e thella, lëviznin sytë e tij të vegjël. Ai u përkul duke e mbajtur një copë herë dorën në gjoks. Pashai ia bëri me dorë që të afrohej, ndërsa vetë afroi dorën te brezi i artë. Xhaxhile beu e pa dorën e Pashait që u fut në brez dhe s'po ia ndante sytë.

— Merre pér èndrrën, — tha Pashai.

Tjetri zgjati dorën duke u përkulur deri në tokë, dhe kur ndjeu peshën e monedhës, u përkul përsëri, aq shumë sa ajo i shpëtoi nga dora. Tringëllima e saj e bëri Pashanë të vështronte tokën. Dora e Xhaxhile beut, si panxhë, mundohej të kapte monedhën, thuajse do t'i fluturonte. Pashai e pa dhe qeshi me të madhe.

Në mëngjes e kishte thirrur Xhaxhile beun dhe i kishte treguar një èndërr... «Sikur isha duke qëlluar me top, — kishte thënë Pashai. — U tmerrova. Më doli gjumi. Ç'ne unë, Shefqet Durgut Pasha të qëlloj me top? — pyeta veten dhe s'më mori gjumi deri në mëngjes.

— Im zot, e dëgjuat krismën e topit? — e kishte pyetur Xhaxhile beu duke fërkuar duart.

— Jo, nuk e dëgjova, por ashtu m'u bë... — kishte shpjeguar Pashai dhe kishte pritur ç'do të thoshte Xhaxhile beu.

— Im zot, kjo èshtë shenjë pér lajme të mira. Sikur të kishit dëgjuar krismën e pushkës a të topit, atëhere èndrra do të qe e keqe, — ishte përgjigjur Xhaxhile beu. Kjo i kishte pëlqyer shumë Pashait, ndaj e shpërbleu Xhaxhilenë. Xhaxhile beu u largua dhe Pashai nisi të bënte ecejake nëpër çadër. Piste Abu Isanë, mirëpo Abu Isai po vonohej. Pashai filloi t'i ndërronte hapat më shpejt... Abu Isai u shfaq te hyrja e çadrës. Ai u përkul, bëri një hap më të djathë dhe paraqiti ushtarin që do të ruante çadrën e Pashait. Pashai e vështroi nga koka te këmbët dhe, pasi tundi kokën, ushtari u largua. Pas tij doli dhe Abu Isai. Ai mori urdhrin: «Nesër në tre të sahatit i pres.»

Përjashta sundonte errësira e natës. Abu Isai me tre kalorës u nisën në një drejtim që e dinin vetëm Pashai dhe ai.

Trokëllima e kuajve nëpër natën e errët përzihet me oshëtimën e lumbit që rrëzohej nëpër kataraktet malore.

\* \* \*

Mëngjesi ishte i vrenjtur dhe mjegulla kishte rrafshuar grykat e luginat. Në kamp vazhdonin preqatitjet përmarshimin e gjatë. Në çadrat e shtabit kasnecët niseshin për në drejtime të ndryshme dhe ktheheshin me një frymë. Mbi çadra kishte rënë një shtresë e bardhë bore që kishte filluar të shkrihej duke lënë mbi to njolla bojë kafe të hapët. Tufalakët prej mëndafshi tashmë qëndronin si mjekra të lagura.

Durgut Pasha pinte kafenë.

Sahati donte edhe njëzet minuta të shkonte tre allaturka. Pashai, si asnjëherë tjetër, atë ditë qe veshur me rroba krejt të reja, tërë shkëlqim dhe në brez mbante një thikë të futur në një mill të florinjtë. Thoshin se ajo thikë kishte një histori, por askush s'e dinte atë histori.

Pas pak u dëgjuan hapa të shpejtë kuajsh. Pashai u ngrit në këmbë, iu afrua dritates, lëvizi pak perden dhe midis mjegullës që luhatej ngadalë ai mundi të dallonte Abu Isanë dhe kalorësit. Abu Isai u hodh me shkathtësi nga kali e duke mbajtur dorën mbi millin e shpatës vrapi po drejt çadrës, ku e priste Pashai me orë në dorë.

Abu Isai qëndronte i përkulur para Pashait.

«Këtë e fitove, Abu Isa, — tha Pashai me mend.

— Të shohim ç'do të na thuash tani».

— «Erdhën,» — tha Abu Isai dhe ngriti kokën njëherësh me buzëqeshjen e tij lajkatare.

— Erdhën?! — pyeti Pashai i habitur dhe në ballë iu nderën rrudha të thella.

— Po, im zot, erdhën...

— Silli pa vonuar brenda!

Abu Isai nderoi dhe doli.

Nga dera e brendshme erdhi kryeveqilharxhi me dy

oficerë shtabi, të cilët qëndruan në këmbë përkrah njërit-tjetrit.

Nga jashtë hynë brenda njëri pas tjetrit dy kryetarët e fiseve, paria e atyre anëve. Kur hyri i pari në çadër, Abu Isai me zë të lartë foli:

— Rrahim Mulla Sadik, i pari i Logajve, — pas kësaj Abu Isai u përtyp, thuajse i vinte zor të prezantonte personin tjetër që hyri në çadër.

— Po ky, kush është, Abu Isa? — pyeti Pashai, e, si buzëqeshi me zor, drejtoi gishtin nga dera e çadrës dhe ia nguli sytë një rreckamani, që bënte dallim nga i pari, i cili ishte veshur me qyrk.

Abu Isai s'arriti të përgjigjej.

— Jam Prelë Pali i Merturit, — u dëgjua një zë i plotë dhe krenar.

Pashai e pa të arsyeshme të ndërronte bisedë, duke i dhënë ftyrës tjetër pamje. Një tabaka e argjendtë zuri të endej nëpër çadër. Pashai fliste:

— Allahu ka bërë emër, miqtë e mi, që ne të flasim e të merremi vesh. E pra, ju thirra ju, o trima...

Pashai shetiti shikimin mbi të parët e fiseve. Rrahim Mulla Sadiku pinte duhan me një cigarishte argjendi, të gjatë, me pipë qelibari të verdhë dhe vështronët këmbët e tij. Prelë Pali i Merturit kishte hedhur njëren dorë mbi gju e dukej sikur rrinte mbi gjemba.

Kryeveqilharxhi me oficerët e shtabit rrinin si të ngrirë.

... — Kërkoj nga ju, — vijoi Pashai, — rrugë të lirë për në drejtëm të Drinit. Dua që ushtria ime të kalojë pa gjakderdhje. Këtë e keni në dorë ju dhe unë. Unë dhe ju, — përsëriti ai për të dytën herë. — E në qoftë e shkruar të jemi të një fjale, allahu do të na i shpërbujejë të mirat në këtë tokë...

Kaq tha Pashai dhe priti përgjigje.

Rrahim Mulla Sadiku, siç rrinte këmbë mbi këmbë, shkundi cigaren mbi tabanin e opingës. Prela i Merturit, si i pa të gjithë me radhë, ia nguli sytë Pashait.

— Jo. Ne këtë herë s'mundemi të ta japim fjalën, Shfaqet Durgut Pashë, — thanë të dy.

Pashai dinak i pa buzagaz e, pa u ngutur, shtoi:

— Ju si të doni. Unë nuk dua gjakderdhje. Edhe mbrapsht mund të kthehem, por atë që s'e bën zoti emër, s'e bëj...

Një copë herë në çadër sundoi heshtja.

Dy prijësit ishin të vendosur në fjalën e tyre.

Edhe Pashai në të tijën.

Ata u ngritën dhe dolën.

Kryetarët e fiseve hipën në kuaj dhe ikën. Pashai urdhëroi Abu Isanë që t'i ndalonte te bregu i lumit e t'i sillte përsëri në çadrën e tij. Abu Isai u largua me vrap i ndjekur nga tre kalorës... Qielli nxinte nga retë e ngarkuara me shi.

Kur u kthyen përsëri në çadër, Pashai, si gjithnjë, buzagaz foli:

— Më falni, zotërinj, që ju ktheva nga rruga për një gabim të vogël tonin.

Kaq tha dhe ngriti dorën lart.

Kryearkëtari i thesarit të Pashait, që bënte edhe punën e administratorit të plaçkës së luftës, iu afrua të parit të Logajve me tri lira dhe u mat t'ia lëshonte në dorë. Ky i fundit e largoi atë. Kryearkëtari vështroi Pashanë, pastaj iu afrua Prelë Palit, po edhe ky nuk pranoi. Kryearkëtari u përkul pastaj përpara Pashait. Pashai i tha:

— Tri lira nuk u mjaftojnë zotërinjve as për të mbathur kuajt... Ç'janë ato?!

Kryearkëtari, administrator i plaçkës së luftës, u zgjati nga një qese mbushur plot me lira. I pari e mori pa bërë zë. I erdhi radha Prelë Palit. Ky u mendua një çast

dhe, kur pa se i pari e fshehu qesen e tij, zgjati dorën, mori një lirë dhe e futi në gojë. Pashai s'po ia ndante sytë Prelës, as lirës turke që shkëlqente midis dhëmbëve të tij të bardhë. Fytyra e zeshkët e malësorit, ashtu tërë muskuj, iu duk si statujë bronci.

— Ka besë fjala jote, Pashë? — pyeti Rrahim Mulla Sadiku.

Pashai ngriti dorën.

Kryearkëtari i hodhi edhe një qese tjetër.

— Ushtrinë tuaj s'do ta sulmojë askush, — siguroi i pari i Logajve dhe mori qesen e dytë.

Prelë Pali ende shtrëngonte me dhëmbë lirën turke. Rrahim Mulla Sadiku e vështronte me inat dhe priste me zemër të ngrirë se mos ndizej sherri aty në çadër. Prelë Pali u ngrit në këmbë dhe, si ia nguli egër vështrimin Pashait, pështyu në drejtëm të tij monedhën e mallëkuar, mbi të cilën kishin mbetur shenjat e dhëmbëve të tij.

— Dije, Pashë, se treqind qese nuk e blejnë një shqiptar. Treqind djem më presin përjashta. Ata s'blihen as shiten me florinj, o Durgut Pashë. Pas çdo guri e pas çdo bregu do të na gjeni me armë në dorë! — Kaq tha dhe doli.

Pashai u zbeh në fytyrë.

Në kamp u dha sinjali i alarmit. Përtej lumit u dëgjuan zëra dhe të shtëna pushkësh. Mjegulla kishte zënë të rrallohej.

\* \* \*

Prelë Pali, si kaloi kampin turk, u fut në një prozhëm. Ekte me hap të shpejtë dhe dukej mjaft i egërsuar. Nuk i hiqeshin nga mendtë fjalët hileqare të Pashait: «Unë s'jam për gjakderdhje... Edhe mbrapsht mund të kthehem, por...» — dhe i rrinte në sy Rrahim Mulla Sadiku duke marrë qesen me florinj. Shtrëngonte dorezën e

kobures sikur të donte me këtë veprim të mposhtte zemërimin e madh dhe para sysh i dilnin fytyrat e trimave të tij.

— «Shko, Prelë Pali, i thuej Pashës se do të kalosh vetëm mbi trupat tanë, mbi trojet tona të rrafshueme. Nam të zi Shqipnisë s'kemi me i qitë për së gjalli, o burra. O do të fitojmë, o do të vdesim me nder!»

«Kjo tokë e ky vend asht yni».

«I thuej Pashës mos na prekë nderin e të parëve, se derdhet gjaku deri në gju!»

Kur ishte ndarë me trimat e tij, Prelë Pali u kishte lënë porosi: «Bëni gati ato llogoret në Qafë të Imshtës e në Kashnjet, në Grykë të Egër e në Leqe të Kalit.»

«Po vijmë me ty nja dy a tre djelmosha», — i kishin thënë.

«Nuk asht nevoja të vini. Një trim që s'ruen veten edhe armikun s'di ta luftojë mirë. Ma mirë një llogore gati, se një trim me mue», — dhe ishte nisur. Askush s'kishte dyshuar në trimërinë e në besnikërinë e tij.

\* \* \*

— Mirë se ju gjej, burra!

Ata u ngriten në këmbë dhe u përgjigjën si në kor:

— Mirë se vjen, o Prelë Pali.

— Besa të egër m'i paske sytë, o bir, — foli më plaku.

Prelë Pali u kthyte nga plaku e, si u hodhi një vështrim trimave me radhë, tha:

— E çka tjetër, o baca Mark, veçse etjes për ta mbrojtë këtë vend me nder. — Pastaj heshti një çast dhe buzëqeshi duke vështruar plakun.

Rreth tij u mblodhën të gjithë sa ishin, burra të moshuar e pleq, djem të rinj shtathedhur, me gjokse të zbuluar, me fytyra të rreshkura nga dielli e nga shqota. Prela kishte hipur mbi një gur e fliste.

— Jemi vetëm, burra. Kryetari i fisit të Logajve u shit me lira te turku.

Mark Marku i Thepit u ngrit në këmbë.

— Çka po flet, o Prelë Pali, a je në mend?

— Baca Mark, — foli Prela, — edhe ju, o trima, po ju them atë që pashë e ndigjova vetë. Ne jemi vetëm. Shefqet Durgut Pasha do të niset në mos sot, nesër në drejtimin tonë. Rrahim Mulla Sadiku na la vetëm. Pra si thoni të bajmë, o burra?

— T'ia djegim kullat, o Prelë Pali.

— Mirë thotë Deda. Baca Mark, edhe ti, o Prelë Pali, i duhen djegë kullat atij qeni.

— Nuk kemi kohë për vëllavrasje, o burra.

— Bajraktarin e shitun s'e kemi vëlla.

— Mos u ngutni, burra... Ju duhet të dini se bajraktari ka me i gënjiye malësorët, pra, ju e kuptioni që kjo punë do kohë dhe mend. Veç nji gja duhet ba, malësorevë u duhet futë në vesh tradhtia e tij e madhe. Pastaj...

— Të nisim njerëz në atë fis e për çdo tym e për çdo derë të çojmë fjalë. Të çojmë bile pa vonue, — foli baca Mark.

.....

*Shkel kuçedra tokën gurë,  
Prej Kosove der'në Merturë.  
Durgut Pashë, pse m'je hutue,  
Trimat kurr' s'kan me u mbarue,  
Kan' dalë sot, o, për me luftue.*

.....

\* \* \*

Gjatë natës u dëgjuan të shtëna. Në disa pikë, ku ishin grumbulluar forca të shumta dhe në prapavija u du-

kën zjarre. Gjenerali turk kishte ndërtuar formacionin e marshimit të ushtrisë së tij në atë mënyrë që të mos i dëmtoheshin shumë forca njëherësh. Që në vogëli qe njo-hur me trimërinë dhe guximin e shqiptarëve dhe vlerë-sonte sidomos befasinë e veprimeve. Për këtë qëllim u mor vetë me organizimin e zbulimit dhe në pararojë të kolonës së gjatë dërgoi jo vetëm përforcime, por urdhë-roi të dërgoheshin atje ushtarë të pregetit dhe oficerë të zgjedhur. Gjatë natës dëgjoi raportin dhe nuk u çudit aq nga numri i të vrarëve sesa nga të dhënat e zbu-luesve të tij: «Shqiptarët janë zhdukur pa lënë gjurmë. Si duket ata janë arratisur pyjeve të dendura, larg rru-gëkalimit tonë, i cili ndodhet krejt i lirë».

Mëngjesi ishte i vrenjtur. Binte shi. Gurgullima e lu-mit këndonte një ninullë të egër, që atij i dukej sikur i ndillte një gjumë vdekjeje.

Nga Qafa e Kores erdhi një korrier që raportoi:

«Brenda pak minutash u shkatërruan nënrepartet që prinin dhe forcat e tjera u tërroqën në panik. Rruga ishte aq e ngushtë, sa nuk mund të lëvizje në kolonë as me dy kilometra në orë. Në konfuzion të plotë, kur po tërhiqeshim, në drejtimin tonë, sikur të shembeshin malet, na fluturuan mbi kokë gurë, drunj, trungje. Hapëm zjarr po efekti i tij qe i paktë. Nuk dallonim këmbë njeriu, s'dëgjoni asnjë zë dhe na dukej se çdo gjë vinte nga qielli. Jemi të mendimit se futja e të gjithë kolonës në këto labirinte do të jetë fatale».

— Mjaft më me fatalitetin tuaj! — bërtiti e përplasi dorën mbi hartën e shpalosur gjenerali turk.

— Dëgjo, — vijoi Pashai pas pak duke zgjatur dorën drejt qiellit me gishtin tregues ngritur lart. Dukej i trondtitur, mjekra e hollë i dridhej mbi gjoksin e gjerë ku shkëlqenin gradat e dekoratat. — Të vazhdohet marshimi dhe të shpartallohen arnautët rrebelë me çdo kusht. De-

ri në mëngjesin e ditës tjetër të më raportohet zbatimi i këtij urdhri!

Korrieri doli. Pashai ra në mendime... Përjashta ve-sonte një shi i imtë...

\* \* \*

Pas mesit të natës, Prelë Pali vetë i tretë po kalonte në pritën e fundit të malësorëve. Bënte ftohtë. Lumi i vogël gurgullonte mbyturazi në rrjedhën e tij. Ushtonin malët. Fshatrat përreth kishin rënë në një qetësi të thellë. Donte edhe pak që të agonte. Kishin vendosur që të kontrollonin gjithë pritat para se të agonte. Por atë çast u dëgjuan të shtëna në krahun e majtë andej nga fshati. Ndaluan. Të shtënat u përsëritën.

— Po këto pushkë ç'janë? — pyeti Prelë Pali.

— Kush po e di!...

— Të kthehem! — tha dhe mori udhën me vrap përpjetë malit i ndjekur nga Dedë Vata. Të tjerët i urdhëruan të rrinin në pozicion dhe të kishin kujdes.

Turqit gjatë natës kishin lëvizur në fshehtësi të mëdhe nëpër një rrugë dhish, kishin kaluar lumin nëpërmjet një ure të vogël me trarë që të mund t'u dilnin malësorëve në shpinë dhe t'i fusnin midis dy zjarresh...

\* \* \*

Malësorët e fisit tjetër, sa dëgjuan për tradhtinë e bajraktarit, dhanë alarmin e u mblohdhën në kuvend. Caktuan prijësin e ri e u ranë turqve. Turqit kujtonin se më në fund i kishin vënë shqiptarët ndërmjet dy zjarresh, por u gjendën vetë të rrethuar.

Nga Qafa e Kolçit u dëgjuan të shtënat e topave. Tri

orë e gjysmë luftë. Forcat turke që mundën t'u dilnin në shpinë gjatë natës ishin ngujuar në labirintet e shkëmbinjve deri në mëngjes.

Turqit e kuptuan që ishin të rrethuar dhe filluan të largoheshin nëpërmjet fakes së përtejme. Po edhe atje s'u shpëtuan pushkëve të malësorëve. Paniku në kampin turk u shtua. Lëndina ku qe ngritur kampi i tyre, gjatë natës u sulmua nga Pjetër Leka vetë i shtatë. Veç të vrarëve ata kishin marrë rob edhe një oficer turk, ndërsa një tjetër e kishin lidhur pas një ahu aty, përballë pritës...

Ndërsa turqit tërhiqeshin në panik, Prelë Pali me shokë i ndiqnin këmba-këmbës.

Dëgjoheshin shpërthimet e topave si bubullimat përmot të keq.

Prelë Pali s'iuh nda deri sa turqit ngritën flamurin e bardhë.

*Çka po thotë Pasha me topa?  
«Lavdi m'thur sot mue Evropa.»*

*Kthehu, Pashë, kah ke ardhë,  
N'krye t'kolonës flamur' i bardhë.*

Kur po nisej kolona e Durgut Pashës e mundur me turp, u dëgjua zëri i malësorëve që këndonin këngën e kushtimit, që kishte qenë ndër shekuj si himn që thërriste shqiptarët përmes mbrojtur atdheun me pushkë në dorë.

Në fshat u ndezën zjarret e para. Lumi gurgullonte mybuturazi, ndërsa era largonte tutje oshëtimën e luftës, që la pas trokamën e hapave të një shpurë kalorësish që largohej e largohej gjithnjë kur po agonte ditë në kodër të Palçit.

## «K A R A K O L L I»

Nuk kisha provuar në jetën time një zgjim të tillë. Ndonëse i kisha hapur sytë më tepër se zakonisht, nuk shikoja asgjë dhe më dukej se isha qorruar. Kështu që m'u deshën disa minuta, duke rrrotulluar sytë rrreth e rrrotull, ku çdo gjë nxinte, që të mblidhja veten dhe të mund të dalloja, në atë errësirë që më rrrethonë, dëborën. Trupin e ndieja të mpirë nga të ftohtët, ndieja dhembje të tmerrshme sidomos në kokë e afër qafës. Dora më ngjante si një degë lisi e rrëzuar. U mundova t'i hapja e t'i mbyllja disa herë me radhë sytë. Çdo gjë rrreth e rrrotull më dukej mospërfillëse: errësira, të ftohtët, dëbora, uji që gurgullonte te këmbët e mia në atë humbëtirë të thellë. U mendova një copë herë. M'u kujtua veshtulli, tufa e vogël e dhive dhe unë duke u kacavjerrë nëpër degë për t'u hedhur gjethë. Ky mendim më bëri të trishtohesha. M'u duk vetja si një veshtull i vërtetë. Duke vështruar qiellin me sytë e ngrirë, befas m'u shfaq një figurë e vagëlluar, që pak nga pak filloj të më qartësohej. Munda të dalloja një yll në qiellin e vrenjtur, u gëzova dhe provova të lëvizja dorën... E lëviza përsëri. E lëviza deri afër këmbëve. Ajo lëvizje sikur i jepte jetë trupit tim. Pak nga pak po më qartësohej mendja. U mata të thërrisja por u pendova, jo vetëm se gryka ime m'u duk si të ishte prej hekuri, po kjo do të tregonte dobësi dhe një zakon të tillë

as unë s'e kisha as shokët e mi. E afrova ngadalë drejt fytyrës pushkën dhe, kur tyta e ftohtë më takoi hundën, e ndjeva të fortë erën e barutit dhe për herë të parë gjaku lëvizi në trupin tim të mpirë me aq forcë, sa u çuditai e u gëzova njëkohësisht. Era e barutit të djegur në tytën e pushkës po më zgjonte nga ai gjumë i thellë në mes të boraës, errësirës, humbëtirës së pyllit. U mundova të kujtoja betejën e zhvilluar. «Gjermanët...» Po gjermanët kishin zënë kodrat, pastaj u tërhoqën drejt brigjeve të lumit... Këto më ngjanin si kujtime të harruara, a thua se s'kishin ndodhur atë natë, po vite më parë

«Përpara shokë, t'i kapim të gjallë! Në mos paçim fishekë, në mos paçim bajoneta a thika, në sulm, o shokë, me dhëmbë ta mbysim armikun... Në sulm, o shokë... Në sulm, o vëllezër! Përpara, partizanë!»

E unë i dhashë trupit me aq forcë, sa m'u duk se mesi im i ngrirë do të thyhej si copë e trashë akulli. Ishte zëri i komandantit ky që më kumboi në veshë. Ishte pamja e asaj beteje buzëmbrëmjen që shkoi, në brigjet e lumit, trup më trup, fyt më fyt e thikë më thikë. «Ku janë shokët? Po komandanti, komisari? kompania ime ku do të jetë vallë? Ku janë tani në këtë natë të errët, në këtë natë të ftohtë? Kush fitoi? Ne? Apo... Ne... ne... ne...» — I dhashë trupit e duke u mbajtur te pushka u ngrita në këmbë. Për një çast m'u duk se trupi im qëndronte jo mbi këmbë po mbi një diçka të mpirë, të ftohtë, krejt të akullt. Eca, a më mirë munda të çapitesha vetëm dy-tre hapa dhe ndalova. S'vazhdoja dot më tej. Qe janar dhe bora e madhe që kishte rënë i kalonte të pesë pëllëmbët e qe rrasur e shtrënguar fort mbi tokë si të mos donte të shkulej në këtë dimër lufte. Përpara kisha lumin. Të futem nëpër lumë? Kështu mendova, pastaj pyeta veten: Cilën rrugë të ndjek? Për mua s'kishte drejtim të njohur në atë errësirë të akullt. Dhe bëra hapa përpara. Këmbët e mia të mpira m'i njomte

diçka. Mendja më rrinte te shokët dhe çuditesha si isha ndarë prej tyre. Koka më dhembte fort e po më merreshin mendtë. Në qafë flokët më qenë ngrirë e më qenë zgjatur me strehë akulli, sa herë lëvizja i dëgjoja tek thyhe-shin me zhurmë të thatë. Uji filloj të më ngjitej gjithnjë e më tepër drejt gjunjëve, mesit, ndaj u mundova të ecja sa më shpet drejt bregut që lartësohej nëpër shkëmbinjtë e thepisur. Uji i ftohtë më dukej i ngrrohtë e sikur po m'i shpinte këmbët e ngrira, ndaj ecja më i lehtesar, duke mbajtur pushkën hedhur për së gjeri. Vazhdoja të ecja e s'dija për ku. S'dija si të jepja shenjë. Për të thirrur as që kisha ndër mend, aq sa kisha ndër mend të dorëzohe-sha. Ngrita kokën drejt qiellit dhe kërkova atë yllin «tim», po mezi e dallova e m'u duk se po ecte, po nxitonë. Dola nga uji. Qëndrova rrëzë një shkëmbi duke vështruar lu-min si fryhej gjithnjë e sytë më vajtën te qafa e malit, ku m'u bë se dallova në qiell shenjat e një agimi që më ngroru zemrën. Vështroja qiellin që hapej ngadalë dhe dëgjova një zë që nuk më dukej larg e që më të rrallë shpërthente. «Mos është ndonjë shok i plagosur? Kushedi». Po sikur vërtet të qe kështu, çfarë mund të bëja unë, që s'lëvizja dot? Kështu prita derisa qielli u hap e unë munda të dalloja lisat për gjatë bregut të lumit, ndërsa në krahun matanë dallova brigjet e thepisura që binin pjerrtazi mbi lumë, të ndara me ca kurrise të gurta e të mbuluara nga bora. Ato fillonin të ngushta, pastaj sa vinin e zgjerohe-shin, deri atje ku valët e lumit rrithnin brigjet e gurta dhe shkrinin borën duke shkëputur copëra të mëdha të cilat në fillim notonin siç ishin, të bardha, pastaj skuqeshin gjersa valët i përpinin në gjirin e tyre. Zhurmat e valëve të lumit më erdhën më të qarta. Eca përsëri. Duhej të kërkova shokët. Kështu ia vura syrin asaj lugine midis dy kurriseve të gurta. Vetëm nëpër atë luginë unë mund të ngjitesha duke çarë me zor borën e duke u mbajtur pas

gurëve, shkëmbinjve. Pjerrësia ishte e madhe dhe në filim unë u stepa përparrë saj. Mjaftonte një shkarje dhe pa dyshim unë do të rrrokullisësha me dhjetëra metra në-për shkëmb, atëherë ato valët e lumi të egërsuar do të më rrëmbezin si ato copërat e borës së ngirirë brigjeve. Përsëri dëgjova zëra. Ato nuk ishin thirrje të zakonshme po ulëritje të vërteta. Qëndrova në një grumbull gurësh që ngjanin me një karakoll të vërtetë. Rrobat e mia të lagura tashmë ishin ngirirë e bërë si të qenë prej mushamajë.

Nga ai «karakoll» i bardhë vështroja gjithë rrugët, shtigjet, luginat e malit dhe mund të zgjidhja një rrugë të sigurtë drejt fshatit më të afërt. Isha i bindur se rrezet e diellit të asaj dite të vrenjtur nuk mund ta shkrinin trupin tim, megjithatë qëndrova në «karakollin» e bardhë duke vështruar. Nuk kaloi shumë kohë dhe dallova jo më larg se një shenjestër pushke një diçka të zezë. Ajo m'u duk në fillim një figurë mjaft e vagëlluar, që më pas jo vetëm m'u qartësua po pas saj munda të dalloja edhe tre, katër, pesë, gjashtë...«Gjermanë?» Ishte një skuadër. Ata lëvizën njëri pas tjetrit. M'u kujtua kur kisha dalë për herë të parë për gjah. Isha i ri. Atë ditë më patën dhënë pushkë për herë të parë. I zumë pritat në anë të pyllit. Dy-tre fshatarë u futën në pyll për të trembur ujqit. Ne të tjerët kishim zënë vendet. Unë isha në një shesh, fshehur pas një guri. Zemra më rrihte fort. Kisha emocion, por duket edhe frikë. Pyesja veten: «Po sikur të më vërsulen mua ujquit? Po sikur të jenë shumë?» — Dhe dëgjoja të rrahurat e zemrës në kraharor. Ujquit dolën papritur nga pylli. Ç'të shikoja! Nëntë ujq! Shokët i kisha larg. Pushka ime... Ah, ajo pushkë e vjetër! Mora nishan dhe qëllova një herë. Vështrova me shpresë se mos kisha vrasë ndonjë. Asnjë. Ujquit, nga krisma e pushkës, u larguan e u shpërndanë në krah të njëri-tjetrit po duke vazhduar rrugën drejt meje. Tërhoqa shulin për t'i vënë fishek tjetër,

kur ç'të shikoja! Ah, ajo pushka ime e vjetër! Ishte bllokuar keq. Gëzhoja i kishte mbetur në fole. Ç't'i bëja? Ujquit vinin drejt meje. Shokët ishin larg. Të fërshëlleja? Të thërrisja? «Jo, jo», — thashë me vete dhe u ngrita në këmbë. Fillova ta përplasja qytën e pushkës pas gurëve, por ajo gëzhoja e mallëkuar nuk lëvizte nga vendi. Ujquit më afroheshin. Pa dyshim që do të më kishin copëtar sikur të mos nxirrja gëzhojën me majën e thikës që kisha në brez dhe të qëlloja...

Oh, ç'u treta në kujtime këto caste, kur po më duhet të vendos pa humbur kohë. Ata janë shtatë, unë një. Ata s'më kanë parë. Ndoshta as që kanë për të më parë, kurse unë... Por...

Lëviza këmbën, dorën, pushkën... gishtin, dhe kur u binda se ata ende më bindeshin me besnikëri, zura vend midis atyre gurëve që përbënë atë karakoll të bardhë. Ujquit e gjahut tim të parë s'më hiqeshin nga mendja. Shtrëngoja pushkën me duart e ngrira. Mora shënim dhe u çudita me sytë e mi që vështronin aq mirë nëpër fletët e shenjestrës. Qëllova tri herë me radhë. Gjithë skuadra siç qe u tret në borën e rrugës. Për disa minuta më pushtoi ankthi i pritjes. S'dija ç'kisha bërë dhe ç'duhej bërë. Të qëndroja apo të largohesha luginës së fshehur, larg pushkës së armikut? Vendosa të qëndroja. Pas pak filloj të frynte veriu i egër aq shumë, sa, tek provoja të merrja shënim, sytë më mbusheshin me lotë. Duke vështruar nga të gjitha anët, munda të dalloja në të majtë e në të djathtë lëvizje. Me sa dukej skuadra e ushtarëve gjermanë ishte shpërndarë në dy ose tri drejtime. Më kishin rrethuar nga të gjitha anët. Vetëm udha përmes luginës kishte mbetur e lirë. Prapë m'u kujtuan ujquit. Kur m'u sulën ujquit, unë qeshë ngritur në këmbë. Dhe tanimë s'e kisha ndër mend të tundesha nga ai «karakoll» i bardhë... I vështrova përsëri... katër. Ishin katër që më afroheshin nga të dyja

anët. «Vallë më shikojnë? Ç'më duhet. Unë i shikoj. T'i qëlloj? Jo, të pres edhe pak. Hej, «karakoll» i bardhë! Gjaku im le ti skuqë gurët e tu, vetëm ata mos të shkelin të gjallë». Qëllova dhe qëllova në shenjë disa herë me radhë. Në të dyja anët më fërshëllenin predhat pas rikoshetave që binin mbi gurët e «karakollit» tim. Dhe unë bisedoja me ata gurë, bisedoja me pushkën time dhe qëllaja armiqtë që kisha rrëth e rrëth.

Të shtënat në krahun e majtë u shuan. Unë qëndrova për një çast dhe kontrollova armën. Ishte plot. Kontrollova gjerdanin tim. Ishte bosh. Pesë të shtëna. Kaq. Vendosa të prisja dhe të qëllojja radhë, pastaj t'u ngrihesha si ujqve me thikë. M'u bë sikur dëgjoja zërin e komandanit: «Përpara, shokë, t'i kapim të gjallë! Në mos paçim pushkë, në mos paçim bajoneta e thika, në sulm, o shokë, me dhëmbë t'i mbysim!...»

Qëllova edhe tri herë të tjera radhazi, pastaj një herë dhe një herë dhe çdo gjë m'u tret si në èndërr të një gjumi të rëndë. As dëgjoja të shtëna, as... Mbi borën e bardhë të «karakollit» tim bëri vijë një shirit i kuq gjaku. Një plumb më kishte marrë pa e kuptuar e nga gjoksi im rrithet gjak.

Pas njëzet e katër orësh unë munda të hapja sytë. Te koka më rrinte një infermiere. Ajo më pa, buzëqeshi dhe doli me vrapi nga dhoma. Pas pak aty erdhën komandanti e komisari i brigadës dhe buzagaz më shtrënguan duart. Ata kishin qenë aty afër në ndjekje të gjermanëve, kur unë kisha qëlluar me armë. Shpejt kishin rënë në gjurmët tonë duke ndjekur gjermanët këmba-këmbës. Aty më kishin parë duke luftuar e më kishin gjetur duke luftuar...

Ngrita sytë, pashë përqark dhe ende nuk e besoja se isha aty, midis shokëve, dhe jo atje, në «karakoll», midis bardhësisë verbuesë të dëborës së ngrirë. Komandanti

sikur e lexoi hutimin në sytë e mi dhe më tha: «Ne u tërhoqëm, Lekë, vetëm ti kishe mbetur atje, i vetëm. Si ndodhi? Përse e bëre këtë?» — Tunda kokën dhe e pashë shokun drejt në sy. Iu përgjigja: «Kishte rrezik, shoku komandant! Praparoja u tërhoq shumë vonë. Mbrojta tërheqjen e saj. Aty...»

Komisari ngriti me kujdes një cep të batanijes dhe ma hodhi përsipër. Po mua më mundonte një pyetje... Komisari më pa, buzëqeshi dhe siç duket e kuptoi kureshtjen time se pëshpëriti: «E vumë re shpejt mungesën tënde. Thamë se mos kishe mbetur rrugës. Pastaj dëgjuam të shtenat. «Është Leka, — më tha komandanti, — ia njoh këngën e belxhikut». — U bëmë një rrethim të bukur nemceve. Tani e kanë lënë vrapin patjetër në kazermat e Babicës. Të gjetëm aty në «karakoll», tërë plagë. Tërë akull. Dikush nga vajzat partizane të quajti me krenari «karakolli i hekurt». Ja, kështu, o Lekë trimi!»

## DIELLA E BREGLOGUT

Ne u ngritëm shumë shpejt. Zakonisht në fshat njërejzit ngrihen herët nga gjumi, po unë atë ditë mund të kem qenë i pari që e prita mëngjesin në dritare. Sapo isha kthyer nga ushtria dhe më kishte marrë malli për fshatin tim. Ato që pashtë e dëgjova më çuditën. Sa shumë ndryshime ishin bërë për një kohë kaq të shkurtër. Majat e maleve u përflakën nga rrezet e para të diellit, atje ku ende ortiqet e dëborës vezullonin gjithë shkëlqim. Fshati dukej sikur ende flinte. Nëpër dritare ndizeshin e shuhe-shin drita e nga dyert dilnin njerëz me vegla nëpër duar. Dola edhe unë. Një aromë e këndshme m'u përplas në gjoks. Lulet nëpër pemë kundërmonin.

Kisha vendosur të shkoja në punë që atë ditë. Atje do t'i takoja të gjithë e me të gjithë do të bisedoja shtruar. Më caktuan në brigadën e ndërtimit dhe, pasi vështrova shokët e punës, thashë me vete se do të kishim si objekt pune ndonjë stallë të re. Po kur më thanë se do të punonim në pallat, u çudita. Të them të drejtën, s'më kishte shkuar ndër mend se kishin filluar edhe në Breglog një ndërtesë me projekt «si ato të qytetit» dhe ta quanin me një emër të madh, «pallat». Ndërtesa dykatëshe dukej që larg atje në mes të fshatit. Mbi të valavitej një flamur i kuq. Aty do të strehoheshin katër familje. Kur ishin hapur themellet e ndërtesës së re, sekretari i byrosë së Partisë kishte mbaj-

tur një fjalim përpara kooperativistëve që ishin mbledhur si në festë: «... po hapim këtu themelet e fshatit të ri, që do të jetë qyteti i ardhshëm. Këtu, midis maleve, në një të ardhme të afërt do të kemi shumë qytete të tillë...» — Dhe kishte filluar kënga e vallja. Me këto biseda kalonim rrugës së fshatit. Një rrugë makine e shtruar me kalldrëm dhe që kishte gropë të shumta. Vende-vende si thumba të mprehtë kishin dalë mbi sipërfaqe ca gurë që të kujtonin anët e brendshme të zinxhirit të traktorit. Në këtë rrugë po kalonim ne, duke ndjekur pas kolonën e grave dhe vajzave që përbënин «Brigadën e të rejava». Një makinë Zis frenoi midis tyre e ato i hapën rrugën duke kaluar në të dyja anët. Shoferi, një djale rreth të njëzeteshtatave, esmer, me flokë kaçurrelë, i bëshëm nga trupi, kishte nxjerë kokën dhe njëren dorë mbi derën e makinës, vështron-te buzagaz e përshëndetëj me të gjithë. Pastaj, kur një nga vajzat (ishte një shtathedhur, me flokë të gjatë, me fytyrën gjithë nur e me sy të qeshur), ndaloi përpara makinës, buzëqeshi dhe iu afrua derës, dëgjova këtë bisedë:

— A u ktheve, o LuIash Bardhi?

— U ktheva, Diellë, u ktheva.

Diella po buzëqeshte, duke vështruar Lulashin e m'u duk se shkëlqimi i fytyrës së saj feksi me shpejtësinë e dritës mbi fshat.

— Po pse, gjithë natën qëndrove ti në pyll e s'rregulllove dot makinën? Eja në brigadën time, o Lulash Bardhi, se...

— Mos e thuaj atë fjälë, o Diellë. Makina ime nuk fle kurrë në rrugë pylli, as në rrugë fushe. Kam punuar gjithë natën me aksionistët e Çukës e besa ti, o Diellë, me gjithë brigadën s'ma dilni dot mua me punë... — Kaq tha dhe makina shkau me shpejtësi.

Brigada e të rejava kishte qenë më e prapambetura në kooperativë. Pjesëmarrja e paktë, pa le puna. «Punë

grash», — kishte thënë një fanatik, «Duhet bërë diçka, — kishte thënë një konservator, — t'u caktojmë brigadier një burrë». — Dhe kishin caktuar Nuzin. Nuzi, dy metra i gjatë, dyzetvjeçar, që s'kishte parë kallo në duar, shkonte në mërgjes, jepte urdhra, bërtiste dhe, pasi ulej, pinte duhan derisa mërzitej. Kur vinte Nuzi, binte edhe çanga. Fillonte «mbledhja», gratë i kalonin me radhë si në shtrungë e Nuzi me atë lapsin që e mprihte vetëm një herë në muaj, shënonë ca shkarravina në fletoren e tij të zhubbrosur. Gratë e vajzat duruan vetëm pak kohë e një ditë u ngritën Diella me shoqet e i këputën një fletërrufe kryesisë, e kritikuan Nuzin në mbledhje. E kritikoi edhe shoferi Lulash Bardhi, që sapo kishte ardhur vullnetarisht në fshat. Kishte lënë Skodën që mbante krom dhe kishte marrë Zisin e kooperativës. Kur e kritikoi Lulashi, Nuzi seç murmuriti nëpër hundë e dikush qeshi. Po Lulashi ia përplasi në fytyrë:

— Është mirë t'ia themi tjetrit të mirat dhe të këqijat hapur, e jo nën buzë, si ti.

Nuzi e kishte vështruar me inat. Ai mendonte se Lulashi i dilte krah Diellës se e dashuronte, gjë që ishte një turp i madh.

Ishte i pari rast që një djalë fejohej apo martohej brenda fshatit. Gratë seç flisnin me njëra-tjetrën Lulashi dalloi midis kooperativistëve fytyrën e Diellës të bërë all dhe vijoi:

— Ajo sot është e fejuara ime dhe nesër do të jetë shoqja e jetës. Ligjet e egra të kanunit na e kanë mohuar këtë të drejtë, por Diella dhe unë do të shkelim mbi to.

Kishin folur edhe shumë të tjera dhe të gjithë e kishin kritikuar Nuzin. Edhe sekretari i byrosë së Partisë e kishte kritikuar dhe kishte ngritur lart punën e mirë të Diellës e të komunistit Lulash Bardhi, që ishte bërë shembull kudo në kooperativë. Pastaj i kishte pyetur se cilën donin të kishin brigadiere dhe ata ishin përgjigjur një-

zëri: «Diellën. Diellën, shoku sekretar...» — Që atëherë puna ndryshoi. Brigada e Diellës është më e mira në kooperativë. Vetë si brigadiere Diella ka bërë 380 ditë pune...

Dielli u ngjit mbi mal. Blerimi, që kishte hedhur shtat mbi fushë, po ngjitej maleve deri atje, në Kurorë të Mandhe, ku ende pushonte orteku i dëborës së dimrit e ahishtet dukeshin me atë ngjyrën e bruztë të shkëmbinjve. Përrenjtë mblidhnin ujërat e zbrisnin me rrëmbim. Vëllët e shkumbëzuara dukeshin nën rrezet e diellit si akuj të bardhë që shkriheshin e thërmoheshin mbi gurë...

Ne ia filluam punës te ndërtesa.

— Do të bëjmë dasmë kur të mbarojmë pallatin, — tha njëri.

— E pse të mos bëjmë, — ia priti tjetri.

Ishte fjala për Diellën dhe Lulashin. Ata do të martheshin dhe me siguri që do të bënin dasmën në këtë ndërtesë, që ishte më e bukura, më e reja në fshat.

— Katër çifte të rinj do të strehojmë në pallatin tonë,  
— tha Mark Suti, duke vendosur një qoshe të re.

— Kur shkova te djali në Shëngjin, — tha bacë Marash Suti, i ati i Markut, — ishte kohë vere. Kalova në plazh e m'u errën sytë. Vura duart në ballë e thashë: More, të gjitha të mira i kemi, po këtë punën e grave që zhvishen kështu të mos e kishim...

— Prandaj ike nga Shëngjini e s'qëndrove, o baca Marash?

Plaku u vrenjt në fytyrë. Në rrudhat e tij kanë lënë gjurmë të thella vitet. 46 vjet ai ka qenë bari. Këtë vit i mbushi plot nëntëdhjetëedy. Jeta e re në kooperativë ia ka kthjelluar shumë mendimet. Ne punonim e ai tregonte për Diellën. Shkonte në brigadën e saj dhe i mësonte si ta punonin mirë tokën. «Dëgjomëni mua, oj çika, se unë e njihja delen nga bajga se në ç'pyll kishte kullotur. Unë e punoja aq mirë arën, sa çdo kashtë misër pa tre kallinj nuk

ndahej. Se e prashisja mirë; pas vadës e shtroja arën me tëkindela që të mos thahej». — Diella e dëgjonte plakun dhe kur ai bëhej gati të largohej, e pyeste: «Pse po ikën, o baca Marash?» — Plaku ndalonte, e, pasi buzëqeshte, ia kthente: «Kam punë, o Diellë! «Çfarë pune ke, more baca Marash?» — e pyesnin njëzëri vajzat. «Do të punoj me tim bir, Markun, që ta bëjmë shpejt atë «kullën, — kështu e quante ai ndërtesën e re dykatëshe, — se aty do të bëjmë nuse brigadiere Diellën. Ajo që ka zgjedhur Lulashin vetë, éshtë e të gjithëve e ne të gjithë do të gjëzohemi».

Në arë shpërthenin të qeshurat e plaku nisej me hap të sigurtë, sikur t'i jepte forcë gazi i Diellës me shoqe, dhe vinte drejt e te ne. Në një shtyllë të ngulur vertikalish kishte kohë që era tundte një flamur të kuq. Ai futej në biseda papritur, ashtu siç ngjitej deri lart pa e dëgjuar e pa e parë njeri. Prej andej Breglogu dukej si në pëllëmbë të dorës. Plaku picëronte sytë kur vështronte i etur e dukej sikur thoshte: «Hej, lum ju që jeni të rinj dhe do ta gjëzonit këtë jetë! Jepi, o Mark Suti, — i drejtohej të birit — jepi ti, djali që erdhe nga ushtria, — më thoshte mua, — ku je, o Diella e Breglogut me ato sokoleshat e tjera... Ku humbe ti, o Lulash shoferi? Eh, ju pastë baca, ç'po më rinoni zemrën».

Plaku skuqej në fytyrë. Sytë i shkëlqenin nga gjëzimi. Mbi kokën tonë era tundte flamurin e kuq, ndërsa dielli lartësohej gjithnjë e rrezet e tij bëheshin më të forta. Nga larg vinte buçima e një traktori, ndërsa në rrugë kalonte një kamion i ngarkuar rëndë që hepohej nëpër gropë. Shoferi i binte borisë me forcë vetëm kur dilte mbi një kodër, për të lajmëruar kthimin. Ne prisnim rërë e zhavor për ndërtesën e re. Brigadat e arave prisnin plehun kimik dhe farën. Binte ajo borri edhe për Diellën e Breglogut, për dashurinë e pastër dhe jetën e lumtur në fshat.

## MËNGJES I PËRGJAKUR

Aty nga mesnata në derën e një kasolleje të fshehur prapa ca mureve të shembura trokiti një njeri. Krismat ishin të lehta dhe të rralla: tak-tak. Në rrugë kishte rënë errësira. Dëgjohej vetëm ulërima e veriut të egër. Qyteti ishte në gjumë të thellë. Në derën e kasolles u përsëritën të trokiturat e pastaj u dëgjua një kërkëllitje e thatë.

Dhoma ndriçohej dobët nga një kandil i vendosur në qoshe të vatrës. Aty hyri Ceni. Dy të tjerët që qenë në dhomë i bënë vend dhe ai u ul pranë oxhakut me gurë të latuar. Ceni i njihte. Njëri ishte Aliu, i zoti i shtëpisë dhe tjetri Bestar Meta, i deleguari i Qarkorit me pseudonimin «Thepi». Ata biseduan kokë më kokë gjer në mesnatë.

— Partia na ka ngarkuar një detyrë të madhe. T'i pregatisim masat për luftë kundër okupatorit... Të ngremë në këmbë popullin që të rrokë armët. Të ngremë në këmbë djemtë dhe nipat e atyre që kurrë nuk u përkulen. Ka ardhur koha për luftë kundër okupatorit. Ne duhet të shpërndajmë trakte kudo. Populli duhet t'i njohe tradhtarët që bashkëpunojnë me armikun. Duhet ta pengojmë armikun të rekrutojë milicë. Okupatori, veç të tjerash, shfrytëzon fanatizmin, prapambetjen tonë... Me okupatorin është kleri, paria, — theksoi Bestari, — prandaj duhet me çdo kusht t'ua presim rrënjet këtyre se vetëm kështu do t'u

thahen degët dhe i gjithë trupi...» — Kështu, pasi u bëri të njojur gjendjen e vendit dhe masat e ndryshme për të përzënë pushtuesit, Bestari u hodh në detyra konkrete të secilit.

— Ti, Cen, e ke detyrën kryesore në katund...

Ceni qe bërë all në fytyrë dhe i dëgjonte tërë sy e veshë të gjitha ç'i thoshte Bestar Meta për ngritjen e populit dhe për organizimin e aksioneve.

Aty afér mëngjesit Bestari dhe Ceni ikën. I zoti i shtëpisë i përcollit dhe qëndroi te dera duke vështruar siluetat e tyre tek largoheshin nëpër natën e ftohtë të dhjetorit.

\* \* \*

Mëngjesi erdhi i vrenjtur. Retë ishin varur deri po shtë në lugina. Rrugët kishin ngrirë kallkan. Gjatë natës nuk kishte rënë dëborë. Si rrallëherë, në rrugë kishte shumë njerëz. Ata u mblodhën përpara derës së nënprefekturës. Lexonin një komunikatë. Pas pak erdhën xhandarët. Kundrat e tyre të rënda u dëgjuan nëpër rrugët e ngrira. Njerëzit u larguan me duar në xhepa, duke pëshpëritur me shoshoqin e fytyrat u shkëlqenin: «Partia komuniste... Njësit guerril...» Disa edhe çuditeshin. Nuk e kuptionin. Pyesnin... Paria, që kuptionin mirë dhe e dinin ç'ishin komunistë, vraponin duke shkumuar nëpër rrugët e ngrira të atij qyteti malor.

Ishte komunikata e parë.

Dimër i egër, me net të gjata e të zeza.

Komunikatat çdo ditë e më shpesh zbukuronin murët e rrënuara të qytetit.

Çdo natë sillte krisma pushkësh.

Një ngjarje tjetër pllakosi ato ditë qytetin e tronditur. Nënprefekti u vra!

«Zoti na ruajtët, — psherëtiu në mes të njerezve një plak. — Çështë kjo dorë e fortë që drodhi qytetin, që vrau edhe nënprefektin të shoqëruar nga dhjetëra xhendarë e spiunë?... Dorë e fortë...»

Armiku i egërsuar filloi terrorin, vrasjet, burgosjet, varjet në rrugët e qytetit.

Në duart e zbeta të rrithkomandantit dridhej radiogrami.

*Në përgjigje të kërkesës suaj drejtuar regjencës, urdhërojmë të merren masa të rrepta e të menjëherëshme përruajtjen e qetësisë. Në të kundërtën, do të përgjigjeni me kokë. Stop. Në të gjitha fshatrat e krahinat të dërgohen pa vonuar sheticat<sup>1)</sup> e ndjekjes për të vendosur qetësinë. Stop. Mbani lidhje me parinë e vendit, me familjet më të njoitura dhe me bajraktarët. Stop.*

Koordinoni veprimet me trupat e Italisë mike që vepojnë atyre anëve. Stop. Merrni sa më shumë djem të zgjedhur për t'i futur në radhët e xhandarmërisë apo për shërbim të fshehtë. Stop. Premtojuni grada dhe parâ njerezve të besuar. Stop. Njoftoni gjendjen para 30 dhjetorit në 0373. Stop...»

Rrithkomandanti përdrodhi buzët: «Premtojuni para», — e, si heshti pak, qeshi gjithë përcëmim: «Qesenë ti, e unë të premtoj...» Radiogrami i ra nga dora dhe thirri me të madhe zëvendësin.

Mexhidi hyri pa vonuar dhe, si mori drejtqëndrim, priti urdhrin:

— Të niset në këtë minutë shetica e toger Zeres, në-për katunde me radhë dhe... merre, — i tha duke i zgjatur radiogramin. — Zbatojeni! — bërtiti me zë të lartë pastaj, papritur i ktheu sytë nga dritarja. «Si urdhëron»,

---

1) Shetica: grupe xhandarësh deri një togë.

— dëgjoi prapa shpine zërin e zëvendësit dhe derën të mbyllej.

Agu i ditës së re rrëshqiti nëpër mjegullën e dendur që zgjatej deri lart, mbi kreshtat e maleve e që dukej sikur toka s'e mbante dot atë peshë të rëndë që i zinte frymën. Po jeta në të vërtetë lëvrinte... Rrugëve të ngrira, që i rrihte veriu si me kërbaç, njerëzit endeshin duke nxittuar. I ndiqte veriu dhe terrori. Ulërimat e dikurshme të ujqve të uritur ishin zëvendësuar tani nga breshëritë e gjata...

Nëpër këtë mëngjes një kalë ecte rrugës së ngushtë duke kafshuar me dhëmbë frerin e hekurt që ia mbante kokën të kërrusur mbi gjoksin e gjerë, ndërsa kalorësi peshonte fort mbi yzengjji.

Veriu i egër përplasej në fytyrën e skuqur të kalo-rësit.

Flokët dhe qepallat e Cenit ia kishte qëndisur me ca penjë të argjendtë vesa e ftohtë e mëngjesit. Përpara dëgjohej oshëtima e lumit. Ai ndoqi me sy rrjedhën e tij dhe valët që ngriheshin kulma-kulma. Pa nga larg urën që nxinte si një shirit i zi. Përtej saj fashistët ishin dislokuar. Kishin vënë roje tek ura. Lumi nuk kalohej.

Po tani, si të bënte? Këtë ai s'e kishte menduar. Kthehej nga qyteti. Fshati ishte matanë. Në kokë i zienin mendime të shumta. «A do t'ia dal mbanë?» Kjo e mundonte. Urë tjetër s'kishte, ajo qe e vëtmja mbi atë lumë. Vështroi përpara shtratin e zgjeruar dhe valët kulma-kulma, pastaj urën që i dukej gjithnjë si shirit i zi. Në veshë i kumbuan fjalët: «...Ty po ta besojmë këtë detyrë jo të lehtë. Duhet ta kryesh patjetër, Cen... Mbaje mend mirë se kjo është detyra e parë që kryen...»

Ai tërhoqi me forcë frerin e në të njëjtën kohë e go-

diti me thembër kalin. Nëpër luginë u dëgjua trokama e kalit mbi tokën e ngrirë.

Vendosi të futej në lumin e tèrbuar. Valët e egra kërcenin valle të ethshme. Ato ia rrëmbyen vështrimin. Ai e ndjeu që iu morën mendtë. I vendosur tèrroqi fre-rin, po kali u zmbraps. Ceni e tèrroqi përsëri, u përkul pak dhe, si e goditi disa herë radhazi, kafsha besnike u ngrit arithi dhe me këmbë të mbledhura përgjysmë u hodh përpara me shumë forcë, si të donte të kalonte lumin me një të hedhur. Valët e vunë përpara e në fillim vetëm koka i dukej. Ceni mezi mbahej, duke u shtrënguar pas krifës së kalit. Valët e tèruara përplaseshin mbi shpinë e kalit që dukej si një shkëmb. Një dallgë e madhe e shkëputi Cenin nga kali, duke lënë në dorën e tij një grusht me qime nga krifa e zezë.

\* \* \*

Zekë Velia, një burrë i moshuar po kthehej në shtëpi. Ekte me hapa të ngadaltë e trup pak të kërrusur. Ndonëse djemtë i qenë bërë burra, plakut s'i kishin shteruar forcat. Ekte dhe pinte duhan. Ekte dhe mendonte.

Ngjiti shkallët e gurta të kullës. Dera e kullës së tij ishte e myllur. Muret gjithë lagështirë dhe akujt e gjatë në strehë ia shtonin mërzinë. Plaku Zekë mendoi përgruan, për djemtë dhe shtyu me forcë derën. Dera e rëndë prej dru lisi u hap duke kërcitur e u përplas me forcë pas murit.

Nënë Simja doli si e trembur nga dhoma dhe, kur pa të shoqin, padashur nga goja i doli një «oh». Plaku Zekë iu afrua së shoqes dhe pa ia hequr sytë fytyrës së saj të zverdhur e pyeti:

— Ç'ke, grua?

Nënë Simja me sy të përlotur e pa guxuar t'i ngrinte për të parë të shoqin, iu përgjigj:

— E zezë ditë pér shtëpinë tonë, burrë! — tha e u mbyt në ngashërima.

Plaku Zekë u drodh nga këto fjalë dhe e pyeti të shoqen se çfarë kishte ndodhur. Po nënë Simja nuk fliste dot. Ajo dëneste, ndërsa i shoqi e pyeste vazhdimisht: — Mos dëgjove gjë pér Cenin? Nuk u kthyte Ceni? Fol! Pse nuk flet? Ku éshtë Selmani? — Po, meqë përgjigje nuk mori, hapi derën e dhomës dhe filloi të thërriste: — Man, Man.

— Ku éshtë Mani, moj grua? Fol, se ma plase zemrën, o ta marrtë zoti shpirtin! Fol, çfarë ka ndodhur, grua?

— Mani, — belbëzoi nënë Simja dhe plasi kokën në mes të duarve.

— E rrahën xhandarët? Mos na e vranë djalin xhandarët? Fol shpejt, çfarë!?

— E morën.

Plaku zgurdulloi sytë nga zemërimi.

— E lidhën?

— ...

— Oh, ç'po ndodh këtë ditë në shtëpinë tonë... Po fol, moj grua, si ndodhi?

Nënë Simja me zërin që i dridhej, por pa lotë, tha:

— Dje erdhi Mani në shtëpi me dy xhandarë. Unë u çudita kur e pashë Manin tonë me xhandarët.

— Xhandarët në shtëpinë time!...

— Po. Mani erdhi me xhandarët. Deshi t'u shtronte edhe drekë bile. Unë nuk dija ç'të bëja. Druhesha mos m'i bënin gjë djalit apo ty kur të vije. Kemi dëgjuar se gjithandej po e shtrojnë miletin në dru. Më thirri Martin marshalli e më tha se do të ma mernin djalin pér fare. Unë ngriva nga frika. E pyeta se çfarë faji kishte bërë im bir, po ata qeshën të tre. Qeshi edhe Mani. «Do ta marrim, — më tha Martin marshalli, — se Mani éshtë djalë trim. Éshtë i biri i Zekë Velisë...»

Plaku pështyu.

«Shtëpia juaj ka nxjerrë gjithmonë trima. Edhe Mani është trim. Do ta marrim ne Manin. Do ta shpjemë në shkollë. Do ta gradojmë. E kur ta shikosh ti, djalin me grada, moj plakë, do të mbetesh pa mend. Do të marrim vetëm djemtë më trima, që të marrin gjak në vetull. Ia thuaj edhe plakut Zekë këto, — se një rrrogë të majme do t'i japë krajli atij.»

Plaku Zekë shtrembüroi fytyrën e thithi fort çibu-kun e tij prej bushi që ishte skuqur nga zjarri.

— Unë s'ia ndaja sytë tim biri dhe mbeta pa mend që im bir qeshte e gëzohej. Fliste Martin marshalli e kariste me atë të qeshurën e tij.

«Pa ku do të shkosh, more tutkun, — i thoshte Manit tonë, ku do të shkosh, në akademinë e Romës? Botën do ta kesh nën krahët e aeroplanit që do të të çojë ty....»

Plaku Zekë dëgjonte e fytyra e tij e madhe sikur qe ngurosur e zverdhur së tepërmë. Në ballin e gjerë i ndeheshin rrudha të thella e bebëzat e syve i zmadhoheshin gjithnjë.

— Unë mendoja luftën që po bëhet sot e i thashë Selmanit: «Ruaju ujit të turbullt, bir,» — Po Martin marshalli ishte kopil i madh. E di që ma kuptoi se ku e hidhja unë llafin? Më tha: «Nuk di gjë ti, o plakë, po mba vesh këtu. Sot mbretëritë janë të forta. Ato janë në luttë me njëra-tjetren. Kanë armë të fuqishme. Ne jemi vend i vogël. Po s'na mori në mbrojtje një mbretëri e madhe si Italia, as që mund të bëjmë hap përpara, se na hanë ujqit... E ç'rrugë e ura, e ç'fambrika që do të na bëjë taljani neve, moj plakë... Do ta hashë sheqerin me rriska e kripën pa racion. Do të na sjellë pëlburë jo si ajo që bëni ju graria në vegje, po pëlburë që të kesh shtatë palë sy për ta parë... Po ti s'e di, oj plakë, çka janë armët moderne e as pëlburat e taljanit, po më vrafshin mua, ti, oj plakë, nuk

i njeh as makarunet! Ëh? A ke ngrënë ndonjëherë makarune, oj plakë?» — më pyeti. «Jo, për besë» — i thashë e ai duke u shqyer gazit shtoi: «Hë, pra. E sheh që ti nuk i di këto. Mos e ngatërrro djalin, o plakë. Ne sot kemi nevojë pér Italinë. Italia i do të mirën Shqipërisë. Ne s'mund të matemi me mbretëri, se jemi popull i vogël e s'jemi pér to veç një kafshatë. Mani do të bëhet oficer, do të mësojë në shkollë. Nesër do të komandojë në luftë. E në ardhëtë ndonjë mbretëri më e fortë se kjo, Mani yt do të dijë të luftojë më mirë, se pér këtë do ta bëjë edhe shkollën... Do të na komandojë në luftë. Ai atëherë do ta veshë gjoksin me ar, o plakë. Nejse, këto janë punë që i kap një mendje e hollë, po unë një gjë di me të thënë: në qofshim gjallë e shëndoshë, do të vini te marshall Martini e do të më falënderoni pér këtë që po ju bëj sot. E ta dini këtë nga unë, — më fliste duke më tundur gishtin, — nuk marrim dosido ne, ç'të gjejmë në rrugë, po djem të zgjedhur. Gjatë kohës që ky do të jetë në shkollë, ju do t'ju shikojnë me tjetër sy taljanët. Ata do të shtohen. Mos kujtoni se do të jetë kjo ushtri që ka ngritur çadrat aty në faqe të malit mbi urë, jo, moj, jo, do të vijë së shpejti edhe një regjiment», — tha ai duke i mëshuar asaj «r»-së. Kur pashë djalin t'u gëzohej atyre fjalëve, edhe unë mendova pér një çast se kjo qe një e mirë që më erdhi në derë. Megjithatë, kur ikën, prapë ia përsërita edhe një herë djalit: «Ujtit të trubullt ruaju, bir. Mos shko...»

— Mos u bëj merak, nënë, se s'jam i vogël, — m'u përgjigj.

Si mbeta vetëm, m'u duk shtëpia krejt bosh dhe qava. Si s'qëlluat asnjëri, xhanëm.

— Bir. Mos ardhsh më, ja, kështu t'i kishe thënë, — sokëlliу Zeka.

Nënë Simja s'po merrte vesh ç'po ndodhte. Edhe

plaku s'e kishte keq, po nuk ia merrte mendja që edhe Mani tē shkonte ashtu, kuturu, pa e menduar.

— Medet që po vonohet Ceni, se ai i di mirë këto punë, — tha plaka e s'po zinte vend.

Plakut një hije e zezë i qe nderë në fytyrë e diçka murmuriste me vete. Sytë ia kishte qepur urëve tē ndezura që digjeshin në vatër e bënин një prush tē kuq. Pastaj foli me zë tē lartë e iu kanos së shoqes:

— Po ti, moj t'u thaftë ajo gojë, si nuk i fole djalit pér atë marri që po bënte? Si e le, moj grua, tē ikte djali?! Hej, mos arriftë tē soset atje ku është nisur!...

Nënë Simja ngriti kokën, e pa tē shoqin drejt në sy, po mendjen e kishte tjetërkund: Ceni ende s'po dukej. Muret e larta tē kullës i rrihte një erë e tërbuar.

Në atë kohë Ceni po luftonte me dallgët e ftohta tē lumit. Notoi gjatë në valët e egërsuara që e përplasnin sa në një anë në tjetrën. Ia ngulte sytë bregut. Ai nuk ishte shumë larg, kur një rrymë uji si llavë që valon diku në thellësi e tërhoqi drejt vetes disa metra thellë dhe e largoi edhe më shumë nga bregu. I dha trupit, doli në sipërfaqe, nxori ujë nga goja dhe ndjeu një tē therur në këmbë. Megjithatë mendjen e kishte top dhe u përpoq tē notonte drejt bregut. Valët shpesh e çonin afër degëve tē shelgjeve që vareshin mbi lumë. Ai nuk ua ndau sytë dhe priti derisa kaloi nën to, zgjati dorën në ajër po trupi iu fundos e ai s'mundi t'i kapte. Doli përsëri në sipërfaqe, u fundos disa herë me radhë e më në fund u kap pas një dege shelgu. U mbajt pas asaj aq sa mundi tē rrotullonte trupin e tē kthehej në pozicion pér tē notuar. Pasi bëri edhe disa lëvizje tē lodhshme, mundi tē dilte nga rryma e valëve dhe iu afrua shkëmbit tē pjerrët që lartësohej dhjetëra metra mbi lumë. Shkëmbi pikonte ujë. Ceni vuri dorën mbi tē. Duke prekur shkëmbin, ai pa duart e tij tē nxira nga tē

ftohtët që dukeshin si dy urë por që ende i bindeshin. Iu qep shkëmbit e doli në krye të tij.

Hodhi vështrimin diku larg mbi male, ku iu shpalos një pamje e zymtë nën qiellin e bruztë. Në trup i shkuani të dridhura. Dhëmbët i kërcisnin. «Për dy orë zbardh», — mendoi dhe shpejtoi hapin drejt pyllit. Kali kishte dalë nga lumi dhe po dridhej ndanë pyllit.

Kishte bërë mjaft rrugë. Vështroi qiellin. S'i hiqej nga mendja dyshimi se mos u dështonte aksioni. Dhe që të arrinte ku duhej, kishte ende për të ecur malit lart. «Ai është dhëpër plakë, — mendoi, — zor se bie në kurth...»

Rrugës së malit po vinte një kalorës.

Ishte Dan efendiu. Ai po kthehej nga vendi i dislokimit të forcave italiane. Efendiu qe bërë i krishterë, apo fashistët qenë bërë muhamedanë?! Kjo nuk dihej. Fashistët kishin pranuar bekimin e Dan efendiut. Pas bekimit qe shtruar edhe darkë. Darka zgjati deri vonë. Pastaj, kur të gjithë kishin fjetur, Dan efendiu kishte kërkuar ta nxirrin nga postblloku, pasi donte të kthehej në fshat përpara se të zbardhë. «Kështu askush s'do ta mësojë se unë qeshë në fushimin e italianëve.» — Ai e ngiste kalin revan. Në rrugën e ngushtë e të heshtur dëgjohej trokama e patkonjve të kalit dhe vërvshëllima e veriut.

— Je ngutur të bëhesh patriot, — i kishte thënë një ditë Dan efendiu Cenit që, ndërsa kundërshtonte të paguante të dhjetat, shante hapur dhe okupatorin. — Patriot njeriu mund të bëhet kur të dojë por, — kishte thënë Dan Efendiu, — pasi të stabilizohet qeveria... Mos u ngut ti, o burrë i malësisë, shërbeji mirë, dhe qeveria të shpall patriot kur të dojë... Këto fjalë që thua ti vetëm sherr ndezin... — Ceni kishte dëgjuar Dan efendien dhe ia kishte

dhënë përgjigjen, që mezi e kishte mbajtur në majë të gjuhës, aty për aty:

— S'presim fjalë tjeter prej teje, o Dan efendi, vëgël e tyre je edhe ti.

Këto i kishte thënë Ceni e Dan efendiu, i tronditur nga fjalët e të qeshurat e të tjerëve, ishte larguar i fyter.

Papritmas u dëgjuan dy krisma pushkësh.

Kali, i trembur, kërceu përpara e nga shpina e tij u rrëzua si trung i kalbur Dan efendiu. Kali vrapi i rrugës së ngushtë, si një shtrungë e gjatë në të dy anët me gurë.

Nga gurët doli Ceni, i cili vështroi rrith e qark, përtë hetuar vendin dhe nxitoi drejt të vrarit. E pa me vëmendje e, pasi u bind se kishte mbaruar, u përkul mbi të, zgjati duart e i shpalosi qyrkun e ngrohtë, i hoqi nagantin nga brezi me nënshkrimin e mbretit merhum. Pastaj, në mes të gjoksit, ku i kryqëzoheshin qostekët e argjendtë, i ngjiti një copë letër ku shkruhej:

«*Kështu do ta pësojnë të gjithë ata që do të vihen në shërbim të okupatorit.*

*Njësiti guerril.*»

E futi koburen në brez dhe ashtu, me duar në xhepa, u fut në pyll.

Kjo ndodhi apo kishte zbardhur 20 dhjetori i 194<sup>ë</sup> në pjesën matanë lumit, ku qenë dislokuar italianët.

\* \* \*

Martini printe në krye i ndjekur nga shoku i tij dhe në fund Mani myllte kolonën. Martini në çdo hap që hidhte thërriste: «Hë, ecni shpejt, o ju dalshin trutë! Harruat se na pret toger Zerja. Me toger Zeren nuk bëhet shaka, more ju marrtë dreqi, këmbët!»

Mani shpejt u mërzit me ato që llomotiste Martin marshalli. S'po i hiqeshin nga mendja fjalët që i kishte thënë e ëma: «Ruaju ujit të turbullt, bir!» — A kishte ikur nga shtëpia pa pyetur as të atin as vëllanë. A do ta kuptionin ata vallë qëllimin e Manit? Po tek e fundit ai e kishte vendosur. Gjithçka i kishte thënë Martin marshalli e kishte joshur, vetëm ato zonjat e Romës nuk i intezonin. Ai ishte i fejuar dhe s'kishte pse të mendonte për to. I kujtohej Zoga, i bëhej se i lutej që të mos shkonte. Ajo do të mërzitej nga mungesa e tij.

«Vallë, a dinte Zoga se si ai, Mani i Zekë Velisë, do të bëhej zabit? — Po nga ta dinte Zoga një gjë të tillë? — Do të gëzohet». — E, ndërsa mendonte këto, në vesh i kumbuan fjalët e nënës: «Ruaju ujit të turbullt, o bir». — Kësaj here buzëqeshi e mendoi se ai nuk ishte më fëmijë që të kishte ende nevojë për këshilla. «Eh, moj nënë Sime, më di fëmijë ti akoma».

Papritur u përplas te trupi i xhandarit që kishte qëndruar në mes të rrugës. Ai ndeshi në vështrimin qortues të syve të xhandarit që kishte ngritur gishtin tregues lart dhe si vërvshëlleu i foli:

— E humbe fare, more tutkun. Dëgjo mirë këtu. Ti nuk e njeh toger Zeren. Ai nuk të fal as sa të zitë e thoit. More vesh? Është i reptë ai, ndryshe s'do t'i kishin besuar një detyrë kaq me rëndësi. Pra përpiku t'i hysh në zemër. Ai të blen me një të hedhur të syve. Ti je në provë. Përpiku t'i fitosh zemrën...

Mani e dëgjonte në heshtje.

— Mos u trewo gdhë, se të kushton shtrenjtë. Ti duhet të durosh, të durosh, — përsëriti, — si i thonë fjalës, edhe dymbëdhjetë shkopinj të të thyhen pas trupit. Ke të bësh në radhë të parë me toger Zeren, të tmerrshmin «Furan Dajaku».

Kaq tha e vijoi rrugën.

Toger Zerja i priste mu në mes të fshatit. Mani hapi sytë të shikonte sa djem nga fshati kishte me vete toger Zerja dhe u habit kur pa vetëm dy xhandarë dhe një ka të lidhur për brirësh. Në çast iu errën sytë e iu prenë këmbët aq sa s'ishte në gjendje të bënte edhe një hap më tej...

Tozer Zerja e priti me duar në xhepa, sikur u numëronte hapat, në gojë mbante një cigare të ndezur që e endte buzëve duke e kafshuar me dhëmbë. Sytë e skuqur hidhnin vështrime therëse mbi vartësit e tij. Kapelja në majë të kokës çudi si nuk i rrëzohej nga era; ndërsa flokët e tij pendë korbi ia shpërndante era mbi ballin e vrenj-tur...

— Ju prita, — nisi ai, — të vinit me shporta dhe më erdhët me shkarpa... Ku m'i ke djemtë, marshall Martin; ku m'i ke premtimet që dhe se do të rekrutoje të birin e Zenel Çunit, të Mark Logut, Fet Delisë, Qerim Kaçit... Ku i ke, o marshall Martini? Pse s'i more?

Marshall Martini qëndronte i heshtur përparrë eprorit. Ai s'kishte q'të thoshte. S'kishte mundur të zbatonte urdhrin e dhënë. Shtatë ditë e shtatë net kishte bredhur shtëpi më shtëpi e njeri s'kishte bindur, le që s'kishë takuar asnjërin prej atyre që kërkonte. Nga e kishin marrë vesh? Pse ishin zhdukur sikur t'i kishte përpire dheu? Marshall Martini kishte thënë sa herë duke u munduar të tregohej sa më i qeshur e babaxhan: «M'i gjeni, ore, se s'kam ardhur për t'i lidhur, po për t'i çuar në shkolla, për t'i veshur xhandarë...» — Po malësorët s'kishin parë kurrë që të dërgoheshin djemtë në shkollë të shoqëruar me xhandarë, ndaj s'i donin ata as xhandarët, as marshallët, as togerët, dhe s'pranuan të shtroheshin në kuvend.

Këto të gjitha ia tha marshall Martini eprorit të tij. Mani i dëgjoi e mbeti gojëhapur. I dukej vetja si një trung i vëtmuar që valët e lumit e përplasnin shkëmbinjve. Ai

vështronë kaun e lidhur. «Xhandarët nuk blejnë bagëti, — mendoi, — i grabisin. Njerëzit u paskan ikur kudo, vetëm unë... Asnjë djalë nga fshati s'u gënjye... Pse, vetëm unë do të shkoj? Oh, nënë, nënë! Ti më the «ruaju ujit të turbullt».

Këto po mendonte Mani kur toger Zerja urdhëroi dy xhandarët që të niseshin me kaun, ndërsa ai vetë me marshall Martinin, një xhandar dhe Mani s'do të ktheheshin në qytet pa kaluar nëpër fshat, me shpresë se do të rekrutonin dhe ndonjë djalë tjetër. Duke parë Manin, do t'i bindeshin më lehtë...

Era këndonte rrreth Manit një këngë të trishtuar.

Atë çast Manit iu kujtua Ceni. Ceni kishte kohë që ikte nga shtëpia me ditë të tëra. Babai nuk e qortonte... Madje iu kujtua se një natë i ati edhe e kishte lavdëruar në sy të miqve: «Ky djalë më duket se po ma përtërin babën». — Gjyshi kishte qenë trim me nam. Ai qe vrarë në luftë kundër shovinistëve malazezë. Pushka e tij ishte gjetur e larë krejt në gjak, se gjyshi s'e kishte lëshuar nga dora as i vdekur. Dhe ja me giyshin trim e kishte barazuar i ati Cenin. Po për Manin ç'do të thoshte ai tani që?... Kur i kujtoi këto, sikur iu ngulën thika në gjoks. Ai kishte ikur nga shtëpia pa pyetur njeri, ashtu me kokë të tij.

Dhe qëndroi në vend. Mendoi të hidhej në përrua dhe të ikte, po iu duk një veprim i ulët të ikte tinës. Ata ecnin. Mani qëndronte në vend. Vetëm pasi u largua disa hapa, xhandari e pa dhe i tha marshall Martinit. Martini, pasi e vështroi Manin i habitur, ia bëri me dorë e, kur e pa që s'po shkulej nga vendi, i tha: «Ec ore, të kanë lidhur!»

Toger Zerja, që po rrinte në krye me duar në xhepa, duke vërvshëllyer ndaloi papritur dhe pyeti: «Çfarë ka ndodhur?»

Po nuk mori përgjigje.

Mani bëri disa hapa dhe qëndroi përsëri në vend duke vështruar fshatin. I qenë afruar fshatit të Zogës. U mundua të dallonte shtëpinë e saj. Ç'do të thoshte Zoga, fshati? «Vetëm Mani i Zekë Velisë dhe një ka i lidhur për brirësh, ndonëse kau qe nisur në një rrugë tjetër, shkelin në gjurmët e toger Zeres... Turp, ore, turp, nipi i...»

— Eh, Man, ç'të gjeti? — i tha marshalli.

Mani vështronte fshatin.

— Nuk vij, — tha i vendosur. — Ju shkon. M'u kthyte mendja...

— Si? T'u kthyte mendja? Po ne jemi burra, apo çfarë jemi? Ec, ore, — tha ai dhe i futi krahun, po Mani u largua dhe bëri të nisej rrugës poshtë.

Toger Zerja u inatos. Xhandari vrapi po drejt Manit. Marshalli hoqi pushkën nga krahun dhe ia drejtoi: «Mos bëj hap, se ta shkreha në lule të ballit».

Mani e pa me inat. Në ballë i kishin kërcyer damarët dhe vazhdoi të kundërshtonte.

— Ta vrisni dhe ta hidhni në përrua, po bëri një gjysmë fjale! — urdhëroi marshall Martini xhandarin që rrinte gati, me pushkë në dorë.

Toger Zerja e vështroi Manin me inat dhe priti derisa i shkoi pranë e i tha shkurt: «Mos luaj me zjarrin ti, djalosh», dhe priu i pari drejt fshatit.

Mani e cte duke menduar si të shpëtonte nga ky kurth ku kishte rënë me këmbët e veta. Xhandari e ndiqte pas duke hetuar çdo veprim të tij. Rruga kalonte luginës ku ishin edhe shtëpitë. Mani e cte kokulur. Ai e dinte që rruga kalonte nëpër oborrin e Zogës. Ai vështronte shtëpitë dhe shpresonte të futeshin në ndonjëren prej tyre. Po toger Zerja e cte duke fërshëlyer e duke rrahur qillotat me një thupër thane. Koburen, që i tundej në rripin e liruar,

e kishte nxjerrë përpara. Inati i parë i kishte shkuar. «Ja edhe shtëpia e Zogës». Manit filloj t'i rrihte zemra fort dhe s'dinte ç'të bënte. Qielli ishte i zënë dhe mbi kodra rrinj varur retë sikur të pushonin mbi to. Nga larg dëgjohej oshëtima e lumit. Nata po binte ngadalë. Në udhën e pyllit dëgjoheshin zilet e bagëtive që po afroheshin.

Në oborrin e shtëpisë ai pa Zogën. Edhe ajo e pa. Tek po priste dru, qëndroi si e ngrirë me sëpatë në dorë dhe ua nguli sytë. Fytyra e saj ishte bërë flakë e kuqe. Një gërshtet i zgjidhur i kishte rënë mbi supe. Sytë e saj të bukur sikur shkrepëtinë atë çast. Mori sëpatën në dorë dhe hyri në shtëpi.

Toger Zerja ndaloi. E pa shtëpinë dhe pastaj tha me ton urdhërues:

— Këtu të futemi.

### 3

Pas pak do të binte nata, një natë e ftohtë që të ngrinte. Ceni gjatë ditës u fsheh pyllit duke bërë gjoja dru dhe kur ra muzgu ai u ndodh në rrugë. Ekte i shkujdesur me kalin për dore ngarkuar me dru. Veriu ulërinte grykave dhe drunjtë rrëth e rrötull sikur do të thyheshin, ndërsa rruga ishte e qetë. «Edhe kjo detyrë mbaroi. Dan efendiu ngrohet në tjetër dynja».

Me këtë mendim në kokë, Ceni iu afrua shtëpisë së tij duke kaluar nën lisat e gjatë ku rruga e gjerryer nga ujërat kishte ngrirë kallkan. Shtëpia iu duk e zymtë me ato strehë që nxinin e me ato mure të lagura e të ngrira që i rrihte gjithmonë veriu. Si shkarkoi barrën e druve, ngjiti shkallët e gurta dhe shtyu derën e rëndë të kullës. Dera e dhomës ishte e hapur e që andej në korridordin e errët e tërë lagështirë binte një fashë krejt të zbetë drite.

Ai pa tē atin qē rrinte i menduar pranë vatrës. Me t'u hapur dera, plaku Zekë thirri:

— Man!

— Jam Ceni, babë.

Plaku u ngrit nē këmbë dhe i zgjati dorën.

— Cen, erdhe, bir? — i tha duke i shtrënguar dorën.

Në korridor u dëgjuan hapat e nënës. Ajo, kur pa Cenin, u mundua t'i fshihte lotët që i rrohdhën, po Ceni e vuri re dhe pyeti i habitur:

— Ç'keni kështu?! Ju shoh tē mërzitur, a mos ka ndodhur gjë?!

Plaku Zekë u ul nē qoshe tē vatrës.

— Kemi që mbrëmë që tē presim, bir. U bëmë merak.

— Dhe unë erdha, babë, — tha ai duke qeshur.

Nëna rrinte nē këmbë e heshtur, ndërsa plaku Zekë vazhdonte tē pinte duhan.

Ceni e vërejti me ngulm tē atin dhe kuptoi që diçka kishin. U mendua një çast.

— Ku është Mani? — pyeti Ceni papritur.

Nënë Simja psherëtiu, ndërsa plaku Zekë heshti. Cenit iu shtua dyshimi.

— Ku është Mani, babë?

— Na iku Mani, bir!

— Si? Ç'do tē thotë na iku, a mos?!

Plaku Zekë e pa tē birin nē sy e foli:

— Iku me xhandarët, bir!...

Ceni u drodh kur dëgjoi këto fjalë.

— Ç'do me xhandarët Mani? — pyeti.

Ata i treguan se si kishte ndodhur. Cenit iu kujtuan fjalët e «Thepit», se armiku përpinqet tē rekrutojë njerëz pér t'i vënë nē shërbim tē tij. Atij kurrë nuk i kishte shkuar nē mendje se i vëllai do tē bënte një hap tē tillë. Ai kishte shpresuar ta merrte edhe Manin nē aksionin që do tē kryente. Sido që kishte ndodhur me Manin, ai ven-

dosi të fliste me babanë. Ai e dinte se i ati i urrente fashistët. Dinte gjithashtu edhe influencën e tij në fshat. Zekë Velia mund të bënte për vete shumë njerëz e të gjithë së bashku të luftonin.

— Na kanë ngarkuar një detyrë të rëndësishme, — i tha Ceni të atit. — Ajo duhet kryer patjetër. «Thepi» na udhëzon që ne t'ua bëjmë të pamundur qëndrimin në Shqipëri italianëve. Armikun duhet ta luftojmë me se të mundemi. Kështu që nesër mbrëma ne do të presim linjat telefonike, do të presim edhe telin në lumë dhe të mbysim lundrën, në mënyrë që fashistët të mos kenë nga të kalojnë. Duhet të prishim edhe urën. Ky aksion duhet kryer. Kisha menduar të merrja edhe Manin, po ai... Sa turp! Ç't'i them unë «Thepit»? T'i them se më iku vëllai te fashistët?...

Plaku pinte duhan dhe dëgjonte.

— Ai ma pastë faqen e zezë, or bir, se më turpëroi në pleqëri dhe unë s'kam më fytyrë të dal në katund, po sa për të prerë linjat mos u bëj merak, se do të jem vetë në ballë!

— Shumë mirë, baba. Neve na duhen shumë njerëz për të prerë linjat dhe unë mendoja se nga shtëpia jonë do të dilnin tri pushkë në këtë aksion. Është detyra e parë që më ngarkon Partia. Duhet mbytur edhe lundra, baba.

Plaku lëshoi zërin si rënkim:

— Tri pushkë...

— Dhe do të dalim vetëm ne të dy, o babë.

Plaku e pa i pikëlluar.

— Ne të dy do të jemi të zotët që të bëjmë edhe sa për tri pushkë, or bir. Dhe këtë do ta bëjmë si trimat. E kemi edhe vendin shumë të përshtatshëm.

— Po «Thepi»? ç'do të thotë ai për Manin?

— Mani tregoi papjekurinë e tij. Ne, me pushkët tona do të tregojmë cilët jemi e cila është shtëpia jonë.

— A më dëgjon edhe mua një llaf, o burrë?, — u hodh Simja nga fundi i konakut ku po lante enët.

Plaku lakoi vetullën e majtë dhe i tha me zë të butë:

— Fol, grua.

Ceni vështroi nga e ëma, duke pritur ç'do të thoshte.

— A ma jepni mua pushkën e tretë? Ma besoni, se edhe unë di të qëlloj. E, në paçi frikë, shaminë time të bardhë që tani po e heq e bashkë me ju po zë pritën. Sytë akoma s'më kanë lënë. Si thua, o burrë?

Plaku, si heshti një copë herë, iu përgjigj:

— Më mirë tri se dy, oj grua.

Nënë Simes i ndriti fytyra.

— Nënë, — thirri Ceni duke e përqafuar... — Nënë!

Nënë Simja e puthi në ballë.

*Kurrë s'kem lanë na pushkë n'dyrek,  
Nan'Hasimja thot' e marr vet'...*

Plaku Zekë u ngrit nxori pushkët nga hatulla ku i mbante gjithnjë të fshehura.

Ceni nga mesi i natës iku nga shtëpia, pasi kishte biseduar gjatë me prindët e tij e kishin vendosur për gjithçka.

\* \* \*

Zoga, me të dëgjuar toger Zeren që tha «Këtu të futemi», mori sépatën në dorë dhe vrapi është oborr e u fsheh prapa derës së shtëpisë. Toger Zerja ia bëri me sy Martin marshallit dhe me një lëvizje të dorës u dha

të kuptionin xhandarit tjetër e Manit se ata duhet të prisnin aty, pa lëvizur nga vendi.

Pas derës së hapur u fshehën edhe ata të dy, toger Zerja dhe Martin marshalli.

Mani hodhi vështrimin rreth e rrotull. Nën këmbët e tyre fillonte faqja e përroit, një pjerrësinë e keqe dhe e thellë që, po të të shkiste këmba, pa një pa dy do të përfundoje në fund të saj. Xhandari hidhte sytë herë nga dritatet herë nga dera e shtëpisë. Mani kujtoi se ai vërente se mos dilte nga shtëpia ndonjë njeri i dyshimtë që s'duhej t'u shpëtonte nga duart. Po xhandari e kishte gjetiu hallin. Ai lëvizte i shqetësuar e nëpër dhëmbë belbëzonte diçka, derisa më në fund tha shkoqur:

— Ç'femër e bukur! Fati i Furan Dajakut!

Manin e shpuan si thikë këto fjalë. Si i zgjuar nga një ëndërr e tmerrshme, u hodh dhe bëri të futej brenda, po në krah ndjeu diçka si darë që e shtrëngoi. Ishte dora e fortë e xhandarit.

— Ku shkon? — i tha xhandari. — Nuk ka pjesë pér ty!... Dhe zbuloi dhëmbët e mëdhenj e të zverdhur.

Manit i hip gjaku. Tërhoqi me forcë krahun e, duke ia ngulur shikimin drejt e në sy, i dha një goditje nën mjekër xhandarit aq me forcë, sa ai desh u rrëzua. Xhandari u mat të hiqte pushkën nga krahу po Mani iu hodh e të dy u kacafytën duke i futur thonjtë në grykë njëri-tjetrit. Xhandari çoi dorën në brez, ku mbante një thikë të gjatë në këllëf. Ajo ishte një bajonetë e mprehtë dy pëllëmbë e gjatë, me dorezë hekuri. Po nuk arriti, se Mani ngriti një gur dhe e goditi në kokë. Xhandari ra si i vdekur. Dora i mbeti e ngrirë mbi dorezën e thikës së gjatë. Mani e goditi edhe disa herë të tjera radhazi, duke murmuritur me vete: «gjarprit i duhet shtypur koka».

Pasi bëri këtë, Mani vrapi përmes oborrit.

Sa vuri këmbën në pragun e shtëpisë, dëgjoi Zogën

që thërriste. Ai zë ia ngjethi mishin dhe shpejt ngjiti shkallët. U çudit kur pa Martin marshallin të përkulur përpara derës tek mundohej të përgjonte nëpërmjet një vrime.

Mani hoqi opingat e trasha prej gome dhe duke ecur në majë të këmbëve mori në dorë një sëpatë që gjeti aty afër e iu afrua marshallit, i cili s'ia ndante sytë vrimës së derës.

Në dhomë dëgjohej kacafytja dhe zëri i Zogës. «Mbahu Zogël!» — i gufoi zemra Man Velisë dhe ndër-kohë ngriti sëpatën e goditi Martin marshallin pas kokës me forcë. Ai u këput e ra pa frymë në pragun e derës.

Mani shtyu derën. Dera ishte e myllur nga bren-da. Ç'të bënte? Zëri i Zogës herë pas here ngjante me kuisjet e bretkosës në gojën e gjarprit. Dukej se toger Zerja mundohej t'i zinte gojën me dorë. Mani u zmbraps disa herë dhe, pasi mori vrull, i dha derës një të shtyrë me supin e tij të fuqishëm. Dera kërciti me zhurmë e dërrasat e vjetra u ndanë nga njëra-tjetra. Llozi i drunjtë ra përpara këmbëve të toger Zeres, që mbante me një dorë të pushtuar Zogën dhe me tjetrën koburen drejtuar nga dera. Mani e dëgjoi koburen që u zbraz në sekondë, por Zoga, me një lëvizje të trupit ia prishi nishanin dhe plumbi e plagosi Manin lehtë në krah.

Mani ashtu i prishur në fytyrë iu turr toger Zeres, që me shpejtësi e zbrazi edhe dy herë të tjera armën. Plumbat e tij kësaj here shpuan dërrasat e tavanit të nxira nga bloza.

Filloi kacafytja. Zerja e vuri poshtë Manin dhe e goditi me grushta disa herë. Pastaj, duke parë se një krah ia kishte plagosur, ia kapi dorën e shëndoshë dhe nisi t'ia përdridhte. Mani i dha trupit me forcë dhe togeri u përplas në dysheme.

— Bjeri, Zogë, — thirri Mani në atë çast dhe të dy

njëherësh qëlluan mbi të deri sa trupi i tij u shtri pa jetë aty te këmbët e tyre. Atë kohë Mani e pa buzagaz Zogën dhe, kur u bë gati ta përqafonte, ajo, me sëpatë të ngritur lart, i foli e egërsuar:

— Ky ngordhi, po tani e ke radhën ti, ti që m'i sille këta horra në derë të shtëpisë!

Mani vuri re se Zoga ishte bërë all në fytyrë. I habitur dhe duke iu marrë fryma ai mundi të thoshte:

— Zogë, a mos u çmende? — dhe u përpoq t'i afrohej.

— Largohu, i poshtër!

— Unë i poshtër, Zogë?! Jam Mani, që të shpëtova nga përdhunimi!... Zogë, jam Mani!

Asaj i shkrepëtinë sytë.

— Jo. Ti nuk je Man Velia, po një i poshtër, derisa rri me të tillë të poshtër! Ti ma nxive vatrën. Ti ma turpërove babën në pleqëri!...

— Mbahu, burrneshë!

Duke thënë kështu, ndjeu të therur në krah e, kur uli sytë, pa se i rridhte gjak. Jashtë u dëgjuan të shtëna. Italianët kishin ardhur me një frymë për të parë se ç'ponodhët dhe rrethuan shtëpinë.

Dita po shuhej ngadalë.

— Eja ma lidh plagën, Zogë.

Ajo e vështroi gjatë plagën që i rridhte gjak e foli:

— Jo. M'u hiq shtëpie! Ti më dukesh njëloj si kufoma e këtij të poshtri që më qelbi shtëpinë. Largohu nga shtëpia ime dhe, po të ra rruga ndonjëherë këtyre anëve, mos e kthe kokën as nga shtëpia, as nga këto anë. Shporru!

Dera trokiti.

Mani mori dy bomba dore në brezin e Martin marshallit dhe iu afrua dritäres së ngushtë duke iu lutur Zogës:

— Ma lidh plagën, Zogë! — Sytë s'i largonte nga dritarja, që të kontrollonte çdo lëvizje të armikut.

— Po më rrjedh shumë gjak... dua... dua të luftoj, Zogë! — Foli ai përsëri me zë lutës.

Ajo hoqi shaminë e kokës dhe ia lidhi krahun. Mani ndjeu një dhëmbje therëse edhe më të madhe që i përshkoi tërë trupin, por që pas pak e dalngadalë erdhi duke iu lehtësuar. Krahun tani e ndiente si të mpirë. Ktheu kokën dhe pasi i buzëqeshi në shenjë falënderimi Zogës, që së fundi po e kuptonte, i tha:

— Merre pushkën, Zogë, — duke i treguar me gisht koburen e toger Zeres, — deri në fishekun e fundit të qëllojmë. E n'u djegjtë kjo shtëpi, bashkë me ne do të digjet. Burrnesha ime. Trimëresha ime...

Zoga iu bind me urtësi dhe zuri pozicion pranë drifates.

Manit i shkëlqeu fytyra e në dorë shtrëngoi fort bombat.

Ai priti një copë herë gjersa u grumbulluan shumë fashistë në oborr, pastaj ngriti dorën ku mbante bombën dhe, si kapi me dhëmbë unazën, e tërhoqi dhe e hodhi me forcë në mes të ushtarëve të Duçes.

Babai i Zogës po kthehej nga kullota. Ai qëndroi mbi një breg dhe me dorën vënë si strehë u mundua të dallonte ç'po ndodhët në fshat. Në atë kohë breshëritë shpërthyen nga të gjitha anët rreth shtëpisë së tij. Gurët e latuar të dritat e u qëndisën e u bënë pulla-pulla nga plumbat.

Mani, pasi pati vërvitur bombën e parë, po bëhej gati të qëllonte me të dytën, por atë çast dëgjoi një të therur në shpatull pastaj shpina sikur iu djersit. Trupi iu ligështua. Uli sytë dhe pa se si mbi këmishë qenë formuar njolla gjaku.

— Zogë! — thirri ai me gjysmë zëri duke mbështetur kokën pas murit të ftohtë.

Zoga u afroa pa e lëshuar pushkën nga dora.

I vuri dorën e majtë në sup e i foli:

— Man! Man!

Mani e pa drejt në sy.

— Zogë! — vetëm kaq mundi të thoshte ai.

Dera e shtëpisë poshtë kërciti. Heshtja e pushkëve u kishte dhënë fashistëve kohë të afroheshin në derë. Atë mund ta shqyeren fare lehtë. Ata ishin shumë.

— Man, mbahu, Man! Mbahu, burrë!

— Zogë! — vijoi Mani me zërin që i mehej gjithnjë e më shumë. Ai fliste duke lëpirë buzët e rrreshkura. Mbi këmishën e bardhë shpërthente vazhdimisht gjaku duke krijuar ca si trëndafila të kuq që zmadhoheshin gjithnjë mbi gjoksin e tij.

— Zogë!... Dasma jonë... mbaroi..., — në fytyrë iu nguros një buzëqeshje e hidhur.

— Man, — thirri Zoga duke e shkundur nga supet.

Mani i hapi sytë dhe u mundua të fliste. Fjala i mbeti në grykë. Vetullat e tij u rrudhën mbi ata sy që po e humbnin dritën ngadalë.

Ushtarët fashistë, që kishin mundur të futeshin benda në shtëpi, vrapani dhe e kapën Zogën për krahësh duke e shqitur me zor nga trupi i ngrontë i Manit.

Ajo nuk tundej nga vendi. Sytë i mbante në atë buzëqeshje të ngrirë në fytyrën e Manit. I bëhej sikur dëgjonte gjithnjë zërin e tij. «Dasma jonë mbaroi».

\* \* \*

Plaku Zekë dhe nënë Hasimja, të dy burrë e grua prisin me ankth orën kur do të takoheshin me Cenin. Duke pritur, plaku Zekë mendonte ditët e rinisë së tij, kur

hodhi së pari pushkën në krah e u radhit me trimat e tjerë. Një natë i ati kishte mbledhur gjithë miqtë e shtëpisë dhe të afërmit dhe po atë natë në fund të dhomës qe varur një pushkë më shumë: Pushka e Zekë Velisë, një pushkë e vjetër, që shkëlqente midis pushkëve të tjera, se Zeka i ri e kishte lyer e pastruar tërë atë ditë. Kur kishte folur i ati, kur kishin folur miqtë dhe të afërmit, Zekës së ri i kishte gufuar gjoksi nga ato që ishin thënë pér të. Dhe kur e kishte zënë gjumi, atë natë kishte bredhur rrugëve anembanë pér të dhënë lajmin se edhe ai do të mbante pushkë si të gjithë trimat e tjerë. Kështu, pas asaj nate, plaku Zekë e pat çuar jetën me pushkë në krah. Gjithë jetën ai s'e kishte hequr atë nga supi. Tek mendonte këto, vuri re se zjarri në vatër thuajse qe shuar e ai ndjeu të ftohtë në trup. Hodhi sytë mos po kotej e shoqja gjökundi në ndonjë qoshe, pastaj e thirri disa herë me zë të lartë. Vetëm ulërima e erës përtej dritares iu përgjigj. «Si iku ky Mani!» — pëshpëriti dhe u ngrit në këmbë. Hapi derën e dhomës. Në atë çast u dha e shoqja në derë, e cila ia bëri me dorë të heshtte. Pastaj e ftoi të shkonin të dy te frëngjia. Atje u ngjeshën të dy e mbajtën vesh. Ajri i ftohtë që futej nëpër frëngji ua rrëqethi trupin. Prozhmi përpara shtëpisë gumëzhitë nga era e ftohtë. Lisat e gjatë luhateshin në sfondin e zi të asaj nate pa hënë. Në oborr dikush lëvizte si hije, po hapa pér çudi nuk dëgjoheshin. Hijet që lëviznin ishin xhandarët. Ata u shpërndanë në të dy anët e koshit të zbruzur të misrit. Burrë e grua pritën disa minuta në heshtje. Pastaj plaka doli në dritaren tjetër po s'mundi të dallonte gjë as që andej. Në këtë kohë dëgjoi hapa të ngjiteshin nëpër shkallët e gurta. Ata hapa, që zhurmonin tek shkelnin mbi shkallët e kullës, s'i kujtonin asnjërin nga djemtë. Dëgjoi në heshtje edhe një çast. Në fund hapi derën e dhomës, mori pushkën dhe priti në errësirë.

Dera trokiti... Trokiti përsëri.

Pas pak u dëgjua një zë: — O Zekë Velia.

Po Zekë Velia nuk u përgjigj.

«I kujt është ky zë që thërret në këtë orë?»

Zëri u përsërit më me forcë:

— O Zekë Velia!

Kësaj here e njohu atë zë dhe u drodh. Ishte kryeplaku. Ai e dinte se kryeplaku s'vinte kurrë për të mirë. Me kryeplakun kishin hasmëri të vjetra. Plaku Zekë, po t'ia gjente rastin, nuk do ta kursente plumbin. Ai ia kish te vrarë vëllanë Zekës, por këtë askush s'e dinte. Paratë e tij e kishin lënë pa vëlla Zekë Velinë. «E gjen pushka ime vrasësin e vëllait», — pat thënë Zekë Velia. Kryeplaku i trembur kishte shkuar te Dan efendiu, në xhami. Mblodhën të gjithë burrat e fshatit. Shkoi edhe Zekë Velia. Kryeplaku u betua me kuran në dorë se nuk ia kishte vrarë vëllanë Zekës. Po nuk i besoi Zekë Velia, se e njihet kryeplakun ç'dhelpër ishte. Që atëherë shihe shin rrallë e nuk i flisnin njëri-tjetrit...

— Zekë Velia!

Plakut i gufone gjoksi kur dëgjonte zërin e tij, që s'ia kishte shkelur pragun e shtëpisë prej disa vjetësh. Dhe ja, kishte ardhur pas mesit të natës. Vallë ç'kërkonte ai qen në këtë orë?

— O Zekë Velia!

— Kush je?

— Hape, o Zekë, se jam kryeplaku.

Plaku heshti. Era ulërinte.

— Pse ta hap në këtë orë? Ti e di fort mirë se në pluhurin e oborrit tim nuk gjenden gjurmët e tua ç'prej disa vitesh. Orë e kobshme të ka sjellë ty, o kryeplak!

— Po, — tha zëri përtëj derës.

— Po?! — ngriti zërin plaku Zekë. — Atëherë po të

përgjigjем si dua unë, o gjarpër boke! Se s'jam vetëm e s'ta kam frikën!

— Mos u ngut, Zekë Velia, po cilna derën se kemi do fjalë me ty, — thirri zëri. — Mani, yt bir, u ktheu pushkën italianëve dhe xhandarëve.

Nënë Simja s'po u besonte veshëve. «Ç'qe ky lajm i zi. Për së gjalli s'ta çel derën e shtëpisë, o njeri i shitur. S'lidhet Zekë Velia së gjalli. Mendove se po më bie lajm të hidhur, por dije se sot, më fort se kurrë, Zekë Velia është i fortë!» — Kaq tha dhe shkruhu pushkën.

Qiellin e vrenjtur nisën ta zhbirin ca fije të rralla drite. Qetësinë e asaj nate të gjatë e prishën krismat e pushkëve. Mbi muret e kullës binin dhjetëra plumbë. Ndërsa nga frëngjité e kullës atyre u përgjigjeshin pushka e Zekë Velisë dhe e nënë Simes. Dhe që atë natë malet kënduan:

*Natën vonë rrëthuan shpinë,  
Duen me vra, o, Zekë Veline.  
Muret e kullës zjarr kanë lëshue,  
Lufton trimi me gjithë grue.*

\* \* \*

Aksioni për prerjen e linjave telefonike u krye gjatë natës. Të pesë postat e xhandarmërisë nuk patën më lidhje me rrëthkomandën. Edhe rrëthkomanda nuk pati me ministrinë... Çdo gjë u bë sipas porosive të «Thepit». Ceni shkoi vetë i tretë në aksionin për mbytjen e lundrës. Roja qëndronte deri vonë dhe kur kishte lëvizje edhe gjithë natën. Dy brigjet e pjerrëta lidheshin me njëri-tjetrin me një kabllo të trashë mbi të cilin qe mbërthyer një makara e vjetër, e ngrënë nga përdorimi dhe e mbuluar nga

ndryshku. Lundra mbi valët e lumit dukej si një gjë e vjetër, si e harruar, që s'do të arrinte kurrë në bregun tjetër.

Ceni dhe dy shokët e tij e panë nga larg lundrën. Ajo duhej këputur sa më parë, se armiku priste t'i vinin forca të reja, të cilat do të kalonin me anën e saj dhe rrezi-kohej dështimi i aksionit. Ata u fshehën në pyll dhe aty nga mesi i natës iu afroan lundrës, e shkallmuani kavon dhe lundrën e morën dallgët tatëpjetë, duke e përplasur sa në një shkëmb në tjetrin. Më në fund atë e vuri rrjedha e lumit përpara e nuk u duk më. Në atë kohë Ceni dhe dy shokët e tij u nisën për t'u bashkuar me njësitin që vepronte në pyll për prerjen e telave. Ata do t'i prisnin në Kodër të Bushit.

— Aksionin e prerjes së telave dhe shkatërrimin e lundrës e kryen me nder shokët, — u tha Ceni duke i përqafuar një nga një me radhë. — Tani na mbetet aksioni tjetër edhe më i rëndësishëm. Nesër do të largohet grupei i oficerëve fashistë që kanë ardhur për të studjuar mundësinë e vendosjes së forcave të reja në këto anë. Ne duhet t'u tregojmë atyre se në këto male kanë për të gjetur vdekjen.

Pasi u tha këto, ata bënë planin se ku do të zinin pritat. Dhe u nisën natën nëpër pyll, që t'i gjente mëngjesi në pozicione.

Ceni e zuri priten në rrugën që dredhonte faqes së malit. Ai vuri re se prita te Guri i Bokës ende nuk ishte zënë. Atë vend do ta ruanin Zekë Velia dhe nënë Simja. Ajo priti duhej të qe zënë përpara të gjithave. Kështu kishte biseduar ai me prindët. Po pse nuk ishte zënë vallë? Ç'do t'u kishte ndodhur atyre? U bë shumë merak. Vendosi të priste.

Mëngjesi zbardhi. Era e kishte ulur vrullin e saj.

Ceni, pa u vonuar, u ngjit mbi kodër. Shpresa se mos

pleqtë kishin qëndruar më larg e bëri t'i ngjitej me një fryshtë kodrës. Guri i Bokës tani ndodhej aty, përballët. Ai vështroi pas çdo guri e dëllinje, u thirri në emër pleqve, por askush nuk iu përgjigj. Atëherë Ceni vendosi ta zinte vetë pritën ku duhej të ishin i ati dhe e ëma. U shtri midis dy gurëve ku formohej një si guvë e ngushtë dhe të dy gurët që ngriheshin anash dukej sikur ishin ngritur për t'i ruajtur atij krahët.

Rugë këmbësore që kishte përparrë ngjante si një vijë e zezë që fshihej pas kthesave të malit. Ceni vërente gjithnjë malin dhe rrugën. Pastaj pa vendin ku qenë zënë tri pritat e tjera nga shokët e tij. Dy pritat e para do të qëllonin njëherësh, ndërsa e treta, që ndodhej në krahun e djathtë të Cenit, nja treqind metra më larg tij, do të mbyllte rrugët e tërheqjes.

Nga fshati u dëgjuan të shtëna. Të shtënat u përsëritën radhazi. Ai dëgjoi me vëmendje duke vështruar andej nga i bëhej se vinin krismat dhe u bind se diçka po ndodhët atë mëngjes të vrenjtur. I vetëm në pritën e Gurit të Bokës, Ceni shtrëngoi fort pushkën, me vështrim të ngulur në rrugën këmbësore që kalonte nën këmbët e tij dhe me mendjen te prindët, që ende s'po dukeshin. Dhe priti duke nëmëruar minutat e gjata.

Një tufë rosash fluturuan duke krakaritur përparrë syve të tij. Ato bënë një kthesë mbi lumin e tërbuar pastaj platinët krahët dhe u ulën mbi një arë të rrethuar me gardh. Gardhi nxinte. Ceni ndoqi me sy gardhin që kalonte anës rrugës këmbësore. Ashtu, mbështetur mbi gurin dhe me pushkën gati, zemra i rrahu fuqishëm. Atë çast iu bë se iu shkurtua largësia deri te ajo rrugë, ku tani po kalonin një grup oficerësh fashistë hipur në kuaj.

Kuajt, me atë ecjen e tyre elegante, çanin përmes rrugës së ngushtë të malit, dhe kalorësve u dukej sikur ua shtonin madhështinë.

Dikush nga ata tregoi me dorë rrugën që duhej të ndiqnin më tej, pastaj kalorësit u tërhoqën frerët kuajve. Kuajt, duke mbledhur kokën në gjoks, u hazdizën dhe me bishtin ngritur lart morën udhën me vrap.

Ceni i ndiqte nëpërmjet fletës së shenjestrës. Ai e dinte se cilin duhej të qëllonte të parin. Priti derisa u afroan. Qëlloi. Vështrimi i tij shkoi më shpejt se plumbi. Dëgjoi edhe të shtëna të tjera, po kalorësit që pati vënë në shënjestër nuk ia ndau sytë. Atij iu bë sikur s'e kishte qëlluar. Shënoi përsëri mbi të dhe ai shkau nga kali siç shket gjarpri në folenë e tij kur ndien rrezikun.

Kali vrapoi rrugës i trembur.

Ceni qëlloi. Shokët qëlluan. Fashistët zunë pozicione në të dy anët e rrugës. Një pjesë u zmbraps, por atë çast u dëgjuan të shtëna nga prita e tretë.

Cenit iu duk vetja si në èndërr. Qëlloi. Dhe qëlloi mirë. Kur hodhi sytë nga armiku dhe vuri re panikun që plasi midis tyre, e mori me mend gjëzimin që do të ndiente «Thepi» kur ky do t'i raportonte.

Disa minuta luftë. Ceni qëndroi deri sa iu mbaruan fishekët. Fashistët, ata që patën shpëtuar, vraponin të alarmuar për të shpëtuar lëkurën.

Hodhi sytë nga fshati.

Në atë kohë një re e zezë tymi lartësohej mbi fshat. Tymin e shtynte era dhe e shpërndante maleve e lugjave.

Cenit iu errën sytë kur pa nga kulla e tij flakën e kuqe që ngrihej drejt qiellit si gjuha e një përbindshi...

Dhe harroi se duhej larguar nga prita. Tani ai e kuptoi pse kishte mbetur fill i vetëm në pritë.

*Zekë Velia trim i rrallë,  
Ç'po lufton me grua e djalë,  
Dielli yje u vuri në ballë.*

Ushtarët fashistë që kishin djegur shtëpinë e tij ngjitheshin faqes së thepisur të malit duke qëlluar.

Flaka e kuqe e vatrës së ndezur ia preu për një çast gjunjët dhe nuk po mundte të lëvizte së andejmi. Ai donte të sulmonte tani edhe me gurë. Pushka e tij s'kish-te asnjë fishek.

«Po pushka duhet mbushur përsëri, për beteja të reja», — tha ai me vete dhe mori udhën drejt malit, ku e prisin shokët atë mëngjes të përgjakur.

## Q Y T E Z A   E   B A R D H Ë

Atë mëngjes drejtori i ndërmarrjes gjeologjike, një burrë i gjatë rrëth të dyzetave, me flokë të shkurtër e të dredhur, fytyrëhequr, ecte me hap të nxituar, duke u përshtëndetur me kalimtarët. Ai kishte më pak se një vit që ishte ngritur nga punëtor në drejtor ndërmarrje.

Pjetër Ahmeti dhe sekretari i byrosë së partisë të ndërmarrjes, Sotiri, e panë, kur u kaloi pranë dhe që të dy shkuan drejt e në zyrën e drejtorit. Drejtori i priti buzagaz. Pas ca iu drejtua sekretarit të byrosë:

— Presim inxhinierët, apo fillojmë qysh tani?

— Ata do të vijnë shpejt. Sidoqoftë, ndërkohë le të dëgjojmë se ç'të reja na sjell shoku Pjetër nga qyteza e tij, — u përgjigj sekretari.

Në zyrë nisi të ndihej vetëm zëri i Pjetrit, që raportonte për punimet në ekspeditë.

Drejtori e pyeti atë për kërkesat që kishin lidhur me bazën materiale e përfurnizimet gjatë stinës së dimrit, ndërsa Sotiri u interesua për punëtorët, ai deshi të dinte sa prej tyre i kishin marrë familjet me vete dhe a i kishin vendosur në punë, etj. Më në fund pyeti për Naddon. Ajo ishte e para vajzë fshati që kishte filluar punën në qytezën e bardhë të gjeologëve.

Në korridor u dëgjuan hapa. Kryeinxhinieri, një burrë i shkurtër me trup të bëshëm, me një çantë të zezë

në dorë, trokiti dhe, si u përshtendet, i zgjati dorën Pjetrit. Pastaj u ul në një karrige. Dera ishte hapur. Pjetri deshi ta mbyllte por u ndodh përballë me inxhinier Qemalin, një djale i ri, që kishte mbaruar studimet në Tiranë para një viti.

— Sektori B. nuk përgjigjet, shoku drejtor, — tha ai.

— Fillojmë, shokë, — foli Sotiri, duke u ngritur në këmbë. — Siç e dini, sot jemi mbledhur që të vendosim përfundimi i për çështjen e punimeve gjeologjike të shpimit në lartësinë 387 në Tellën e Egër. Për këtë kemi thirrur edhe sekretarin e organizatës së partisë të ekspeditës, shokun Pjetër Ahmeti.

Sekretari i byrosë fliste ngadalë, duke i vështruar me radhë, drejtorin, kryeininxhinierin, Pjetrin dhe Qemalin, i cili kishte kryer kërkime në atë ekspeditë.

— Shokët tashmë janë njojur me projektin e punimeve të paraqitura nga inxhinier Qemali, — vijoi Sotiri, — le të diskutojmë rrith projektit dhe le të vendosim!

— Kisha diçka, — tha kryeininxhineri; — më duket e parakohshme të diskutohet projekti pa u vendosur më parë nëse do të vazhdohen apo jo punimet në lartësinë 387.

Sekretari u kollit:

— Ju dyshoni, — tha ai, — në punën e inxhinier Qemalit, i cili, si i ri, mund të ketë bërë edhe ndonjë gabim.

— Më vjen keq që mendoni kështu. Inxhinier Qemali është kolegu im.

— Po ne, shoku kryeininxhiner, ç'jemi?

— Flisni më qartë, — iu kthyesh drejtori kryeininxhinerit. — Ne kemi shumë ditë që po diskutojmë për pikat e shpimit, për rezultatet e analizave laboratorike, etj.

Kryeininxhiner Vironi u ngrit dhe nisi të fliste duke rrotulluar në dorë një laps me majë të gjatë e të mprehtë si ata që përdoren për vizatim teknik. Ai ishte kundër zba-

timit të punimeve të shpimit në lartësinë 387 gjatë stinës së dimrit. Sipas tij, atje, jo vetëm që ishte terreni i vësh-tirë, por lindte një pikëpyetje e madhe edhe në punën kër-kimore.

— Unë mendoj, — vazhdoi ai, — se është më mirë të planifikojmë më pak shpime gjatë dimrit.

— Po sikur të jetë e nevojshme e kundërtat?, — pyeti inxhinier Qemali.

— Ne s'mund të ecim me «sikur»!, — iu përgjigj tjetri prerë.

Sekretari i byrosë tundi kokën.

Inxhinieri u skuq në fytyrë dhe heshti. Kur përfundoi së foluri kryeinixhiner Vironi, ai u ngrit dhe foli shkurt:

— Unë, si inxhinier i ri, edhe pse pa përvojë, kam krijuar bindje për të gjitha ato që parashtroj, se bazohem në punën, në djersën që kemi derdhur të gjithë, si edhe në të dhënët pozitive të analizave laboratorike. S'mund të lë pa theksuar se gjatë dimrit është mjaft të vazhdojmë vetëm me një pikë shpimi. Nga ana tjetër, na duhet të llogarisim perspektivën. Unë i besoj lartësisë 387. Atje ka sasira të mëdha minerali. Kjo na i ngroh zemrat, ndaj të mos tërhiqemi prej vështirësive.

Pas inxhinierit e mori fjalën Pjetër Ahmeti. Ai foli për punën e shokëve të tij në lartësinë 387, për besimin që ata kishin se do ta pushtonin atë atij dimri. Kryeinixhiner Vironi i dëgjonte, duke zhgaravat me laps në një letër të bardhë.

Më në fund u ngrit prapë Sotiri:

— Na duhet, shokë, — tha ai, — ta pushtojmë me çdo kusht lartësinë 387. Madje, të kryejmë atje edhe punime. Byroja e partisë e di se kjo është një detyrë e vësh-tirë, por ka besim se ju do ta kryeni me sukses. Vironi e Qemali të përfundojnë brenda këtij muaji çdo gjë që kanë

në duar! Njëkohësish të fillojë edhe furnizimi! Më 29 nëntor sondat të buçasin në lartësinë 387!

Me të mbaruar mbledhja Pjetër Ahmeti u nis për në ekspeditë. Diskutimet që kishte dëgjuar e shoqëruan atë në çdo hap.

Ai ecte drejt lartësive me mijëra ëndrra e mendime në kokë. Para syve i dilnin portretet e shokëve, malet, e tjera. Gryka e thellë e lumit oshëtinte. Pjetri vështronte kataraktet e bardha si qumësht deleje, vështronte shoferin, pastaj majat dhe mundohej të merrte me mend ku ndodhej kuota 387.

\* \* \*

Qyteza e bardhë ndrinte. Ndërtesat e barrakat në shezin e madh dukeshin të bardha si vetë malet. Perdja e natës varej deri poshtë në luginën e thellë, tek shkëlqenin dritat e sondave. Nuriu ecte i heshtur dhe ndaloi, kur vështrimi i tij ndeshi në ato drita të sondave.

Ai kishte qenë disa ditë atje. E njihte mirë atë vend, rrugët, kodrat, shkëmbinjtë, ortiqet. Njihte egërsinë e atij vendi, për të cilin malësorët thoshin se vlente vetëm për verim bagëtish. Gjithë ditën atje endej mjegulla. Natën ulërinte veriu si në shëndre. Le pastaj, kur binte bora dy, tre e katër metra! Nuriu hodhi sytë nga ana tjetër dhe pa luginën e thellë e lumin që gjarpëronte përmes maleve të larta.

Ai kishte qenë në fillim sondist, pastaj ishte bërë kryesondist. Të gjithë e lavdëronin. Para disa ditësh ishte pranuar edhe në Parti. Pikërisht për këtë e kishte thirrur një ditë sekretari, Pjetri.

Pjetër Ahmeti, apo që kthyer nga mbledhja, kishte

biseduar shtruar me Nuriun: «Na duhet me çdo kusht që ta pushtojmë Tellën e Egër!, — i pati thënë ai. — Atje do të kryejmë shpim gjatë dimrit e do të zbulojmë mineral. Vështirë do ta kemi vërtet, se dimri në këto anë është i ashpër. Po ne komunistët do të prijmë në ballë. Ti, Nuri, duhet t'i bësh për vete punëtorët me shembullin dhe fjalën tënde!».

Nuriu kishte ndier ngrrohtësinë e këtyre fjalëve. Ai i kujtonte ato sa herë merrte udhën e malit nëpër monopatë të ngushta, që të çonin te sonda, apo kur kthehej vonë në qytetin e bardhë përmes errësirës së natës, kur grykave era ulërinte si e marrë.

Që atëherë kishin rrjedhur disa ditë.

Nuriu me shokët e tij filluan punën. Ja, Rexha, Xaja dhe Sokoli, apo siç i quanin shokët «kreshnikët», gjithnjë dukeshin të qeshur dhe shpesh këndonin. Kënga e tyre ishte e gjatë. Kënga e tyre s'kishte të mbaruar. Ajo s'nnihte as kohë e as vend, as shi e borë e akull. Dita-ditës Nuriu e shihte se sa vështirë ishte të pushtohej Tella e Egër. Por, a duhej të tërhiqeshin nga udha? Kurre!

Kështu, duke ecur me këto mendime në kokë, ndaloj papritur përpara sallës së mbledhjeve. Era e malit tundte lehtë derën e lënë hapur. Salla ishte e zbrazët. Nuriu u hodhi një vështrim tryezave, stolave, stendave të kuqe përballë. Në gjoks dëgjoi të rahura të forta e në tëmtha dhembjë. Vështroi një copë herë malin prej nga vinte një erë e ftohtë. Atë natë do të punonte në turnin e tretë.

Kur hyri në dhomën e fjetjes, të gjithë ishin në krevate. Tre «kreshnikët» këndonin. Në mur një portret dhe tri çifteli ... Nëpër krevate kishte rroba të hedhura, në dysheme çizme. Tre «kreshnikët» këndonin:

*Kryesondisti ynë gjumëlehtë,  
ngrehu, të shkosh në turn të tretë!*

Nuriu kaloi përmes krevateve i heshtur. Dukej i vrenjtur, fytyrëzbetë, me pamje pak si të trishtuar. Tre «kreshnikët» e dinin pse vuante brigadier i tyre, ndaj i shkelën syrin njëri-tjetrit dhe vazhduan:

*Shumë vonon vera me dalë  
në Tellë të Egër, more djalë...*

Të tjerët qeshën. Qeshi edhe Nuriu vetë. Kënga pushoi.

— Brigadier, gati?, — pyeti Sokoli.

Nuriu e dëgjoi atë zë të njohur dhe, si u kthyte nga ai, tha:

— Gati. — Rexha hoqi çibukun e, duke nxjerrë nga goja tymin e duhanit, doli në rrugë. Shokët që dorëzonin turnin, sa i panë, u thirrën disa herë. Zëri i tyre përzihej me zhurmën e motorit dhe humbte nëpër natë.

Kur u afroan, brigadier i raportoi Nuriut se shtangat jepnin shenja bllokimi.

— Prapë do të kemi avari, — belbëzoi Nuriu. — Oh, sa keq! Planin si katërmujor më duket se nuk po e realizojmë as tani në kohë të mirë. Avari sot avari nesër!...

A kishte rënë në mendime. «Guri i fortë po na shkatajeron makineritë». Një hije e zymtë u nder në fytyrën e gjerë të Nuriut. Ngriti sytë dhe u hodhi një vështrim punëtorëve. Kur pa tre «kreshnikët», iu duk se sytë e tyre thoshin: «Ç'ke, o burrë, që e humbe fare?» Nuriu i pa, u çel pak në fytyrë, pastaj iu afroa sondës.

— Në Tellë të Egër kjo sonda jonë do të bëjë një gjumë të gjatë dimri, — tha Sokoli.

Rexha e Xaja heshtën. Era shtynte tutje nëpër skuta gjethet e thata, që zhurmonin lehtë.

— Kështu thonë vetëm dembelët, — tha Nuriu.

Sokoli, sikur ta kishte pickuar diçka, bëri dy hapa drejt Nuriut e foli:

— Mos ia hiq frerin fjalës, brigadier, se s'ta kemi borxh dhe as ta durojmë fyerjen, more vesh!

— Pra, ty, Sokol, të vjen keq, ë? Atëherë po e përsëris atë që thashë më parë, jo për të të fyer ty, por vetëm pér të thënë të vërtetën. Sonda jonë do të bëjë gjumë dimri edhe këtu e jo në Tellë të Egër, në qoftë se ne do të rrimë duarlidhur.

— Nuk është e mundur në lartësi të kryhet gjatë dimrit një metër shpim, o Nuri. Mos e ngatërrro me dembelizmin këtë! Ne duam të punojmë e të tejkalojmë planin, po vështirësitë s'të lënë.

Nuriu e vështroi në fytyrë.

— Ta tejkalojmë atje lart, — tha duke drejtuar dorën nga maja e malit. — Atje në Tellë të Egër.

— Atje shkojmë në pranverë, në verë e vjeshtë, por jo në dimër... Pak pika shpimi kemi këtu?

— Shumë bile, po sikur edhe një e vetme të jetë në Tellën e Egër, duhet llogaritur se sa vlen, sa mineral zbulohet me atë shpim. Këtë s'duhet ta harrojmë asnjëherë.

— Unë nuk jam dakord.

— Ti s'je dakord, se të ka mbërthyer interesи personal, rehatia...

— Prapë me fyerje, brigadier.

— More kujt i thua fyerje ti, xhanëm?

— Sokol, — pse nuk e lini më mirë këtë muhabet!, — tha Rexha. — Ne kemi ku bisedojmë. — Heshti një çast e iu drejtua Nuriut:

— Edhe ti, o Nuri, mos mendo se vetëm ato që thua vetë janë të drejta e duhet bërë medoemos ashtu. Unë do ta them këtë qysh në mbledhjen e parë që do të bëjmë.

— Thuaje, o Rexhë, pse të mos e thuash?, — tha Nuriu, po përgjigje nuk mori.

Ai punonte në heshtje. Ç'është e vërteta, ata ia njih-nin këtë veti, ndaj edhe e donin. Po kur ndonjë nga shokët bënte thyerje të disiplinës në punë apo tregohej i pakujdeshëm gjatë shpimit e nuk ruante sondën, ai nxehet: «Po këto janë më elementaret, more shokë!, — u thoshte. — Pa këto ne s'mund të punojmë, nuk mund të realizojmë planin». Kur ndodhnin avari ai qëndronte natë e ditë atje, deri sa bëhej zhbllokimi... Punonte njëloj si të tjerët. Në fushim ulej galic dhe s'ia ndante sytë motorit që heshtte.

Edhe «kreshnikët» punonin, po kënga s'u ndahej nga buzët. «Po këta, xhanëm, punojnë apo jo?», — kënga e tyre e nervozonte Nuriun.

Vonë, pas mesit të natës, kur të ftohtët u bë më therës e mbi trekëmbëshin e kullës luhatej drita elektrike, ai dëgjoi zërin e kryesondistit:

— Jepi djathtas! Hiqe me forcë! Ndihamoje, more Rexhë! Është gjithë ajo peshë. Fort, fort!, — zëri humbiste në vorbullën e erës.

Ai u afrua. Kur po futej në barrakën e motorit, pa fytyrën e hequr të kryesondistit. Prapë avari! Tjetri lëvizi dorën gjithë nervozizëm, uli çelësin dhe zhurma e motorit s'u ndie më. Nëpër të çarat e dërrasave të barrakës fërshëllente era e fortë. «Ç'të bëjmë?», — pyeti duke vështruar motorin që heshtte. Ndërsa nga tubat e hapur dilnin avuj të ngrohtë, që i përpinte era në çast. Të dukej se ajo erë e ftohtë do të ngrinte çdo gjë. «Pa filluar ende dimri, — i kaloi nëpër mend Nuriut. — Si do të vejë halli më vonë?».

Në barrakë u mblodhën të gjithë sondistët.

— Shtangat e kanë fajin, — tha njëri.

— Këtë e dimë, — ia priti tjetri.

Era përplasej me forcë pas dërrasave të barrakës, duke lëshuar ca krisma të thata si ato të breshrit.

- Kështu ndodhin avaritë, sa herë ndërrohen turnet, — tha Xaja.
- Sa herë ka pakujdesi, — tha Rexha.
- Flasim pastaj për «Tellë të Egër», — ia priti Sokoli.
- Planin s'e lëmë pa e realizuar, sikur..., — tha Sadiku. Nuriu ngriti sytë e duke vështruar tha:
- Të lumtë, o bablok, ashtu është! Ne do ta realizojmë planin edhe në Tellë të Egër. Mos të nisemi nga një avari që na ndodhi, por nga mundësitetë reale që kemi.
- Unë kam një mendim!
- Fol, Sadik!
- Të provojmë forcën tonë, të përveshim mëngët për të zhdukur avarinë!, — tha ai dhe, pa marrë përgjigje, thirri:
- Babin, shpejt, babin! — Bëri më tej nëpër errësirë sikur të donte të rrëmbente atë peshë të rëndë hekuri, që ia thoshin emrin «babì» e me të të zhbllokonte shtangat.
- Shokët e ndoqën pas. Nuriu me kryesondistin, pasi panë shtangat e zhytura në thellësi, kontrolluan tubacionet e ajrit e u rikthyen në barrakë. Tre «kreshnikët» këndonin.
- C'njerez të çuditshëm!, — tha Nuriu. Kryesondisti i pa e buzëqeshi:
- I kanë shokët të rrallë.
- Tjetri pohoi me kokë. Kënga e tyre asnijëherë s'i që dukur më shqetësuese se sa tani, që kishte heshtur motori. E çudiste një gjë. Si u dilte kënga? Ai u afrua e, kur u fut midis tyre, pa se era e ftohtë e bjeshkës nuk ua kishte përtharë djersët e ballit, ndërsa tingujt e bukur të këngës i përcillte tutje.
- Po kënga pushoi papritur. Ata u entuziazmuani në fillim duke pandehur se aq e paskësh pasur avaria. Nuriu, pasi i kontrolloi edhe një herë, urdhëroi të ndizej motori.

Ata rrinin në pritje, duke vështruar kryesondistin që ishte zhytur i téri në punë dhe që herë pas here kërkonte ndonjë çelës apo fliste nën zë, duke lëshuar ndonjë të sharë që askush s'e dëgjonte. Shokët as që ia vinin veshin. Kryesondisti mbasë e ndiente ankthin e pritjes së gjatë të shokëve, ndaj për t'i qetësuar u thoshte:

— Seç ka një kleçkë malukati!...

Motori nisi të punonte, po nuk ishte zhurma e tij e njohur. Ajo zhurmë ngjante më tepër me një rënkim.

— Ta kishim mbajtur ndezur malukatin, — tha Rexha, prej shqetësimit se mos nga të ftohtët kishte ngrirë uji brenda në të.

— ...

— Sikur s'ia dimë huqet.

— More, po kontrolloje atë kandelën njëherë!

— E ç'faj ka kandela?!

— Prisni!, — foli kryesondisti, duke vënë duart mbi pompën e thithjes. Pas pak motori filloi të punonte ritmikisht. U vendosën shtangat. Ato zhyteshin në thellësi të tokës. Të gjithë prisnin me ankth rifillimin e shpimit. Po në kohën që koronka takoi në shkëmb, u dëgjua një krismë e fortë, pastaj shtangat u drodhën

— Prapë avari?!

Mëngjesi donte edhe pak të binte mbi male. Punëtorët e kishin rrethuar sondën e tyre dhe e vështronin të heshtur. Ata s'ndienin as ulërimën e erës, as lodhjen e natës nga mërzitja që shkaktoi avaria e përsëritur.

Malet filluan të buzëqeshnin nga rrezet e para të agimit të ftohtë.

— Po vjen Pjetër Ahmeti!, — tha dikush me zë të ngjirur, sikur ta kishte zënë rrufa.

— Edhe inxhinieri.

— Ç'do t'u themi?, — foli njëri, po askush s'e dëgjoi.

Sonda heshtte përpara tyre. Malet po përfakeshin ngadalë nga rrezet e para të diellit.

Nuriu qëndronte si i ngurosur në vendin e tij të punës.

— O Nuri, eeeheeej!

Ai ngriti sytë dhe, kur dëgjoi përsëri zërin që e thërriste, gjoksi i gufoi, e, tek mbushte atë me ajrin e ftohtë të bjeshkës, ndiente një zbrazëti të pafund. U mat të përgjigjej, po zëri s'i doli. Dëgjoi zërat e shokëve që u përgjigjën:

— O heeeeheeej! Oheheheej!

Malet përsëritën: «Ohehej, oeheehej!». Ata zëra si-kur e ngrohën Nuriun. Ai buzëqeshi për herë të parë, duke vështruar shokët.

Ai që quhej Asim, trokiti ashtu i heshtur në zyrën e Pjetër Ahmetit. Pjetër Ahmeti vuri buzën në gaz duke i treguar një karrige e i tha të ulej. Asimi ishte njëri prej sondistëve të parë të kësaj ekspedite. Ai kishte bërë një kurs tremujor në Tiranë dhe që atëherë punonte në ekspe-ditat e zonave të thella të Alpeve. Pjetri e pyeti për disa hollësi, që e bënë të dyshonte se mos i kishte ndodhur gjë në shtëpi, por shpejt e kuptoi se tjetër gjë e preokuponte Asimin.

Pjetër Ahmeti kishte biseduar atë mëngjes me Nuriun vetëm për Sokolin. E kishte pyetur:

— Pse kundërshton Sokoli të vejë në Thellë të Egër?

— Nuriu i qe përgjigjur vetëm duke i thënë se Sokolit i dukej e pamundur që të kryheshin punime gjeologjike në dimër në lartësi të atilla si ajo e Tellës së Egër.

Nuriu e kishte kundërshtuar.

— Ç'e shtyn tjetër Sokolin? A ke biseduar ti, Nuri, me të? Jo. Atëherë merru me të. Ai mund të bëhet një pu-

nëtor i dalluar, po t'i qëndrohet pranë. Mbaje afër, — e këshilloi Pjetri dhe Nuriu doli. Pjetrit i kujtohej dita kur kishte ardhur në ekspeditë Sokoli. Skuqej kur fliste. Në mbrëmje të asaj dite mbante një çifteli në dorë.

«Po këtë ku e gjete?», — e kishte pyetur.

«Në shtëpi».

«Paske ardhur me çifteli në punë».

«Po. Më tha baba: — Merre çiftelinë me vete, o bir! Se, edhe kënga është si arma».

Pjetri kishte tundur kokën dhe e kishte vërejtur me admirim atë, që dinte aq mirë t'i endte gishterinjtë mbi ata dy tela të hollë që dridheshin e tingëllonin, duke lëshuar tinguj të ëmbël.

Dera trokiti. Pjetri ngriti sytë e, kur pa Asimin, u shkëput nga mendimet.

— Të thirra, Asim, për një çështje. Kemi menduar që ti ta marrësh familjen këtu. Shtëpitë i ndërtuam dhe janë gati. Ato duhen mbushur me njerëzit, që do të punojnë në qytezën tonë e lart në male.

Asimit i erdhën krejt të papritura këto fjalë, ndaj ai, duke e parë drejt në sy sekretarin, tha:

— Unë nuk kam bërë një kërkesë të tillë, shoku Pjetër, kurse shokët e tjerë po.

Pjetri ndezi një cigare.

— Edhe ata do t'i sistemojmë patjetër, por menduam që edhe ne të gjithë t'i marrim këtu gratë dhe fëmijët. Asgjë të keqe nuk ka, përkundrazi, qytezës sonë do t'i shtohet gjallëria. Le që pastaj kemi edhe nevojë. Ti e shikon që në mensë, në kuzhinë, në dyqane na mungojnë njerëz, ose kemi vënë burra në vend që t'i shfrytëzojmë si forca pune për atje lart. Ti e di, Asim, që ne këtë dimër do të punojmë dhe në Tellë të Egër. Vështirë do ta kemi, apo jo? Prandaj mendojmë t'i kemi familjet pranë.

Asimi pohoi me kokë dhe u skuq në fytyrë.

— Për t'i përballuar vështirësitet, — vazhdoi Pjetri, — na duhen prapavija të forta. Ja, dy detyrat tona, Asim: Ta bëjmë qytezën tonë një vendbanim të vërtetë gjeologësh. Hë, si thua?! Së shpejti martojmë edhe Sadikun. E pra, ai s'e kishte të lehtë të vendoste. Ti e di si është fejuar. Kur i propozova që të martohej shpejt se do t'i jepnim edhe shtëpi, ai më tha me shaka: «Aman, more shoku Pjetër, se jam gati të shkoj e ta rrëmbej natën». — Pastaj më tregoi se si i kishte ardhur shpirti në majë të hundës: «Tre vjet kemi që jemi fejuar e ata të nuses ende duan pajë, pajë, pajë. Kjo do të thotë: para, para, para. Unë merr këtej lekë e dërgo andej!» — Mendoam të shkonte edhe një herë atje e të fliste shtruar me prindët e nuses. Dhe ashtu bëri. Kur u kthye më tha: «Me të lutur s'u bëka!» — Unë e pashë i trembur. Kujtova mos kishte bërrë ndonjë proçkë. E di ç'u kishte thënë krushqve: «O do të ma jepni tani, o mbajeni me gjithë pajë!» — Atë natë s'e kishin zgjatur më. Në mëngjes krushka i qe përgjigjur: «Mirë, o bir, të paktën në pranverë, sa të bëhem i gati...». — Sadiku e kishte kundërshtuar: «Dimrin do ta bëjmë në Tellë të Egër...». — Kështu pra, së shpejti martojmë Sadikun. Do ta gjallërojmë jetën në qytezën tonë. Si thua?, — pyeti për së dyti Pjetri. Asimi qe zhytyr në mendime. Ç'mund t'i thoshte Pjetrit, që nuk e dinte, bile as nuk mund ta merrte me mend se si e kishte punën ai. Asimi qe djalë i vetëm. I ati qe ngritur ta fejonte e ta martonte, sepse donin një nuse e cila të shërbente në shtëpinë e re, që sapo e kishin ngritur, pastaj edhe t'ua mbushte me nipa e me mbesa. Asimi nuk kishte bërë fjalë, as kishte kundërshtuar, kështu që ata, Asimi dhe Zana, qenë fejuar e martuar jo vetëm pa u njobur por edhe pa e parë njëri-tjetrin deri ditën e martesës. Zana ishte nuse e mirë, e bukur dhe ai djalë i urtë, i sjellshëm. Kështu dashuria lindi vetëm pas martesës. Po kjo, veç, qe një rastësi.

Asimi ua kishte hedhur fjalën edhe herë të tjera prindëve që ta merrte Zanën me vete, përpara se t'i thoshte Pjetër Ahmeti, por i ati, jo vetëm që e kishte kundërshtuar në mënyrë të prerë, por edhe i kishte thënë të kthehej ai në fshat. Këto mendonte Asimi, kur doli nga zyra, ndaj pyeste veten përsë s'ia kishte thënë këto Pjetër Ahmetit.

Kaloi një javë dhe Asimi ende nuk kishte vendosur të shkonte në fshat. Një pasdite, ndërsa rrinte mbështetur pas një ahu, e shihte inxhinierin tek luante ping-pong me punëtorët mbi një dërrasë të gjerë që shërbente si tryezë. Hodhi shikimin te godinat e reja që kishin ndërtuar për familjet. Pranë tyre nxinte stani i drunjtë, ku ishin strehuar për herë të parë. Ai stan kishte qenë vatra e parë nga kishin sulmuar malin, shkëmbin, kishin ngritur qytetëzën e kishin çarë galeritë. Kur ngritën barrakat, nuk kishin më nevojë për atë stan, megjithatë punëtorët nuk e prishën, tërhoqën derën dhe tani e quanin muze të qytetëzës së bardhë, sepse aty kishin myllur kujtimet e ditëve të para, të përpjekjeve, të fitoreve të tyre të fillimit.

— Ç'ke që mendohesh, o Asim?

Asimi e njohu zërin e Nuriut, po s'i dha përgjigje. Tjetri, që i shkoi pranë dhe u ul në krah të tij, i tha:

— Deri në gjysmë të malit ngjitet makina, pastaj transportin do ta bëjmë me krahë.

— Të duket e lehtë t'i ngresh sondat në krah, ty, a?

Nuriu qeshi.

— S'ë kam fjalën për sondat, jo. Mora vesh se ti do të vesh në fshat të marrësh nusen, apo jo? Shoku Pjetër më tha se të gjithë, pa përjashtim duhet të sjellin familjet. Pra, them për plaçkat e shtëpisë. Hë, si e ke syrin? Unë për vete do ta sjell familjen, i kam dërguar fjalë plakut. E di si tha shoku Pjetër? «Në qoftë se ju do t'i sillni të gjithë familjet këtu, ne jo vetëm do të plotësojmë vendet bosh, që kemi në lokalet tona, por do të krijojmë edhe një

brigadë me gratë që punojnë në kooperativë». — Bukuri, për besë bukuri, hë?

Nuriu priti një copë herë, dhe si nuk mori përgjigje, e nxiti Asimin t'i tregonte se ç'e pengonte për të vepruar.

Më në fund Asimi ia tha të gjitha. Nuriu u çudit dhe po atë natë bisedoi gjerë e gjatë me Pjetër Ahmetin.

Sokoli ishte ulur mbi një gur, pinte duhan e mendohet. Vështronte mu përpara këmbëve të tij. Njerën do të e kishte mbështetur grusht në faqe.

— Merrja këngës, o Sokol!, — i thirri dikush nga larg, por ai s'dha përgjigje.

— Të janë mbytur gjemitë bre?!

Sokoli ktheu kokën dhe, kur pa Nadon, ftyra i shkëlqeu.

— Cilat gjemi, moj?

— Ato që të çojnë në Tellë të Egër, — tha ajo dhe iku duke qeshur.

«Edhe kjo e paska marrë vesh! More po kush ia tha edhe ç'e shtyu xhanëm?! Unë kam mendimet e mia për Tellën e Egër dhe s'ka njeri që ma mbush mendjen se atje mund të kryhen punime në dimër dhe pikë».

— O Sokol, e di si më dukesh tani?

Ai e pa Nadon nga larg.

— Si ata që s'kanë punë. Kërko andej nga fshati mos kanë ndonjë vend për rojë. Shko pa vonuar, mos e humb rastin!

— Ja, do të të pyes ty mos më merr në kuzhinë, të punojmë bashkë.

— A, jo, në kuzhinë nuk pranohen «pleq».

— Po pse, moj, plak jam unë?

— Vetëm pleqve s'u punon gjuri për në Tellë të Egër.

Sokoli u ngrit, e pa me inat dhe u drejtua, pa ditur as vetë se ku.

— Ti, Nado, bën mirë të shikosh punën tënde.

— Unë shikoj çdo gjë në qytezën tonë, Sokol, ndaj të këshilloj që të mos ndahesh nga shokët. Shko në Tellë të Egër, Sokol, edhe ti!

Zëri i ëmbël i Nados e bëri Sokolin të mendohej. Ai po çuditej pse pikërisht ajo, Nadoja, thoshte të ikte?! Të largohej prej asaj, që ia bënte më të bukur qytezën e bardhë.

Aty nga mesdita qielli qe vrenjtur. Pas pak filloj një shi i rrëmbyer me breshër. Topthat e breshërit kërcenin në sheshin e qytezës së bardhë. Çatitë prej dërrase pishe kërcisin, grykat ushtonin nën retë e varura. Duhej transpor tuar sonda për në Tellë të Egër. Automjetet nuk shkonin dot. Sonda duhej mbartur në krahë. Kolektivi i punëtorëve të ekspeditës kishte marrë zotim ta transportonte sondën në krahë. Terreni nuk lejonte të përdornin mjet tjetër.

Ata vendosën: «Më 29 Nëntor sonda jonë do të jetë në Tellë të Egër».

Ishin ditët e fundit të nëntorit dhe zotimi duhej mbajtur. Transportimi i sondës do të bëhej me krahë. Një ditë ata u ngritën pa zbardhur mirë. Binte një vesë shi. Bjeshka dukej e zymtë. Rrugëve, lëndinave anës gurëve, kudo ku më parë gjelbëronte bari, tanë kishin vërvshuar uji e balta, që dukej e zezë sikur të qe anilinë qymyri.

Punëtorët e vendosën sondën në ca drunj të gjate duke e kryqëzuar dhe e lidhën me tel e litarë. Kjo do t'u jephte mundësi ta kapnin shumë vetë njëherësh.

— Ta provojmë!, — u dëgjua një zë e punëtorët u përkulën, por... sonda nuk lëvizi nga vendi. Ata drejtuau

trupin. Përsëri sonda nuk ngrihej. Ata vërtet ishin shumë, por pesha e sondës ishte tepër e rëndë. Dhe rruga nuk ishte e sheshtë. Ajo dredhonte faqeve të pjerrëta të malit.

Bubullimat gjëmonin. Dhjetëra sy qenë mbërthyer mbi atë kullë të rëndë metalike, që ngjante si një shkëmb i shkëputur nga mali. Punëtorët ishin qullur nga shiu dhe nga djersët.

— Ta provojmë edhe një herë!, — i ftoi Nuriu.

— Kujdes, shokë!, — thirri dikush. Ata të krahut të djathëtë i ngriten më parë dhe gjithë pesha e motorit rëndoi në anën tjetër. Drunjë shkanë në gurët e lagët dhe bashkë me ta edhe sonda. Të njëmbëdhjetë punëtorët e krahut të majtë vunë gjoksin. Duart e tyre si kanxha e frenuan atë vrull të ethshëm, që mund t'u kushtonte shumë. Të tjerët e tërhoqën me forcë në drejtim të kundërt, që ajo të merrte drejtpeshim.

Heshtje.

Dëgjohej vetëm fishkëllima e lisave dhe era e ftohtë.

— Si t'ia bëjmë?

— Sonda nuk ngrihet...

— Kot e kemi.

— Shokë, ta provojmë edhe një herë!

Një vetëtimë çau qiellin afër syve të tyre.

— Kujdes, shokë, ndahuni në rregull, që të mos pengjmë njëri-tjetrin!... Hajt, shpejt! — Ky qe zëri i Nuriut, që, ndonëse ishte bërë qull, ngaqë kishte hequr edhe mushamanë se e pengonte në lëvizje, s'donte t'ia dinte e s'i rrihej në një vend.

— Ho-oop, si artilierët! Ho-oop!

Fytyrat e tyre u ashpërsuan e krahëve iu nderën muskujt e fuqishëm. Pesha e rëndë s'donte të shkëpuesej nga toka.

— Ho-oop! Edhe pak, se lëvizi! Po u lëviz mësohet

me udhën! Edhe neve na mësohen krahët me të. Hajt, o burra!

— H-oop, si artilierët! Një-dy-tre, hop! Edhe një herë! Gati? Një, dy, tre! Ho-ooop! Ja, lëvizi prapë, apo jo?

— Ku janë «kreshnikët?», — pyeti Pjetër Ahmeti, që kishte shtrënguar fort në duar drurin dhe mundohej bashkë me shokët ta ngrinte mbi supe.

— Duhet përforcuar krahu matanë, — tha Pjetri, — se këtej kemi kreshnikët; s'ua ha qeni shkopin për punë këtyre! Apo s'janë edhe të fuqishëm.

Të tjerët buzëqeshën duke vështruar sondën. Sytë e tyre sikur thoshin: «Kjo virane duhet ngritur». Po t'i shikoje ata dhjetëra burra të fuqishëm me atë peshë të rënëdë në krahë, mund të thoshe se po stërmundoheshin kot. Po, pak nga pak dhe ajo zuri të lëvizte nga vendi e më në fund u vu në udhë. Ishin metrat e fundit të rrugës. Nata kishte zënë të binte pa u ndier. Në fytyrat e punëtorëve shihej lodhje, mundim... Kreshnikët këndonin:

*E bardhë moj në derë të stanit...*

Inxhinier Qemali ngjitej nëpër Tellë të Egër vetë i dytë. Ishte me një djalë të ri, që s'e kishin parë ndonjëherë. «Mbase është ndonjë koleg i inxhinierit», — menduan punëtorët. Kur u afrua inxhinieri, atyre u kishin mbetur edhe pak metra për të bërë. Nuriu kishte shkuar disa herë deri te sheshi ku do të vendosej sonda: madje kishte numëruar edhe hapat, pastaj kishte vrapiuar e kishte kapur atë drurin e tij dhe kishte nxitur shokët duke thënë 98... 94... 81... 76... 65... .

Inxhinier Qemali u fut shpejt midis punëtorëve.

— Një «lugë» për inxhinierin!, — tha Sokoli buzagaz.

— Edhe një për mua!, — tha djaloshi i panjohur që zuri vend pranë një punëtori dhe tendosi muskujt. Drujtë ishin të lagur.

— ...29 ...28 ...27..., — vazhdonte Nuriu.

— Gazetar!, — foli me shaka inxhinier Qemali. — Kujdes, se mos të thyhet pena nga pesha e sondës!

«Qenka gazetar ky djalosh!», — i pëshpëritën njëri-tjetrit punëtorët.

— Jo, përkundrazi, shoku inxhinier. Kështu mprihet më shumë pena.

Të tjerët qeshën. Qeshi edhe Nuriu.

Atë natë sonda u vendos në vendin e saj. Gëzimi mori dhenë. Lart, në trekëndëshin e kullës që çante qieillin, u ndezën një varg dritash. Ato drita u jepnin guxim tek kalonin shtigjeve, rrugëve të vështira.

Ky qe suksesi i parë. Po lufta, përpjekjet e tyre, sapo kishin filluar. Bjeshka dëgjoi melodinë e një këngë të re. Atë natë ra dëborë në male. Qyteza e gjeologëve u zgjua më e gjallëruar.

Zërat e tyre të fuqishëm e të gjëzuar dëgjoheshin në-për pyll. Qiellit vraponin vetëtimat e zjarcta. Nëpër gryka oshëtinin përrenjtë që zbrisnin nga malet me vrull si katarakte të bardha. Në qytezën e bardhë dritat ishin ndezur. Dikush qëndronte në kornizën e një dritareje dhe priste.

Pjetër Ahmeti pa orën e foli:

— Shikojeni Nadon! S'paska fjetur! Na paska pritur!

— S'paske fjetur, o Nado?, — i tha Nuriu, kur hyri në mensë.

Nadoja e vështroi buzagaz.

— Kujt i flihet! Neve na rrinte mendja te ju. U lodhët. Jeni të pangrënë.

— Tryezat e pastra tē zbræzëta tē mensës u gjallëruan nga zérat e punëtorëve, nga kënga e tre «kreshnikëve». Vetëm Asimi mungonte atë natë.

Asimi kaloi lëndinën e u fut në pyll; aty nxitoi hapat që tē dilte në atë bregoren prej ku shtëpia dukej më mirë. Zakonisht ai shkonte në shtëpi një herë në muaj. Ndërsa kësaj radhe kishte ndenjur një kohë më tē gjatë, plot dyzet e tri ditë. E kishte marrë malli për prindët, sidomos për Zanën. Atij s'i pëlqente aspak, kur Zana i pëshpërishte pranë veshit: «Humbe fare, o Asim... Nganjëherë më bëhet se tē kam harruar ftyrën...». Me këtë ai bindet se ajo, nusja e tij, mërzitej në shtëpi, ndaj ia priste buzagaz: «Ndërsa unë ty, Zana, tē kujtoj qartë gjithnjë. Ftyra jote e qeshur më rri pérherë në mendje. Mbase kjo ndodh ngaqë ne punojmë në lartësi tē mëdha...».

Këto po mendonte Asimi kur doli në bregore, e prej nga pa kullën e bardhë. Pérroi i thellë ushtonte mbyturi. Ndoqi me sy udhën deri atje ku ishte ara e tyre. Mundi tē dallonte tē emën që punonte në arë. Bëri disa hapa më tej. «Ja dhe Zana, ku po punoka me nënën».

Rrugën deri afër arës e bëri thuajse me vrap.

Zana e pa e para. Në fillim ajo u step. Pastaj u skuq në ftyrë e pastaj duke buzëqeshur tha:

— Shiko kush na erdhni, nënë!

— Çka the, oj bijë?, — pyeti e vjehrë duke vazhduar tē korrtë misrin hamullor; pastaj duke mbajtur ijet me dorë, drejtoi trupin, lëshoi një «oh» që shprehte lodhje dhe gëzim njëkohësisht. Hapi krahët e nisi tē çapitej drejt tē birit. Si u çmallën për disa çaste, nëna i tha Zanës që tē vazhdonte punën, se duhej mbaruar gjithë parcela. Kjo gjë e çuditit Asimin. Zana, e bindur vështroi në fillim tē shoqin, i buzëqeshi dhe vazhdoi tē korrtë.

- Asim, shko po deshe në shtëpi!
  - Jo, nënë, unë do të shkoj bashkë me ju.
  - Do të vonohemi, bir, kemi shumë për të korrur.
  - Nesër, o nënë, nesër; tani nuk punohet.
- Nëna drejtoi trupin, uli zërin e foli:
- Ka thënë yt atë, o bir, ta mbarojmë sot, e pa e mbaruar ne s'kthehemë në shtëpi. Shih malet, u zbardhën nga bora...

Asimi u çudit.

- Domethënë, ju paska dënuar!
- Jo, bir, po është jona. Na duhet për dimër. Me se ta ushqejmë atë lopë që kemi?...

Asimi ia dinte huget të atit, ndaj tani iu kujtua ç'kish-te ndodhur kur kishte shkuar djali i dajës tek ata në fshat. «Qe vjeshtë, ne të dy dolëm shëtitje nga arat e përroit, pastaj qëndruam te burimi, në atë lëndinën përtëj arës. Aty janë edhe dy arra të mëdha. Filluam të hanim arra. Dhe pse të mos hanim, kur ato ishin të pjekura dhe thy-heshin me dorë. Babai na kishte parë dhe më thirri mua. Shkova.

— Ç'bëni atje, mor gdhë?, — m'u drejtua mua. — Nuk e di ti se ato arra i kam ndarë për t'i shitur me nga një napolon kilen, kurse ju m'i, hani, që ju zënnshin fry-mën! Po pak arra ka këtu, a? Shikoni andej përroit, përtëj tokave, se ka arra në pyll sa të doni. Shko merre edhe atë zdapin dhe qërohuni, sa nuk ju kam kapur me dru. Kështu më tha babai, por unë nuk lëviza nga vendi. Ai më pa me inat, më bërtiti, por unë kundërshtova i vendosur, duke i thënë se s'kisha ç't'i bëja djalit të dajës.

Atëherë babai u xhindos dhe më ndoqi duke më sharrë: «More tutkun, more qurravec, po ti do të më mësosh mua, që të kam bërë kokën?!» — Unë ika, por djalit të dajës nuk i thashë që të mos hante arra...».

Asimi sikur u zgjua prej mendimeve nga një pshe-

rëtimë që ia kapi veshi papritur dhe vështroi të ëmën e Zanën, që ende korrnin misër.

— Po hajdeni tani, o nënë, mjaft punuat! Do t'i them edhe unë babës. Në errësirë mund të prisni dorën. Lëreni!...

Gjethet e misrit fërférinin nga era.

— Zanë, si thua, ti, bijë?, — foli buzagaz nëna dhe mori udhën për në shtëpi. Asimi i shkonte pas.

Ata ecnin pa folur. Kulla e bardhë heshtte. Dëgjo-hej vetëm gurgullima e përroit dhe zhurma e gjetheve të thata të gështenjave, që rrëzonte era...

Babai i priste në oborr.

Ai qe ulur në fund të shkallëve të gurta dhe pinte duhan i heshtur. Asimi priu i pari drejt tij. I ati picërroi sytë, po nuk e njoihu, deri sa dëgjoi zërin e të birit:

— Si je, babë?

Ai zgjati dorën e tij të rëndë me kallo, pa lëvizur nga vendi.

Zana donte të futej brenda e të ndizte një dritë, po shkallët i kishte zënë plaku me trupin e tij,

— Të kaloj, pak, o babë? — Plaku bëri mënjanë dhe, tek pa të shoqen, e pyeti:

— E mbaruat misrin, oj grua?

— Edhe pak na mbeti për nesër?

— Çka the?!

— Pak, bre, fare pak na mbeti, se u err dhe nuk shih-nim. Pa pastaj na erdhi edhe djali.

Plaku hoqi çibukun nga goja.

— Im bir në shtëpinë e vet ka ardhur. A mos do të presësh dashin, a? Kur të thashë unë, ti duhej ta mbaroje misrin së korruni, apo mos po çmende në pleqëri, oj grua?

— Zbardh prapë nesër drita e i japim fund, or burrë.

Plaku u ngrit i nervozuar.

— Sonte, — bërtiti, — a dëgjove? Sonte!

Po ndërhyri Asimi dhe sherri u shua.

— Nesër, baba, nesër. Kur këto të shkojnë në punë, dal unë e mbaroj.

Dhe kështu u vendos. Hynë brenda në dhomë.

Për një kohë sundoi heshtja. Babai pinte duhan në qoshe të oxhakut, ndërsa Asimi ndiqte me sy herë Zanën e herë nënën, e cila pregetiste darkën. E kishte shumë të rëndë ta hapte bisedën. Ai e dinte mirë se nënës s'do t'i vinte mirë që ta merrte Zanën në ekspeditë. «A do të mund t'i bind? Do të ma marrin për ters». Mendime të tilla e shqetësonin vazhdimisht.

— Do të na rrish ndonjë çikë?, — pyeti e ëma të birin kur hyri në dhomë me gotat e rakisë në dorë.

— Vetëm tri ditë lejë më dhanë. Jemi në valën e punës. — Asimit iu duk sikur biseda po merrte rrugën e vet, ndaj shpejt nxitoi të thoshte:

— Më nisën për një punë, se ndryshe s'do të më lejonte njeri të viaj.

Ndërkohë Zana po vendoste pjatat mbi tryezë. Asimi shëtiti sytë te të gjithë me radhë dhe vuri re se ata prisin që ai të vazhdonte fjalën.

«Tani erdhi çasti më i vështirë», — mendoi.

— Kam ardhur të marr Zanën, — tha me ngut, pa pasur guxim t'i shihte në sy.

— Si?!, — pyeti babai duke shkundur me forcë çibukun në qoshe të oxhakut.

Atëherë ai ua tregoi çdo gjë gjerë e gjatë. I vinte keq për pleqtë. «Po tani në dimër le të vijnë me ne dhe këta». Ngriti sytë dhe pa të ëmën; po iu duk si tepër e zbetë, ndërsa në faqe i shkëlqente një lot.

— Asim, po ma merr nusen, o bir, a? — pyeti nëna.

Asimi i hodhi dorën në supe dhe e ftoi të ulej pranë tij. Zjarri bubullinte në oxhak. Një dru kërciti, pastaj një shkëndijë zjarri kérceu dhe ra mbi qilim. Babai e ndoqi

me sy ashtu i menduar pastaj lëshoi dorën e rëndë mbi të dhe s'e lëvizi që andej.

— Mua s'më zë shtëpia brenda pa Zanën, o bir, — vazhdoi e ëma, — e ti po e merr. S'të vjen keq pér ne?

Asimi u prek nga këto fjalë, po s'e dha veten.

— Mos e thuaj atë fjalë, nënë!

— Ti, Asim, u zemërove me mua më duket dhe prandaj kërkon ta marrësh nusen, — i lëshoi fjalët si bombe babai.

Asimi ktheu kokën nga qoshja tjetër. Babai thithte fort çibukun dhe herë pas here shfrynte.

— Jo baba... «E dija se do të ndodhte kështu». — Unë pér këtë punë u nisa që andej. Duhet ta marr Zanën, sepse ashtu kemi vendosur. Të gjithë do t'i marrim gratë. Ndërmarrja ka nevojë. Është jona ndërmarrja, apo jo? Ne do të punojmë në lartësi të mëdha këtë dimër... Shumë punë që mund t'i kryejnë gratë, sot i bëjnë burrat, që na duhen pér në mal. Kështu më tha sekretari i partisë. A mund të veçohem unë nga shokët? Unë e dhashë fjalën. Në doni ejani edhe ju, ta kalojmë së bashku dimrin!

Zana rrinte si në gjemba. Qejfi ia donte të shkonte me Asimin po dhe të ndahej nga pleqtë s'i vinte mirë. Kur dëgjoi fjalët e fundit, ajo tha e gjuar:

— Vërtet, baba, hajdeni dhe ju!

— Ha, ha, — qeshi babai me zërin e tij të trashë. Në atë të qeshur ndihej një notë e thellë zemërimi:

— Hajdeni edhe ju, hajdeni edhe ju!, — përsëriti ai. — C'mendje! Po shtëpinë, që sapo e ngritëm? Bukur, besa! Në pranverë, kur të kthehem, ta gjejmë shesh me tokën. Unë çuditem si ua zë goja.

— Jo, o bir, ajo është punë që s'bëhet, — shtoi nëna.

Asimi hyri në dhomën e gjumit. Pas tij si fëshfërimë ere u dëgjuan hapat e lehtë të Zanës. Dhoma ku-

ndërmonte erë mollë e ftonj. Asimi e dintc që Zana i zgjidhte ato fruta, i vinte në arkë dhe i ruante deri në pranverë. Ndërsa ndonjë kokërr ftua e priste me gjithë bisk e gjethje dhe e varte në gozhdë. Ata çdo ditë e më tepër zverdheshin deri sa merrnin ngjyrën e limonit dhe lëshonin erë dehëse. Asimit në fillim iu duk se ajo erë mollësh e ftonjsh do t'ia prishte gjumin po shpejt e harroi atë.

— Vërtet, o Asim, do të ikim?, — pyeti gruaja. I shoqi heshtte.

— Më vjen keq për pleqtë, Asim.

Ai përsëri nuk foli.

— Të paktën sa të kalojë dimri.

— Nuk të marr për dimrin, po për punën, Zana.

— Edhe këtu do të punoj, Asim. Dimrit në kooperativë s'para punojnë. Po ka shtëpia punë plot.

— Asimi e vështroi drejt në bebëza, me kokën pak të anuar.

— Ah, si flet edhe ti!, — tha dhe, si heshti prapë për një çast, vazhdoi:

— Po më çudit me këto fjalë. Ti, Zana, kujton se unë e pata të lehtë deri sa e mora këtë vendim? Ndosh ta të shkon mendja se nuk çaj kokën për prindët por shikoj vetëm veten, punën time dhe ty.

Zana u vrenjt në fytyrë.

— Janë pleq ata, o Asim.

— Ohu! Sikur nuk e di unë! Çfarë u mungon babit e nënës? Ne do t'i ndihmojmë e më vonë do të mundohemi t'ua mbushim mendjen t'i marrim me vete. Mos shih ç'thonë sot! Tani për tanë, që janë dhe të fortë, e kanë të vështirë të largohen prej këndejej, po prit, dimrin tjetër do të vijnë.

— Ç'do të bëj unë atje, Asim?, — pyeti Zana me një ndjenjë gëzimi dhe druatjeje bashkë.

— Shkojmë njëherë, pa kollaj është.

Unë shtatëvjeçaren kam, ti e di.

— Ç'do të thuash me këtë?

— Po ja, me ç'punë mund të merrem? A ma ka kush nevojën vallë?

Asimi qeshi.

— Se çfarë do të bësh konkretisht unë nuk e di, po mund të të them se duhet të punosh atje, ku ka nevojë ndërmarrja jonë.

— Mirë, mor xhan, — ia ktheu Zana.

Ai nisi t'i tregonte i kënaqur për Tellën e Egër. Ajo i kishte hedhur dorën në qafë dhe e dëgjonte me buzë në gaz.

Dhjetori filloi me kohë të keqe. Kishte rënë afro një metër borë në Tellë të Egër, ndërsa poshtë në qytezë më pak. Puna kishte dy javë që kishte nisur dhe çdo gjë shkonte mirë, po kjo s'jepte siguri për të ardhmen. Brigadier Nuriu e kishte ngritur krevatin te sonda. Ushqimin ia sillnin me gavetë. Kështu vazhdoi një javë, deri sa një ditë e shoqja shkoi e merakosur te sekretari i partisë, Pjetër Ahmeti. «Nuriu është shëndoshë e mirë si kokrra e mollës, hiç mos u bëj merak. Qëndroi në Tellë t'i vinte punët në rregull. Nesër besoj se do të kthehet». — Kaq i tha Pjetër Ahmeti dhe Zadja u qetësua. Si iku ajo, Pejtri lajmëroi Nuriun që të zbriste në qytetëzë.

— More Nuri, po humbe fare, o i uruar! E pësove si ajo nusja. E ke dëgjuar historinë e saj? Kur i thoshin afrohu pranë zjarrit të ngrohesh, futej në oxhak, kështu dhe ti mbete në Tellë.

— Nuk e di, për nder, ndoshta jam bërë si nusja, po puna të rrëmben.

— Ti në fillim e shikoje me druajtje Tellën e Egër,

ndërsa tani mbetet atje. I harrove të tërë shokët, gruan, fëmijët!, — përfundoi ai buzagaz.

Nuriu ndezi një cigare.

— Unë akoma druhem nga Tella e Egër, shoku Pjetër.

— Më kupto drejt ku e kam fjalën, Nuri! Kemi folur edhe më parë, edhe atje pranë sondës. Të jesh i kujdes-shëm është gjë e mirë, por ama jo ta bësh çdo punë vetë! Ki më shumë besim te punëtorët! A më kupton, apo jo?

— Po, të kuptoj... — Nuriu qeshi me vete.

— Pse qesh, Nuri?

— M'u kujtua një gjë. Më duket vetja si më plaku i brigadës.

— Si më plaku!?

Tjetri pohoi me kokë.

— Unë kam mësuar shumë ngajeta. Edhe tani mendoj se shumë kam mësuar ato ditë, kur punonim në Tellën e Egër. Më parë i shikoja me dyshim disa nga punëtorët sidomos «kreshnikët». Nuk kisha besim tek ata, më shqetësonte kënga e tyre kohë e pa kohë, ndërsa tani kam tjetër mendim.

Pjetri thithi fort cigaren dhe, duke vështruar malet e zhytura në mjegullën e bardhë, vazhdoi:

— Dëgjo, Nuri! Ne duhet t'i shohim njerëzit ashtu siç janë. Me të mirat dhe të metat e tyre. Në qoftë se humbasim besimin tek ata, atëherë, në radhë të parë, kemi humbur aftësitë si drejtues. Ata do të kërkojnë lejë. Kanë nevoja, halle. Duhen dëgjuar, Nuri, duhen ndihmuar sa herë që është e mundur. Ne i kemi njerëzit të mrekullueshmë. Me ata do të fitojmë çdo betejë.

Si i dhanë fund bisedës, Nuri u ftoi Pjetrin të shkonin atë natë në shtëpinë e tij. Rrugës Pjetri e pyeti Nuriun:

— Nusen do ta fusim në punë, Nuri, si thua? Duhet të japim shembullin që në fillim.

— Jam plotësisht dakord, shoku Pjetër.

Ata ishin futur aq thellë në bisedë sa u çuditën kur arritën në shtëpi.

— Haje të futemi, Pjetër!, — tha Nuriu dhe Pjetri pasi pa orën, në fillim kundërshtoi, pastaj ktheu rrugën. Vajza e vogël e Nuriut e gëzuar, me krahë hapur, i priti te dera. Zadja, kur pa të shoqin, tha duke buzëqeshur:

— Po ç'u bëre, more burrë? Na harrove fare!

Hynë në kuzhinë. Një zjarr bubulak kërciste në sobë.

Zadja vuri gotat e rakisë mbi tryezë dhe, si mori një-rrën prej tyre, e takoi me Pjetër Ahmetin. Pastaj iu drejtua Nuriut si me shaka:

— Mirë se erdhe edhe ti, o burrë!

— Zade, a ke qejf të hysh në punë?, — e hapi bisedën Pjetër Ahmeti. Zadja me vështrimin mbi të shoqin, u mendua një çast pastaj pohoi me kokë.

— Biseduam rrugës të dy me Nuriun, edhe ky kështu si ti mendon.

— Po ç'punë mund të bëj unë? S'kam punuar kurrë. Edhe shkollë s'kam shumë, — filloj me drojtje Zadja.

— Pse, sa klasë shkollë ke?

— Vetëm një të mesme.

— Një të mesme?! Pse e ke ndërprerë?

— Është një histori e vjetër. — Ajo pa nga Nuriu dhe heshti.

— Tregoje!, — ia priti i shoqi. Pse hesht? — Dhe, pa e zgjatur, nisi vetë të tregonte:

— Ne kemi qenë të fejuar qysh në djep. Kur u rritëm, Zades i doli bursa për mësuesë, ndërsa unë nuk kisha bërë kërkesë. Babai, me të mësuar lajmin, i hipi kalit në shpinë dhe me cigaren ndezur e mbajti fryshtë në derë të krushkut.

— Ku ma ke çue nusen, more mik?, — e kishte pyetur tē atin e Zades.

— Në shkollë ta çova, — i ishtc përgjigjur tjetri.

— Po mue s'më pyete fare, a?

— Jo.

— Keq, pra! Unë kam kujtue se ajo do tē bahet nusja e djalit tim, por...

Më në fund tē dy pleqtë patën vendosur që Zadja tē largohej menjëherë nga shkolla. Por kësaj nuk ia kishin arritur dot, prandaj kishin pritur deri sa ajo u kthyte pér pushimet e verës. Kështu që, s'e lanë tē vazhdonte më tej.

— Po, sidoqoftë, një vit shkollë tē mesme Zadja e fitoi. Pra edhe me aq shkollë ka mundësi tē bëjë shumë punë këtu, pér shembull në llogari apo në dyqan. Mendoni dhe na thoni!, — foli Pjetër Ahmeti. — Ti, Nuri, i di nevojat tonë. Po nuk siguruam prapavijat, — theksoi ai buzagaz, — fronti në Tellën e Egër nuk mund tē jetë i pathyeshëm, apo jo? Tani më falni, po ngrihem dhe ju falem nderit pér mikpritjen! E po natën e mirë de! Ti, vogëlushe, përqafioje xhaxhin! Dhe, më jep fjalën se do tē vish ndonjë ditë edhe te shtëpia e xhaxhit. Kam edhe unë një vajzë tē vogël. Mirupafshim nesër në Tellë tē Egër, Nuri! Do tē vij atje tok me inxhinierin.

Pjetri doli.

Nga dera e hapur vrapiuan flokët e lehtë tē borës, që i shtynte brenda era e marrë.

— Shpirt njeriu është ky sekretari ynë, — tha Nuriu.

Zadja pa nga i shoqi dhe nuk foli.

Nuriu mori vajzën dhe, si u ul në minder, filloj tē luante me tē.

— Hajde edhe ti, moj grua, e më thuaj njëherë si ke qenë këto ditë! E keqja është se po qaheni ju që rrini zjarrit e jo ne tē Tellës së Egër.

— Ç'do të thuash me këtë, Nuri. Unë nuk bëra ndonjë gjë. Sekretarit të partisë ia thashë.

— Cfarë i the, moj grua?

— I thashë se burrin tim e keni dërguar me shërbim, apo ka humbur në mjegull?

— Ama, qenke ankuar vërtet ti, a? Ha, ha, ha! Po mua as që më tha gjë Pjetri për këtë. Oh, ç'paskam qëlluar në shenjë! Vërtet paske pasur ankesa!...?

— Ti mos u bëj kështu, Nuri!... Edhe ne bëhem i merak.

— Nuriu i zgjati dorën...

Përjashta binte borë.

Nadoja po rrinte me duar të mbështetura në një tryezë, ku zakonisht prisnin bukën. Tre punëtorë s'kishin ngrënë darkë ende. Ajo vështronë nëpër kornizën e saj mensën e zbrazët. Nadoja priste të ktheheshin punëtorët që t'i jepte fund ditës së punës. Ajo e mbyllte kuzhinën pasi hanin të gjithë. Ajo kishte hapur derën e kuzhinës. Përpiquej mos i zinte veshi ndonjë zhurmë. Rreth e rrötull ishte qetësi. Punëtorët ende s'po dukeshin. Përse po vonoheshin, vallë!? Ç'do t'u kishte ndodhur!? Mbylli derën dhe i futi dru sobës. Atë çast u dëgjua një krismë në derë. Në fillim Nadoja u step. Kjo ishte një gjë e rrallë. Zakonisht, kur vinte ndonjëri, futej në mensë e i fliste nga sporteli, ndërsa nga kjo derë vetëm dy shoqet e saj e thërrisinin.

«Kush të jetë?!». Në fillim mendoi se mos qe Zadja. Po ndërrroi mendje.

— Kush është?, — pyeti.

Priti një çast, po përgjigje s'mori.

— Hape, Nado!, — foli zëri përtej derës. — Jam Sokoli.

— Ti je? Na ngrive gjakun, more Sokol!

Sokoli qeshi. Fytyra e tij ishte bërë e kuqe nga të ftohtët.

Atij i shkëlqenin faqet prej kokërrizave të borës që kishin zënë të shkriheshin pak nga pak.

— Po ç'do këndej, more Sokol? Dil, ore nga dalin të gjithë! U mësove keq ti!, — vazhdoi ajo kur iu kujtua se edhe para disa ditësh ai po këtej i kishte folur.

— Nado, unë erdha të bisedoj me ty.

— Ç'të bisedosh me mua, o Sokol? Ec, ore, nga sporteli, po të them, se më plevitose me derën hapur!

— Unë sportelin e di, moj Nado, po... sonte kam ardhur për ty.

Ajo shtyu derën me dorën e majtë dhe u bë gati ta mbyllte, po Sokoli e mbajti.

— Nado, pse sillesh kaq ashpër me mua? Ti e di, Nado...

— Shko, Sokol, se unë do të mbyll derën. Nuk është mirë të të shohë njeri këtu. Shko tani. Natën e mirë.

Sokoli s'po dinte ç'të thoshte. Vështrimi i egër i syve të Nados e bëri të hutohej.

— Dëgjo, Nado. Të dua, Nado, — vetëm kaq arriti të thoshte sepse Nadoja e skuqur në fytyrë mbylli derën.

Sokoli, kur pa derën që u mbyll, e ndjeu veten të fyter. Qëndroi pak dhe iku i mërzitur.

Nadoja priti dhe për një kohë të gjatë. Tre punëtorët ende nuk ishin kthyer nga puna. Ajo i priste që të hanin darkë. Atëherë mbylli derën e kuzhinës dhe vrapiqi për te barraka e punëtorëve. Sapo shkeli pragun mbeti si e gozhduar në vend nga habia. «Ua, këtu s'paska njëri! Po Sokoli? Nga të jetë ai, që e ka lënë bujtinën vetëm? Diçka do të ketë ndodhur përderisa në bujtinë...», — tha dhe thirri.

— Sokol, o Sokoll!, — zëri i saj shpërtheu si jehonë. Sokoli doli nga errësira dhe i trembur e pyeti:

— Ç'ke, Nado?

— Sokol! Ku i ke shokët? A mos iu ka ndodhur gjë?

— Kujt?

— Sadikut me shokë. Ku janë të tjerët? Vetëm ata të tre s'kanë ngrënë darkë. Po të tjerët ku janë, Sokol?

— Çudi që t'i paska mbyllur bora veshët ty, Nado. Nuk dëgjove ti, a? Sot gjithë ditën kanë gjëmuar thirrjet: «Aksion, aksion, aksion».

— Aksion!?

— Një pjesë kanë vajtur në ndihmë të kooperativisteve, sepse stallat e bagëtive po shembeshin nga bora, Nado, prandaj shikoje edhe ti kuzhinën se mos të shembet!, — e ngau Sokoli. — Ndërsa Sadiku me Xajën dhe Rexhën janë te sonda e tretë.

Ajo mbylli sytë për t'i shpëtuar vështrimit të tij, po nuk harroi t'i thoshte:

— Kuzhinën ma ruajnë të tjerët...

— Ma ruanin, thuaj, — korrigjoi Sokoli, që e mori vesh ngasjen, ndërsa Nadoja, e bërë all në fytyrë, vrapi drejt kuzhinës si një zog i ndjekur nga stuhia e dimrit që gabimisht futej nga dritarja e hapur e dhomës.

— Nado! Nado!, — jehoi zëri i Sokolit. Veriu i ftohtë që ulërinte iu përplas në gjoks. Në dritaren e kuzhinës dukej silueta e Nados. «Ah, Nado, Nado!», — pëshpëriti ai duke u rikthyer në strofkën e vet.

Pas pak u dëgjua një zë në oborr:

— Rojë, o rojë, roojë!

— E ka zënë gjumi, more, e zëntë egjra rojën gjumëmadh!

— O rojë!

Ishin dy «kreshnikët», Xaja me Rexhën. Ata kërkonin, thërrisin, po Sokoli nuk përgjigjej, ndonëse i dëgjonte për bukuri.

— Ja ku qenka! Uh! Pulë e lagur qenka! Ha, ha, haa!

Sokoli i vështronte i mërzitur.

Ata iu hodhën përsipër të dy njëherësh, sa krevati kërciti e Sokoli thirri: «Oh, më mbytët, o ujq. Ikni, ore!». Rexha mori paqetën nga xhepi e i tha Xajës: «Merr nga këto me «barot» të thatë.» Ata i morën paqetat e tyre të lagura e i vendosën pranë sobës së ndezur që të thaheshin. Shokët ishin në mensë kur Xaja e pyeste:

— Ç'ke që je i mërzitur, more buf? Ty kot ta kanë vënë emrin Sokol...

— Do të më lësh rehat, Xaje? Sa i bezdiss'hëm je! Ti më mirë na trego se ç'bëtë. Sadiku me shokë, a u kthyen??

Sokoli tundi kokën. Rexha priste të vazhdonte bisedën, por Xaja e pengonte, prandaj e qëlloi me shaka në nofull, në bark e në gjoks, deri sa ai u ngrit nga krevati dhe vrapi me shokët.

— Kapeni, kapeni!, — thërriste Sokoli. Po të tjerët iu përgjigjën me të qeshura:

— Rojë, ku e ke pushkën, rojë?

Roja nuk lëvizi. Sokoli s'i ndahej Xajes dhe, kur e pa se u largua aq sa s'e arrinte dot, u përkul, mbushi grushtat me borë, e ngjeshi me forcë dhe e qëlloi me sa fuqi pati. Në errësirë u dëgjuva «tup» krisma e pelëces së Xajes. E kishte qëlluar në shpinë. Xaja këtë priste. Ndaloj dhe të dy filluan të qëllonin me borë njëri-tjetrin. Pas pak erdhë Rexha duke thirrur:

— Hej, ndahuni, ndahuni!, — dhe qëllonte herë Xajen e herë Sokolin. Pastaj u lodhën dhe u tërhoqën pa kushte në drejtëm të fjetores. Bora u kishte lagur flokët dhe duart, fytyra u qe skuqur.

— Hiqni qeleshet përjashta», — thirrën shokët, kur ata filluan të shkundeshin brenda në dhomë. Sokoli e Xaja s'i ndanin sytë Rexhës dhe vetëm kur ai hoqi pe-

liçen, u bindën se ndeshja kishte marrë fund. «Paqe kreshnikësh», — tha Xaja dhe vazhdoi të zhvishej. Ora kishte kaluar dy pas mesit të natës.

Përjashta ishte errësirë. Era ulërinte kudo dhe ngrinte borën e bardhë si pluhur dhe e shtynte drejt luginave, honeve, gropave të malit. Si çdo natë, nën strehë afër derës, një dërrasë që e lëvizte era lëshonte krisma të çejrra. Dritaret dukeshin të vogla dhe dritat të zbeta, të largëta. Të paktën ashtu iu dukën Asimit gjatë gjithë rrugës, që nga faqja e malit ku ishte sonda e deri sa arriti në shtëpi. Si rrallëherë ai po kthehej nga turni vetëm. Atë natë, pasi la turnin, u mor një cop herë me sondistët e rind që, ndonëse ishin shumë të kujdeshëm, punonin me një farë druajtje.

Hodhi sërisht vështrimin nga qyteza e bardhë dhe iu kujtua Zana. Ç'vështrim të ëmbël kishte ajo! Si i qeshnin sytë, kur e shihte në prag të derës! Kujtonte fjalët e plakut që e kishte porositur: «Gruan mbaje në shtëpi! Në mos qofsh në gjendje ta mbash me bukë, lëre këtu! More vesh?». Ai s'çuditej me fjalët e të atit, sepse s'kish-te qenë dakord që ajo të punonte as në arë. Tani që kush-edi si e përfytyronte qytezën, kishte nisur të njëjtin avaz. Po Asimi çuditej me Zanën, nusen e tij të re, edhe pse ajo s'pranonte të hynte në punë për të mos kundërshtuar të vjehrrin. Zana qe mësuar të punonte vetëm në arë dhe kundërshtonte me një logjikë krejt fëmijnore, aq sa e nervozonte pa inasë Asimin. «Më ka vënë në pozitë edhe me shokët. Nejse, do të shkoj të bisedoj me Pjetrin. Ai mund të më ndihmojë». Këto plane po bënte me mend Asimi, kur diçka lëvizi fare pranë tij. Diçka e zezë. Ai stepi në vend e duke shqyer sytë u mundua të dallonte se ç'gjë ishte ajo që kishte lëvizur, ujk, ari, apo çfarë

tjetër. Duke shtrënguar fort në dorë shkopin, që e kishte marrë pér t'u mbajtur, priti disa minuta, po s'pa gjë. Pér një çast mendoi se mund t'i kishin bërë sytë. Nata ishte e errët. Rrugët — me borë. Syri, kur s'je i përqëndruar, të génjen lehtë. Ai u vu përsëri në rrugë, në fillim ngadalë, pastaj me hapa të shpejtë. Kur ja, përsëri lëvizi një njollë e zezë. Asimi ngriti drurin lart mbi kokë duke e mbajtur me të dyja duart dhe qëlloi me aq forcë saqë i shkanë çizmet e ai u rrëzua mbi borë. U ngrit në këmbë rrëm-bimthi. Dalloi prapë lëvizje të ngathëta. Asimi u bind se ajo kafshë ia kishte frikën. «Të jetë lepur? — mendoi. — Po ç'do lepuri këtu në dëborë?!». Duke menduar kështu, nxitoi përsëri hapat. Njolla e zezë u largua në drejtim të shkëmbit. Asimi nxitoi prapë hapat. Uli shkopin dhe u mundua të dallonte ndonjë lëvizje, po kur s'mundi të shquante asgjë, tha me vete: «Më iku! Sa keq!». Para këmbëve të tij qe krijuar një gropë e bardhë. Ai u përkul, zgjati duart dhe filloi të kontrollonte, duke ecur ngadalë, deri sa dora i takoi në diçka të ftohtë akull, që lëvizi sa e preku. Dora e tij e shtrëngoi atë me forcë, pastaj e kapi në grykë, sikur donte t'i zinte frymën me ato duar të fuqishme. Kafsha filloi të lëvizte, kur ai e peshoi dhe bashkë me të u zhyt thellë në borë. Dora e tij e djathtë përmblodhi në grusht qafën e hollë e të leshtë të kafshës. Pastaj Asimi u ngrit në këmbë duke belbzuar: «Drenushë. Drenushë e vogël qenka!». E mori atë duarsh dhe e mbështeti pas trupit, sikur të donte ta ngrohte në gji drenushën e vogël me këmbë të gjata. Në çdo hap që bënte dëgjonte rrahjet e zemrës dhe të dridhurat e trupit të drenushës.

Kur ngriti dorën t'i përkëdhelte kokën, drenusha lëvizi me fuqi e desh i shpëtoi nga dora.

«Ma paske kokën shytë, moj drenushë, që më zure rrugën në këtë natë të ftohtë! Tani ne të dy mbërdhijmë,

po kur tē vemi nē shtëpi Zana... Një drenushë shytë... Zana... Ajo le tē kujdeset pér ty! Ajo po rri kot nē shtëpi. Sa tē mbërrij do ta porosis që tē tē rrisë ty. E kur tē tē bëhesh sa një dhi e butë, unë do tē tē vë një zile nē qafë e do tē tē lëshoj oborrit tē shëtisësh, tē kullosësh nē gomuret e oborrit, pa pastaj do tē tē sjell edhe bar e gjethë nga Tella e Egër...».

Me t'iu afruar shtëpisë, thirri fort e Zana i hapi derën gjithë gjem. E vështroi nē fytyrë buzagaz dhe, kur vuri re se i shoqi i mbante duart pas shpine, priti që ai t'i tregonte vetë çfarë i kishte sjellë.

Asimi bëri tē futej brenda, Zana lëshoi një «uf!».

— C'më trembe. C'e ke atë kec nē dorë, more Asim?!  
Asimit s'i erdhi mirë.

— Nuk është kec, po drenushë mali, moj nusja ime. S'e njohe?!

— Po unë s'jam rritur me drenusha, mor burrë.

Asimi qeshi.

— Tani do ta rrisësh, — tha ai duke e lëshuar nē dysheme drenushën që dridhej nga frika e shtyhej pas këmbëve tē Asimit. Sytë e egërsuar tē drenushës dukeshin si tē kristaltë.

Drenusha nē fillim s'lëvizi, po pastaj hyri poshtë minderit duke kërcitur thundrat e saj tē mprehta mbi dërrasat e dyshemesë. Ata e mbyllën derën me kujdes dhe e rrethuan sobën me ca drunj, nga frika se mos u digjej drenusha e tyre, që atë natë s'pranoi tē vinte asgjë nē gjë.

Si hëngri darkë, Asimi u ul nē minder dhe nisi tē shfletonte gazeten. Pas ca ia mbërtheu sytë një fotografie nē faqe tē parë. Ishin ata, sondistët e Tellës së Egër. Atij iu kujtuan dëbora e madhe, lodhja, vështirësitet, pastaj edhe çasti kur kishte ardhur ai gazetari. Dhe ja, artikulli i tij! Fotografia! (vështroi gjatë atë fotografi, dhe

nisi të lexonte atë reportazh, ku shkruheshin emrat e shokëve, emri i vet, ngjarjet nga jeta në Tellë.

Kur mbaroi së lexuari, hodhi vështrimin mbi Zanën, që lante pjatat, pastaj kërceu nga minderi, u përkul nën të dhe zuri të ndillte drenushën: «Keçe - keçe, keçe - keçe!».

Ndonëse rrodhën ditë e u bënë plot dy muaj, qysh se Zana ishte njohur me qytezën e gjeologëve, prapëseprapë vazhdonte të rrinte mbyllur në shtëpi. Në fillim Asimi ngulte këmbë që ajo të hynte në punë. Për këtë ata ishin grindur disa herë me Zanën. Ajo e nevrikoste me qëndrimin e saj. Kohët e fundit Asimit s'i binte më në mend të fliste me Zanën për çështjen e punës. Të dukej sikur ishte lodhur me rrahjen e kësaj çështjeje, ose sikur qe pajtuar me gjendjen. Po edhe Zana s'ndihej. Ajo merrej me drenushën, e cila tashmë kishte hyrë në jetën e tyre dhe i kishte rrëmbyer me ato kërcime të bukura që bënte, si edhe me sytë pérherë të lëngshëm e me bebëzat të zma-dhuara. Qimja e saj e shkurtër ngjyrë kafe e çelët shkëlqente dhe Asimi kënaqej, tek ia lëmonte. Drenusha druhej nga ato prekje, ndaj kur e lëshonin, kërcente prapë, duke pérplasur këmbët e holla e të gjata me thundra të vogla e tepër të zeza.

Ditët vazhdonin të rridhnin ashtu të bardha e të ftohta dhe Asimi me Zanën kishin gjetur qetësinë e më-parshme. Ata nuk grindeshin më. Por ja që papritur në këndin e kuq të qytezës bëri bujë një fletrrufe.

Ajo i drejtohej Asimit nga shokët e brigadës së vet, sepse ai ishte i vetmi në mes punëtorëve, që e kishte mbyllur të shoqen në shtëpi. Ata çuditeshin me të sepse ai kishte qenë ndër të parët që kishte ndier nevojën e punës së gruas në ndihmë të Tellës së Egër. E pra tani ç'kishte

që s'ndihej?! Edhe kur e pyesnin, ai për çudi kishte gati përgjigjen:

— S'do Zana, është e pamundur t'i kthehet mendja. E ka marrë me frikë.

As Pjetër Ahmeti nuk kishte nxjerrë gjë në shesh.

«Përgjigju!, — i tha vetes në heshtje Asimi. — Po bë-  
he gazi i botës!».

— Përgjigju!, — i tha edhe Zanës, sapo hyri në shtë-  
pi atë mbrëmje.

Zana e pa e nuk foli. Ajo u çudit nga mënyra se si  
iu drejtua i shoqi.

Drenusha kërcente në fund të dhomës. Asimi e pa dhe  
buzëqeshi. E mori në dorë dhe duke i përkëdhelur sutat,  
veshët, qafën, foli përsëri:

— Përgjigjiu pra, o grua! Përgjigju me shkrim fletë-  
rrufesë!

Zana, që e dëgjonte për herë të parë fjalën «fletërru-  
fe,» si heshti pak, tha:

— S'të marr vesh se ç'thua, or burrë!

Asimi ngriti sytë i çuditur. Pastaj ia bëri të qartë  
gjithçka.

Ata të krahasojnë ty me ato gratë e motit që rrin  
mbyllur brenda katër mureve. Dhe hak kanë. Po edhe unë  
s'kam qenë e s'jam në rregull.

Kam menduar se na mjafton rroga ime dhe aq. Zanës  
i ra një valë e nxehtë në fytyrë dhe u skuq.

— Po unë kam frikë mos të turpëroj, Asim, se jam  
rritur në fshat. Asgjë s'më pengon tjetër.

Si tha kështu, Zana u kapërdi, se e ndjeu grykën të  
tharë. — Po qe se... që nesër e filloj punën. — Lotët i  
vijëzuan faqeve. Sedra e nënës së re qe prekur rëndë kësaj  
here.

— U bëra të më tregojnë me gisht, — foli pas pak dhe  
nuk e përbajti dot ngashërimin.

Asimi s'po u besonte veshëve. Ai u ngrit në këmbë, hapi derën dhe i tha drenushës:

— Lamtumirë, drenusha ime e vogël! Mundohu të gjesh rrugën që të çon në strofkën tënde.

Zana kërceu e trembur dhe e kapi drenushën me të dyja duart.

— Po kjo ç'është? Më duket se ne po bëjmë si...

— Si kush?

Ajo nuk foli por qeshi përmes lotëve duke zbuluar ata dhëmbët e saj të bardhë si bora e malit.

— S'na ka faj drenusha, Asim. Le të rrijë me ne! Tani shko e i thuaj shokut Pjetër se unë jam gati të filloj punë që nesër.

Pas pak dhoma ra në qetësi. Ndihej vetëm soba që bu-bullonte dhe drenusha e vogël, që endej poshtë e lart në-për dysheme, duke lëshuar krisma të thata.

Sokoli vështroi anash dhe si u bind se nuk po e vinte re njeri, trokiti lehtë në derën e kuzhinës. Shpejt u duk një dorë që hapi dritare, nga pas perdes së bardhë. Pastaj ra në sy trupi i bëshëm i Nados. Sokolit i qe bërë mendja top të fliste edhe një herë me Nadon, po as kësaj here s'i kishte ndezur. Tek largohej, Nadoja e ndiqte me sy. Ai do ta priste te qoshja e barrakës, në mes të natës.

Harku i dritave në sheshin e heshtur të qytezës iu duk atij i trishtuar. Pritja po e torturonte. Zhurma e motorëve, që ngjante me zhurmën e makinës kur i ngjitet një mali të lartë e plot kthesa të forta, herë-herë vinte e fortë dhe herë-herë nuk dëgjohej thuajse fare. Era ose i merrte e i afronte ato zhurma, ose humbiste në hapësirë.

Nadoja doli me hap të lehtë dhe nisi të vravonte, që të mos ndiente të ftohtë. Kaloi pa e vënë re Sokolin, që priste në strehën e barrakës. Por ai e ndoqi pas deri sa e

arriti. Nadoja në fillim u tremb, po, si e dalloj se kush ishte, vazhdoi të ecte duke vështruar borën. Sokoli e zuri nga dora dhe s'e la të vazhdonte më tej:

— Dëgjo, Nado, unë të flas ndershëmërisht! Po ti pse s'pranon? Në ke ndonjë arsy, ma thuaj! Ta di edhe unë, dreqi e mori! Nga goja e saj s'po dilte asnë fjalë. Ajo po ndiente frikë. Po sikur të ndeshnin me Sadikun? Si do t'i vinte halli asaj pune?

Degët e ahut tundeshin nga era dhe që andej mu pranë këmbëve të tyre rrëzoheshin copëra të ngrira dëbore. Ajo e kishte prishur fejesën në fshat e para dhe kishte hyrë në punë. Së bashku me disa shoqe, kishte vendosur të martohej me atë që do të donte vetë. Po, kurrë, ama, s'e kishte menduar që një natë do t'i ndodhë të rrinte kështu e të bisedonte me një djalë nën strehën e errët të barra-kës. Kjo ishte «marre».

Iku e trembur me vrap. Afër fjetores, fare papritur, Sokoli kishte parë një njeri që i kishte zënë rrugën, e kishte kapur për dore dhe e kishte tërhequr me forcë. Nadoja nuk kishte bërtitur fare. «E rrëmbyen. Ndoshta njerëzit e burrit të parë, — tha ai me vete. — Mbase edhe vetë ish-i fejuari.» Ndërkohë dëgjoi: «Ku ishe?». A, a. Ishte zëri i Sadikut, që vazhdonte ta tërhoiqte të motrën duke e pyetur. Nadoja heshtte. Sokolit nuk iu durua. Shkoi pranë tyre dhe foli me guxim.

Sadiku ia lëshoi dorën Nados, bëri një hap përpëra dhe pyeti i çuditur:

— Si??

Sokoli u përtyp një çast, ngaqë s'po gjente fjalët e përshtatshme, tek pa se zemërimi i tjetrit kishte marrë udhësi përrenjtë malorë. Po shpejt e mblođhi veten dhe tha:

— Sadik, unë e shoh që ti je nxehur, po...

— Të këshilloj të largohesh, përpëra se...

— Të merremi vesh, Sadik!

Sadiku, sikur ta shponte diçka në gjoks, iu afrua me grushtat shtrënguar.

— Ti nuk je shoku im...

Sokoli u mundua t'i shpjegonte gjithçka ashtu siç kishte ndodhur po nuk mundi. Po vinin shokët. Zërat e tyre ndiheshin qartë. Sadiku s'deshi të përleshej me Sokolin në sy të tyre. Kërciti dhëmbët dhe bëri të ikte.

Do të fillonte punën në turnin e tretë.

«O Sokol, o Sokol! Ku je, o ftujak i krimbur?», — dëgjoi dikë që thirri.

— Ejani, se jemi vonë!, — u tha Xaja Sokolit dhe Sadikut.

Nadoja qe futur midis barrakave dhe ecte me hap të shpejtë nëpër rrugicën e bardhë.

Rexha e kapi Sadikun nga krahu, po ai e tërhoqi i zemëruar.

Sokoli çapitej pas tyre. Ecën një copë rrugë ashtu pa folur. Në krye printe Rexha. Sadiku, kryesondisti i turnit, pinte duhan dhe herë-herë kollitej.

— Mos je ftohur gjë, o Sadik, apo e ke nga duhani?

— Jo, — u përgjigj tjetri shkurt.

— Sonte më duket moti si i hallakatur, — tha Xaja.

— Rrëzohen ortiqe. Mjegulla është varur.

Iu ngjitën në heshtje kodrës vezake me drurë të rraillë e të gjatë. Pak më poshtë, në këmbët e malit, ishin krojet. Sokoli, sa herë kalonte andej, fuste duart në ujë dhe kujtonte atë ditë vere, kur kishte ardhur si punëtor i ri. Atje për herë të parë kishte pikasur nga larg Nadon tek mbushte ujë. Kishte qenë fundi i muajit korrik, e me-gjithatë rreth e rrotull bari ishte krejt i njomë e lulet krejt të freskëta si në pranverë.

Sokoli e kishte ndjekur me sy Nadon deri sa ajo qe fshehur në grumbullin e ndërtesave. Pastaj ai, si pa kup-

tuar ia kishte marrë këngës shtruar, e zëri i tij atë ditë  
kishte pasur vërtet një tingëllim të ëmbël:

*Kur po i ngjitesh malit përpjetë,  
Mori lule, që rrithesh n'bjeshkë...»*

Këto po i kujtoheshin Sokolit, tek ecte në fund të kolonës, ndaj edhe as që i kishte dëgjuar bisedat e shokëve që prinin para tij.

— Po eja, more Sokol, — i folën shokët, tek fillonte rrëpira dhe tek rruga vështirësohej ende.

Ecën gjatë në heshtje. Pastaj dikush thirri:

— O Sadik! O heeehee!

— Ndaluan.

— Na thërrasin nga Qafa e Malit.

— Qenkemi afruar, o trima!

— Hajt të përgjigjemi njëherësh!

Ndaluan për të dytën herë dhe në çast nga gjokset e tyre të gufuara jehoi e fuqishme ajo thirrje, që u përzie me ulërimat e veriut:

— O ku jeni, moore? E heehee!

Kur arritën në Tellë të Egër, panë brigadier Nuriun tek bisedonte me Pjetër Ahmetin dhe inxhinier Qemalin. Nuriut i shkëlqenin sytë. Ai dukej i lumtur atë natë të ftohtë dhjetori.

— Sokolat tanë, — tha buzagaz Pjetri, kur qenë afruar punëtorët.

Inxhinier Qemali mbante në dorë një gur poroz. Deshi të thoshte diçka, po fjala i ngeci në grykë e sytë i shkëlqyen nga një gëzim i rrallë.

Ata u mblodhën njëri pas tjetrit duke u përshëndetur. Ajo natë kishte gjallëri të jashtëzakonshme.

Kur nxorën shtangat panë në duart e tyre atë që kër-

konin prej kohe, rubinin e kuq. Inxhinier Qemali e mori në dorë, i buzëqeshi dhe e ledhatoi si të kishte në duar një fëmijë të vogël e të bukur. Pastaj u hodhi një vështrim shokëve që e rrëthonin. Shpejt ajo copë minerali kaloi dorë me dorë, duke rrëmbyer buzëqeshjen e të tërëve. Gëzimi, kënga dhe minerali i kuq hynë atë natë në jetën e gjeologëve si një fllad i ëmbël, si refreni i një këngë gazzmore. Ishte fundi i katërmujorit. Pas një mijë e tetëqind e dyzet e tre metrave shpim në pika të ndryshme, kishin arritur të zbulonin mineralin. Tella e Egër jehoi nga këngët dhe thirrjet e gjenguara. Gjeologët u gjallëruan e nisën të haheshin në udhë, në turn, në bisedat për emrin e qytetës së tyre. Disa mendonin ta quanin «Qyteza e Bardhë» sepse e bardhë ishte bora që vishtë malet për muaj të tërë. Po ama vinte vera dhe ajo shkrihej, ndërsa rubini i kuq qëndronte i fortë në zemër të tokës. Atë natë zunë fill bisedimet e gjata për të ardhmen e Tellës së Egër, për pasuritë e mëdha të mineralit, për teleferikët që do të vraponin nga mali në mal, për galeritë e reja, brigadat e reja, banorët që do të vinin aty për të punuar.

Thonë se zërat e përzier me zhurmën e tufanit të dëborës i kishte dëgjuar asaj nate në «Qytezën e Bardhë» edhe një njeri që priste agimin e ditës së re me sy të pafjetur e zemër të ngrirë.

E kjo ishte Nadoja.

Ajo qe e para që u hodh si e trembur nga shtrati dhe vrapi i për në punë. Dukej e zbetë dhe e vrarë në fytyrë, sa shumë shokë dhe shoqe e pyetën se ç'kishte, por ajo, si e zënë në faj, përgjigjej pa i ngritur sytë. Kur pa nga larg Sadikun që po kthehej nga turni, sa nuk ngriu në vend. Ashtu me vështrim të ngulur në atë kolonë që afrohej përmes dëborës, mundi të dallonte Pjetër Ahmetin, inxhinier Qemalin, Sokolin. Ja, Nuriu u nda nga shokët. Zadja buzëqeshi.

— Shkon tē shohë vajzën..., — tha ajo dhe e la fjalën përgjysmë. Iu afrua Nados.

— Se ç'ke sot ti, Nado.

Shoqja heshtte. Sytë e saj tē mbërthyer mbi turmën që po afrohej dukeshin si tē frikësuar. Zadja, kur pa që Nadoja s'po i përgjigjej, filloi tē bënte gati mëngjesin e atyre që po ktheheshin nga turni i natës.

I pari u fut Pjetër Ahmeti. Ai ishte tepër i gjëzuar e sa shkeli pragun e portës thirri me entuziazëm me atë zërin e tij prej babloku:

— Oj Nadire, po dil këtej nga ne njëherë, se mjafth ke qëndruar atje përtej mbyllur në kafaz!

Nadoja u tmerrua fare: «Qyqja, edhe sekretari i partisë e paska marrë vesh. Gazi i botës u bana. Më thërrret. Atje tē shkoj? Atje në sy tē vëllait, në sy tē tē gjithëve?».

— Shko, moj Nado! Po tē presin, — e nxiti Zadja.

Mensa u mbush plot me zëra. Nadoja i hetonte zërat qartë; gjëzimi i tyre e çudiste dhe e frikësonte.

— Eja, moj Nado, ç'u bëre, moj Nado?!, — pyeti inxhinieri.

— Hajde, Nado, hajde, le tē na shërbejë Zadja sot!

— Po qe nevoja, jam gati tē përvishem unë!, — tha Nuriu, që sapo qe kthyer nga shtëpia, ku kishte shkuar për pak kohë. — Le tē më quajnë ndihmës tē parë tē mensës, — tha së fundi. Të gjithë ia plasën gazit.

Nadoja u afrua ngadalë drejt tyre e, kur po bëhej gati tē përshëndetej, Pjetër Ahmeti u ngrit në këmbë, i zgjati dorën, e duke e tërhequr, e uli pranë vetes. Shokët kishin zënë vend dhe ishin shumë tē gjallë, ndonëse ktheheshin nga turni i tretë, kurse ajo ishte e heshtur dhe e druatjurt.

— Nxirreni atë shishen!, — tha Nuriu dhe sakaq gotat u mbushën. Edhe Nados i vunë një gotë përpara.

Ajo u çudit. Mos kishte qëlluar ndonjë festë atë ditë dhe ajo s'e dinte?!

— Zade, hajde këtu!, — foli Sadiku. — Thirre edhe Zanën, paçka se Asimi është në turn!

— Po edhe drenusha në gjumë, — tha një tjetër.

Ata qeshën për të dytën herë me të madhe, sa që gumëzhiu e gjithë salla.

Zadja erdhi.

— Merre një gotë edhe ti, o Zade!

— Edhe ti, o Zanë!

Nadoja rrinte ashtu kokulur.

— Ne, shoqe, sot, që ta merrni vesh ju, kemi dy gëzime, së pari dje pasdite dhe mbrëmë tërë natën kemi ndeshur në mineral; pra mundi i tërë këtyre muajve s'na vajti kot. — Gratë hapën sytë dhe përplasën duart vetiu të gëzuara. — Përveç kësaj, kemi edhe një gëzim tjetër o shoqeni. Apo jo, o Sadik? Si thua, ta «zbrazim»?

Sadiku buzëqeshi.

— Po, shoku sekretar.

— Po ti, Sokol, si e ke syrin?

— Si të pushkës.

— Epo, ja, nga ta nis edhe unë! Këta të dy, — foli përsëri Pjetër Ahmeti, duke vështruar herë Nadon e herë Sokolin, janë për t'u uruar. Troç ta them, de! Kanë rënë në dashuri me njëri-tjetrin. Do të fejohen.

Të gjithë u ngritën në këmbë duke brohoritur.

Pjetër Ahmeti u kollit.

Nadoja u bë prush. Uli kokën e s'e ngriti. Po Sokoli ishte më trim. Ai s'po ia ndante sytë asaj.

— Ta ngremë... për ty, moj Nado, e për Sokolin, — tha Nuriu.

Nadoja heshti si e turpëruar. Kur e ngritën të gjithë, e ngriti edhe ajo.

— Atëherë, fol ti Sokol!, — pëshpëriti ajo me atë zë të lehtë, si fëshfëritje gjethesh në pranverë.

— Ngrejeni pra, këtë shëndet, shokë, — tha Sokoli, — për Partinë dhe për shokun Enver, se ky është urimi më i mirë që mund të na bëni sot neve, që po shpallim fejesën tonë, këtu në Qytezën e Bardhë. Pastaj ai hodhi sytë mbi Nadon. Ajo buzëqeshi e lumtur.

Xaja e Rexha ia morën këngës:

*«Po, Sokol, at' deshta me thanë,  
Se Partinë e kemi nanë...»*

\*

\* \* \*

Tërë dimrin e shoqëroi një erë aq e marrë, sa që herë - herë dukej se ajo do t'i shkulte me rrënje edhe lisat, edhe pishat, dhe do t'i rrokulliste trungjet e tyre shpateve, luginave, ku zhurmonin përrenjtë, që shkumbëzonin në lumen ujëkaltër. Dhe pushoi era, vetëm kur iku marsi e hyri prilli. Malet filluan të qeshnin të lehtesuara nga pesha e dëborës së dimrit. Dielli nisi të shkëlqente në qiellin e kaltër. Kështu erdhi në qytezë, pas kaq kohësh, makina e parë. Në atë makinë ishin edhe dy inxhinierë nga Tirana. Ata kishin sjellë edhe përgjigjet e analizave të gurë-kampioneve që kishin dërguar atje ata të Tellës së Egër. Dukej se ajo qytezë, ato male, ishin ngritur mbi themele të rubinta, të kuqe, të çmuara, madhështore.

Të nesërmen Pjetër Ahmeti, Nuriu, inxhinier Qemali kishin rrethuar makinën që po kthehej për në Tiranë. Në krah të shoferit ishte ulur Asim Pobregu. Zana nuk i ndahej makinës, aq sa nuk e linte derën të mbyllej. Ajo vazhdonte të përkëdhelte drenushën e saj.

— Largoju, o Zana, se do të nisemi!

— E, moj Zanë! Kë po përcjell, Asimin apo drenushën?

— I thuaj drenushës tënde një fjalë para se të niset për në kopshtin zoologjik, o Zana, i thuaj se do t'i çosh bar bjeshke, — e ngiste Nuriu.

— Ujë bjeshke

— Fllad...

Makina mori me vrull rrugën që gjarpëronte përmes konifereve duke lënë pas Qytezën e Bardhë në lartësi, qytezën e rubinit të kuq.

---

*PASQYRA E LËNDËS*

Guri i kripës .....	3
Portreti .....	11
Pishtarë të ndezur .....	18
Karakolli .....	29
Diella e Breglogut .....	36
Mëngjes i përgjakur .....	41
Qyteza e Bardhë .....	72